



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, nenit 33 të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 15 dhe 16 dhe 17 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa i Komunës së Klinës, bën këtë:

## F T E S Ë

Ftohen të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, të marrin pjesë në mbledhjen e II-të të KPF-së e cila mbahet me datë: 13.02.2023 në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës, duke filluar me punë në ora 09:00.

## R E N D I T I D I T Ë S

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
3. Shqyrtimi i Raportit të punës së ekzekutivit për vitin 2022,
4. Shqyrtimi i propozimit të drejtorisë për FEZH për bartje të mjeteve,
5. Shqyrtimi i propozimit të DUMM për destinimin e parcelës Nr.00109-0 ZK. Dolle-Klinë për ndërtimin e shtëpisë për të moshuarit,
6. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin Janar-Shkurt 2023,
7. Të ndryshme.

01Nr. 060-4045 2023  
Klinë, më 03.02 2023



Kryesuesi,  
Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Na osnovi clana 52 Zakona LSU Br. 03/L-040, clana 33 Statuta Opstine Klina, clana 15, 16 i 17 Pravilnika o radu Skupstine i Skupstinskih Komiteta, Predsedavajuci Komiteta za Politiku i Finansije vrsi sledece::

## OBAVESTENJE

Obavestavaju se clanovi Komiteta za Politiku i Finansije, stampane medija, lokalni radio da dana 13.02.2023 odrzava se 2gi sastanak za 2023 godinu.

Sastanak se odrzava u Sali Skupstine Opstine od 09:00.

## DNEVNI RED

1. Izostanci,
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa prethodnog sastanka
3. Razmatranje izvestaja rada Opstine za 2022 godinu,
4. Razmatranje predloga odeljenja FPR za prenos sredstava,
5. Razmatranje predloge odeljenja UZS za destinaciju parcele Br.00109-0 KZ. Dolac-Klina za izgradnju kuce za starce,
6. Razmatranje zahteva KPFU tokom Januara-Februara 2023m
7. Razno

01Br. 06-4045 2023  
Klina, 03/02 2023



Predsedavajuci,  
Fadil Gashi



# ORGANIZATA E VETERANËVE TË LUFTËS TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS



OVLUÇK

Adresa sheshi "Mujë Krasniqi"

Nr 004/01

Data 23.01.2023

REPUBLIC OF KOSOVA	
MUNICIPALITY OF KLINË GESTIJA KLINË	
Pranuar me dt. Reshtruar on Prilapend dana 23,01,2023	
KËRKESË: PËR Kryesuesit të Kuvendit Komunal Z. FADIL GASHI	
Org. Jed.	
01-463-2484/23	

KËRKESË: PËR Kryesuesit të Kuvendit Komunal Z. FADIL GASHI

NGA: O V L e UÇK- së Dega Klinë

LËNDA: KËRKESË:


Kerkojmë nga Kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi, të na jepë në shfrytëzim 20 ari tokë në kodrën e Gremnikut, arsëya është se në atë kodër dote vendosët simboli i luftës, tri shkronjat e arta të UÇK-së.

Në këtë vendë dote vendoset simboli i UÇK-së si dhe një park dhe dote quhet parki i UÇK-së

Mbesim më shpresë që të na ndani dhe të na ljani lejen e ndertimit të ketyre shkronjave të Arta .

Më respekt  
Klinë 23.01.2023

Kryetari OVL-es dega Klinë  
Hajdin Balaj





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

DREJTORIA E FINANCAVE, EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT  
05-Nr. 400-3897 /2023  
Klinë më dt: 02.02, /2023

**PËR:** Kuvendin e Komunës -Kryesuesit Z.Fadil Gashi.

**PËRMES:** Kryetarit të Komunës z.Zenun Elezaj,

**NGA :** . Drejtori i Drejtorisë Për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim z.Enver Berisha

**LËNDA:** Kerkesë për Bartje të mjeteve të viteve të mëparshme në vitin 2023.



Duke u bazuar në Ligjin Për Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin Për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjin Për vetqeverisjen Lokale dhe Statutit të Komunës, kërkojm nga Kshilltaret Komunal qe të bëjë bartjen e mjeteve të mbetura bnë vitin 2023 sipas kodeve të përcaktuara në kërkesen qe do ti bashkangjitet ketijë akti zyrtar.

Arsyeshmeria e marrjes se kësaj procedure qendronë se Drejtorja e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit pas aprovimit nga Ekzekutivi ka pregaditur kërkesenë për bartje të mjeteve të mbetura nga vitet e mëparshme në vitin 2023.

Me respekt.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

NGA: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit z.Enver Berisha

PËR: Komitetin për Politik dhe Financa në Klinë

Lënda: Kërkesë për predestinimin e parcelës nr.00109-0 Zk.Dolc-Klinë për ndërtimin e objektit për shtëpi të Moshuarve

Ju njoftojmë se komuna e Klinës ka për qëllim ndërtimin e Shtëpisë për përkujdesje ndaj personave të moshuar, (shtëpi të Moshuarve), andaj për ndërtimin e objekti kemi menduar që të propozojmë predestinimin e parcelës Nr.00109-0 Zk Dolc komuna Klinë në emër të Pronë shoqërore sholla Fillore "Dostijev Obradoviç. Kjo parcelë është e lire dhe e përshtatshme për ndërtimin e objekti, pasi që objekti i shkollës së fshati Dolc është i ndërtuar në një lokacion tjetër. Kjo parcele sipas Hartes Zonale ka kodin ZB2 (zonë banimi) dhe ka destinimin Banin Individual, mirpo sipas HZ në përshkrim në pikën 5.1 Në paragrafin shfrytëzimet e lejuara dytësore i përfshin edhe shfrytëzimet me aktivitete sociale, po ashtu edhe në paragrafin shfrytëzimet e lejuara të veçanta përfshin edhe shërbimet shëndetsore.

Kësaj shkrese i bashkëngjisim edhe këto dokumente:

Certifikata pronësorë  
Kopja e planit  
Ekstrakti nga HZK

Klinë, më 02.02.2023

Me respekt.

KOMUNA E KLINËS MUNICIPALITY OF KLINA OPŠTINA KLINA			
Pr marrur më dt. Received on		02.02.2023	
Pr marrjena dana			
Org. / Jed.	Numer Number Brezj	Shtojca Appendix Prillog	V. / t
01-463-3898/23			



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

*Zyrtarisht*

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71010022-00109-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	11-261-23
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	02.02.2023 - 13:14
Komuna / Opština / Municipality:	KLINË / KLINA / KLINË
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Dolle / Dolac / Dolle
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	KLINË / KLINA / KLINË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71010022-00109-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land	Rural	2603			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
SELISHTE-ZADRU.DOM				

**A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE**

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> ) Površina (m <sup>2</sup> ) Area (m <sup>2</sup> )
1	Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land	Oborr/Dvorište/BackYard		1777
2	Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land	Shtëpi-Ndërtese/Kuca-Zgrada/House-Building		826

**B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR**

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinsti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	<b>P.SH.SHKOLLA FILLORE DOSITEJ OBRADOVIQ</b>	KCID1002807	DOLLC / DOLAC / DOLLC /			1/1		





Identify Results



Feature	Value
PGeo:HZK Klinae Zonimi_HILUCS	
OBJECTID	123
(Derived)	
(Actions)	
OBJECTID	123
HILUCS1	5
HILUCS2	5.1
HILUCS3	NULL
Zonimi	Zonë banimi
Kodi	ZB
Destinimi	Banim individual
ISN	0.5
ISHPKZh	40
Strukturat_e_ndërtuara	SRIL
Llokma	NULL
NjB	NULL
kodi_i_ri	ZB2
Etazhiteti	P+2
Shape_Length	2370.17714538544
Shape_Area	67782.0666705422



Mode Current layer

View Tree



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
 MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
 MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
 MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

**KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN** - *zgjtarisht*

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KLINË  
 Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Dollc

*Nr 11-261-23*

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-71010022-00109-0	Parcelë / Parcela / Parcel	2603



Shkalla/Razmera/Scale: 1:462

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 02.02.2023

Koha/ Vreme/ Time: 01:16:11

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

*[Handwritten signature]*

Aprovoi/Usvojio/Approved/Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



*[Handwritten signature]*

KOSOVA

10-01-2023

NDIHMË JURIDIKE | PRAVNA POMOC  
LEGAL AID

**KUVENDIT KOMUNAL - KLINË**

**KËRKESË**

01, 553 - 995/23

- Për strehim të përkohshëm -

**Paraqitësja e kërkesës:** Nazife (Bajram) Gucati nga Klina, Nr.tel 044-806-788.

Si fillim më lejoni që t'ju falënderoj për Ndhimën që më keni ofruar vazhdimisht dhe që vazhdoni të më ndihmoni akoma. Unë dhe fëmijët e mi ju jemi tejet mirënjohës Kryetarit, Nënkryetares dhe çdo personi tjetër që kontribuoj sado pak në zgjedhjen e problemit tonë për Strehim të përkohshëm, në kohën unë un si viktimë e dhunës në Familje më së shumti kisha nevojë. Mirëpo me keqardhje duhet të ju njoftoj se përkundër përpjekjeve të mia për punësim apo vetëpunësim nuk arrita të punësohem dhe në pamundësi të përmirësimit të gjendjes time ekonomike po detyrohem t'ju drejtohem edhe njëherë ju si kuvend për të më ndihmuar në pagesën e qirasë. Momentalisht unë me 2 fëmijët e mi jemi duke jetuar në banesë me qira prej 250 euro, ku shuma të cilën me keni ndihmuar më parë nuk më mjafton për muajt në vazhdim. E si rezultat i kësaj ndihmi të rrezikuar se në këto ditë të ftohta do të mbesim pa strehë mbi kokë. Gjendja ime ekonomike është shumë e dobët.

Unë nuk kam pronë time të trashëguar apo çfarëdo qoftë tjetër mbi vete, jetoj në një gjendje të rëndë ekonomike, e qka më sjellë edhe para sfidave të mëdha sociale.

Andaj unë Nazife Gucati kërkoj nga institucioni i lartcekur që të marrë parasysh kërkesën dhe nevojën time urgjente dhe të na bën një zgjidhje duke më ndihmuar Financiarisht për Strehim të përkohshëm deri në një zgjidhje definitive të një banimi.

- Me Përgjegjësi të lartë morale deklaroj se jetoj në kushte jo të mira ekonomike.

**Provë:**

- Letërnjoftimi kopje.
- Kartela e Ndhimës Sociale.

Prandaj po i drejtohem titullit të lartëcekur, që të merr parasysh kërkesën dhe nevojën time urgjente.

Mbes me shpresë se kërkesa ime do të hasë në mirëkuptimin tuaj dhe të më gjendet zgjidhja për Strehim të përkohshëm.

**Klinë 10,01,2023**

**Parashtruesja e kërkesës:**  
**Nazife Gucati**







# KARTELA E VIKTIMËS

*t'i jepet viktimës me t'u raportuar rasti*

Numri i rastit:

2021-DE-504

Data e paraqitjes së rastit:

14.11.2021

Stacioni policor:

POLICOR KLIUR


Emri dhe mbiemri i zyrtarit policor:

DELLI HAKAJ

Në rast të ndonjë rasti emergjent, telefono  
Policinë e Kosovës në numrin **192**

Policimi në Bashkësi





Nazife

ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS  
 ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA  
 KOSOVA BAR ASSOCIATION

**Avokat Fisnik Mërlaku**

Pranuar **29-08-2022**



Numri i rendit	Ora e pranimit	Nënshkrimi i pranimit
9/22		<i>[Signature]</i>

REPUBLIKA E KOSOVËS  
**AVOKAT  
 FISNIK(Y)MËRLAKU  
 KLINË**

Tele: +383(0)49/534/962 – E-mail: [fisnikmerlaku@gmail.com](mailto:fisnikmerlaku@gmail.com), Rr. "Skender Rexhepi" nr. 47

**KONTRATË PËR QIRANË E BANESËS**

E lidhur në Kline, më datën: 29.08.2022

**QIRADHËNËSI:**

Imer (Isen)Hoti i lindur me 01.10.1952, ne fshatin Jashanicë Komuna e Klinë, tani me vendbanim ne Belgjikë, me numer personal: 1170552845, dhe nr të ID: 1402904, ku i lartë cekuri me dat: 29.08.2022 ne bazë të Autorizimit të derguar nga Rrjeti i tij social (Viber) nga numri i telefonit ti personal me nr: +32494845232, e autorizon: djalin tij: Driton (Imer) Hoti, i lindur më 20.02.1974, në fshatin Jashanicë, Komuna Klinë, me numër personal 1172243505, dhe nr të ID: 1557952, të lëshuar me dat: 09.01.2020 i vlerfshem deri me dat: 08.01.2030. me zotesi te plotë veprimi. të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës.

Dhe

**QIRAMARRËSJA:**

Nazife (Bajram) Qallapeku e lindur më datën 14.06.1969 në fshatin: Polac Komuna Skenderaj tani me vendbanim ne fshatin: Shtupel Komuna Klinë, me zotësi të plotë veprimi, me Numër Personal: 1004944000, dhe nr të ID: 1139631, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, më datën 07.12.2018, i vlerfshëm deri më datën 06.12.2028.

Palët kontraktuese arritën marrëveshjen, si vijon:

**Neni I  
 Lënda e Kontratës**

1.1. Në bazë të Parakontrate për Shitëblerjen e Banesës Nr.rend.7139/2021, Ref.nr.1615/2021 datë: 03.09.2021, pronar është Imer Hoti ku Qiradhënësi, është pronarë i banesës e cila evidentohët me Nr.rend.7139/2021, Ref.nr.1615/2021 datë: 03.09.2021, Banesa është në katin e 6 (gjashtë), me sipërfaqe prej: 83.50 m<sup>2</sup>.

*[Handwritten signature]*



*[Handwritten signature]*



1.2. Qiradhenësi është në pajtim që të jep dhe qiramarrësi që të merr më qira katin 6 (gjashtë), me sipërfaqe prej: 83.50 m<sup>2</sup>, të specifikuar në paragrafin 1.1. të këtij Neni.

#### Neni II

##### Çmimi i Qirasë dhe detyra tjera

2.1. Palët kontraktuese janë pajtuar që efekti i kësaj kontrate të filloj nga dt: 01.09.2022, në kohëzgjatje prej 6 muaj (gjashtë muaj) me mundësi vazhdimi, gjegjësisht gjerë më dt: 28.02.2023, me mundësi vazhdimi prap për 6 muaj (gjashtë muaj), palet në kontrat duhet ta njoftojn 2 muaj para nese dojn me shkput kontraten apo ta vazhdojn ate.

2.2. Palët në këtë Kontratë kanë arritur pajtimin që çmimi kontraktues për shfrytëzimin e banesës do të jetë 250 € (dy qind e pesdhjet euro), për muaj.

#### Neni III

##### Menyra e pagesës

3.1 Qiramarrësi është i detyruar që për shfrytëzimin e banesës sipas nenit 1. Pika

1.1. të pagujë qiranë për qdo Muaj duke filluar nga data 01.09.2022 deri me 28.02.2023, në shumën, nga 250€ (dyqind e pesë dhjet euro) në muaj, kesh në dorë.

Pagesa e qirase duhet të behët prej datës 01. deri me datën 05, në fillim të qdo muajit. kesh në dorë të qiradhenësit: sipas autorizimit: Driton (Imer) Hoti.

#### Neni IV

##### Shpenzimet e shfrytëzimit

4.1. Shpenzimet qe krijohen si rezultat i shfrytëzimit të zakonshme siç janë: rryma, dhe mbeturinat, mbesin në shfrytëzim të lir apo ngarkim nga pronari i objektit (Punkryesi) deri në regjistrimin e orave elektrike dhe regjistrimin e mbeturinave, ndersa shpenzimet për Ujin i bartë Qiramarrësi nga data e lidhjes së kontrates, njesori mates i ujit me nr: 00006530 datë: 29.08.2022, ndërsa shpenzimet e jashtëzakonshme të cilat shkaktohen nga fuqië madhore (Vis major) pa fajin e qiramarrësit si dhe pagesën e tatimit në pronë e bartë qiradhenësi.

4.2. Qiradhenësi obligohët që t'i përmbush të gjitha detyrimët e mëhershme të rrymës, ujit, mbeturinave dhe obligime tjera të shkaktuara për shfrytëzimin e banesës.

4.3. Qiramarrësi nuk mban përgjigjësi për borxhët e mëherëshme të mundshme, të shkaktuara para lidhjes, së kësaj kontrate.

#### Neni V

5.1. Nese qiramarrësi apo qiradhenësi deshirojnë ta nderpresin kontratën mbi qirane, secila pale është e detyruar qe ta lajmeroj palën e kundërt paraprakisht 2. (dy) muaj perpara ditës së shkeputjës se kontratës.

Biznes I  
OKA  
Nr. U.  
Nr. U.  
Nr. U.  
Punkryesi  
Tender



### Neni VI

Pas përfundimit të kontratës së qirasë, qiramarrësi detyrohet ta kthejë banesën nga neni 1 par.1.1. të kësaj kontrate në posedim të qiradhënësit në gjëndjen e njejtë si është pranuar me qira, po ashtu qiramarrësi është i obliguar që ta mirëmbaj banesën si shtëpiak i mir dhe ekonomist i mir.

### Neni VII

Palët kontraktuese me vullnet deklarojnë që dhënien-marrjen me qira të Banesës nga neni 1 i kësaj kontrate e kanë bërë me vullnetin e tyre të lirë, me vetëdije të plotë, pa kurrfarë dhune, kërcënimi, mashtrimi apo lajthimi juridik, të cilën gjë e vërtetojnë me nënshkrimin e kësaj kontrate.

### Neni VIII

Sipas kësaj kontrate, qiramarrësi, nuk ka të drejtë që Banesës, katinë 6 të përshkruar në nenin 1 të kësaj kontrate t'ia japë personave të tretë pa pëlqimin e qiradhënësit.

### Neni IX

Mosmarrëveshjet eventuale të cilat paraqiten gjatë zbatimit të kësaj kontrate, palët kontraktuese do t'i zgjidhin me bisedime dhe mirëkuptim, e po që se një gjë e tillë nuk është e mundur, atëherë kontesti do të zgjidhet nga Gjykata Themelore Pejë Dega Klinë.

### Neni X

Kjo kontratë është përpiluar në ekzemplarë të mjaftueshëm, si për palët kontraktuese, ashtu edhe organet e tjera, dhe pasi që iu lexohet me zë, palët kontraktuese njëzëri deklarojnë se e pranojnë si të veten dhe e nënshkruajnë pa vërejtje, prandaj pas nënshkrimit atyre u jepen ekzemplarë të mjaftueshëm të saj.

### PALËT KONTRAKTUESE

#### QIRADHËNËSI

Emri: Imer (Isen)Hoti

Nr: personal:1170552845,

Nr:ID:1402904,

Adresa:Fsh:Jashanic K.Klinë

I Autorizuari:Driton (Imer) Hoti

Nr.Personal:1172243505

Nr.ID:1557952

Nënshkrimi:

Adresa:fsh:JashanicëK.Klinë.

#### QIRAMARRËSI

Emri:Nazife(Bajram)Qallapeku

Nr: personal:1004944000

Nr:DL:1139631

Adresa: Shtupel Komuna Klinë

Nënshkrimi:



Stamp: TUAL, WYER TAKI, 957, 0362, gmail.com, Sh. Klinë



NDIHMJA JURIDIKE • PRAWNA POMOC  
LEGAL AID

## AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Zyra Mobile për Ndihmë Juridike Falas Klinë

A.nr.02/23-10

Dt.10,01,2023

Në pajtim me neni 32. pika 1,2,3 dhe 4 të Ligji për Ndihmë Juridike Falas, nr.04/L-017, Zyra Mobile për Ndihmë Juridike Falas në Klinë, bie këtë:

**APROVOHET** kërkesa për lejimin e ndihmës juridike falas **Nazife (Bajram) Gucati** Rr.Ali Kelmendi K.Klinë.

### A r s y e t i m

Aplikuesja **Nazife Gucati** ka parashtruar kërkesën për ofrimin e ndihmës juridike falas.

Pas shqyrtimit të kërkesës së aplikuesi verifikimit të përmbushjes së kriterëve në pajtim me nenin 7,8 dhe 9 të LNJJF, si dhe dokumentacionit të bashkangjitur, Zyra Mobile për Ndihmë Juridike Falas, në **Klinë**, konstatoi se përfituesi potencial i ndihmës juridike falas i plotëson të gjitha kriteret e parapara, në pajtim me Ligjin për Ndihmë Juridike Falas Nr. 04 /L-017 .



Zyrtari i Ndihmës Juridike Falas

Taulant Nikçi

**Këshilla juridike:** Kundër këtij Vendimi pala e pakenaçur, ka të drejtë të ushtroi ankesë, në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të Vendimit. Ankesa i dorëzohet Komisionit për Ankesa, të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas – Zyra Mobile për Ndihmë Juridike Falas Klinë, Rr. “Abedin Rexha” Shtepia e Kulturës “Jehona e Dukagjinit”  
Pn.

Tel. 039 423-698 Tel. Falas 0800 11 777, web: [www.anjf-rks.org](http://www.anjf-rks.org)



Prishtinë: 10.01.2023

**Nga: NLB BANKA sh.a.**

**Subjekti: Vërtetim mbi llogarine**

Ne **NLB BANKA** sh.a. me përgjegjisi të plotë lëshojmë këtë informacion qe klienti **NAZIFE QALLAPEKU** i/e ka te hapur llogarine me nr: **17-09-1000924688.42**

Ky informacion është me kërkesën e klientit.:

  
NLB Banka  
Ekspozitura Klire - Shifra 827



**Kuvendi i Komunës Klinë**  
**Komiteti për Politikë dhe Financa**

01Nr \_\_\_\_\_/23

Klinë,dt: \_\_\_\_\_/23

**PROCESVERBAL**

**Nga mbledhja e I-rë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 13.01.2023, me fillim nga ora 09:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.**

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e Komitetit, OSB-në, drejtorët dhe të pranishmit, gjithashtu theksoi se është mbledhja e parë për këtë vit. **Fadil Gashi, Kryesues:** Te rendi i ditës unë i kam tre kërkesa të reja jashtë kësaj që e kemi në rend dite dhe po filloj me radhë:

- 1. Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2023;**
- 2. Inicimi i Plotësim-Ndryshimit të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Klinës;**
- 3. Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027.**

**Kryesuesi, prezantoi rendin e ditës:**

- 1. Arsyetimi i mungesave;**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit Financiar janar-dhjetor 2022 (ref.drejt.fin);**
- 4. Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi i dytë i kryetarit të komunës me qytetarë për vitin 2022;**
- 5. Shqyrtimi i Planit të Punës së Prokurimit për vitin 2023;**
- 6. Shqyrtimi i Planit të Punës së KKSB-së për vitin 2023;**
- 7. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin dhjetor 2022- janar 2023;**
- 8. Të ndryshme.**

**Fadil Gashi, Kryesues:** Po besoj se me material kemi pasur pak problem, se adresat zyrtare është mirë t'i funksionalizojnë, se kur po ka material shumë po kemi problem pastaj të kemi qasje në dokumentet që po jua dërgojmë, kjo është e para, e dyta është që unë kam fjalë të mira që unë po besoj se jemi afër furnizimit me llaptop, ndoshta edhe kjo na ndihmon pak. Unë po hap debat rreth rendit të ditës me këto tre kërkesat tjera që të shtohen në rend të ditës.

**Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 5 vota PËR, u miratua rendi i ditës.**

### **Pika 1. Arsyetimi i mungesave.**

**Fadil Gashi, Kryesues:** Unë po konfirmoj se prej 7 anëtarëve të KPF-së, jemi 5 sepse nuk kemi pranuar konfirmim ende ndaj ministrisë dhe besoj se me 5 ne mund të vazhdojmë seancën e mbledhjes.

**Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 5 vota PËR, u miratua rendi i ditës.**

### **Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

**Fadil Gashi, Kryesues:** A ka dikush diçka rreth procesverbalit nga seanca e kaluar?

**Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, Kryesuesi hodhi në votim dhe me 5 vota PËR, u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.**

### **Pika 3. Shqyrtimi i Raportit Financiar janar-dhjetor 2022 (ref.drejt.fin).**

**Fadil Gashi, Kryesues:** Ne e kemi drejtorin e Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, ju kisha lutur që ta bëni një prezantim dhe pastaj e kishim debatuar.

**Enver Berisha, drejtor i DFEZH:** Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë! Meqë është takimi i parë i Komitetit për Politikë dhe Financa për këtë vit, ju uroj gjithëve të keni shëndet, në punë angazhim, harmoni në familje dhe në punët tuaja të përditshme. Jo veç në këtë rast që unë dua ta them por është një situatë të cilën e kemi vlerësuar të gjithë, kisha thënë në nivel vendi, se viti që e lamë pas ka qenë sfidues për arsye se u përballem në të kaluarën edhe me situata të tjera të zakonshme, siç ishte kovidi, mandej u përballem me dy gjëra që faktikisht ne veç i kemi pasur, është fjala për vonesa në shpalljen dhe kryerjen e punëve për shkak të mungesës së OSHP-së deri vonë, dhe e dyta, rritja e çmimeve e cila e ka bërë të veten në Kosovë dhe në komunën tonë që realisht ka qenë bukur sfiduese me mbërrij me i realizuar të gjitha

projektet të cilat ne i kemi pasur. Por duke i pasur krejt këto sfida parasysht edhe para vetes, është jashtëzakonisht domethënëse dhe meritore se komuna e Klinës është ndër komunat që ka mbërri ta realizojë buxhetin e saj mbi 90% dhe këtë shifër ka pak komuna në Kosovë që e kanë, kështu që, është e rëndësishme kjo për faktin se ne do të jemi pjesë e fitores edhe të grandit si rezultat i shpenzimit të mirë të buxhetit për vitin 2022.

Planifikimi i buxhetit për vitin 2022 ka qenë, dmth grandit qeveritar ka qenë 10,372,411.74 euro;

- Të hyrat vetanake kanë qenë 1,065,865.00 euro;
- Të hyrat e bartura kanë qenë 1,196,666.06 euro;
- Participimi i qytetarëve ka qenë 41,443.63 euro dhe
- Një donacion i vogël nga "Save The Children" që ka qenë 5,437.68 euro.

Krahasuar me periudhën 2021 dmth ka qenë 1.46% rritja për grandin qeveritar, kanë qenë në të hyrat vetanake 28.35% , dhe prej krejt kësaj ne kemi mbërri t'i shpenzojmë këto mjete në këtë formë, dmth te grandit qeveritar ose te total buxheti i 12,000,000,00 euro kanë mbetur të pashpenzuara 12,680,000,00 euro, kanë mbetur të pashpenzuara edhe 1.100.000.00 euro.

Domethënë 760.000.00 euro barten si pjesë e buxhetit tonë, dmth janë mjete që nuk na merren, ndërsa mjetet që na merren janë diku 365.000.00 euro që janë nga paga dhe mëditje për shkak të një planifikimi që ne e kemi bërë për shujta, por që realisht ajo nuk është realizuar në mungesë të vullnetit që Ministria e Financave dhe Thesarit nuk e lejuan, por që këto mjete ka rrezik që të merren. Mirëpo, sido që të jetë, në investime kapitale, në mallra dhe shërbime, në komunal, në të gjitha shpenzimet për të cilat komuna është përgjegjëse, në total jemi shpenzues të mirë të buxhetit në kuptimin e menaxhimit të projektit të kërkesave, kështu që, besoj se ky vit tash na krijon një mundësi që vërtet të kemi një situatë edhe më të mirë në periudhën vijuese, duke pasur parasysht pengesat që kanë qenë në vitin 2022 po shpresoj që nuk kemi me pas në vitin 2023 dhe komuna dhe qeveria lokale me qenë më efikase, me qenë më shpenzuese e buxhetit në kuptimin pozitiv, duke i realizuar të gjitha ato zotime që i ka bërë para qytetarëve dhe para votuesve. Kjo është sa për fillim, nëse ka dikush diçka që realisht është konkrete, ju e keni marr raportin e punës, besoj keni pasur mundësi edhe ta shihni por si zakonisht këto mbesin për t'i shqyrtuar edhe në subjektet tjera politike, me siguri që në fund me nxjerr një konkluzion për shpenzimet e këtij buxheti, faleminderit. Nëse ka kryesues diçka, unë do të mund të kyçem prapë.

**Fadil Gashi, Kryesues:** Faleminderit, drejtor, për prezantimin dhe raportin! Unë fillimisht, jo veç si kryesues, por edhe si anëtar i Kuvendit, kisha dashur që për seancë është mirë me na sjell edhe tabelat krahasuese, e kemi pasur si praktikë, të shpenzimet sidomos, sepse të të hyrat është një tabelë krahasuese që e krahason me vitin paraprak dhe vërtetojmë atë që e themi edhe në raport, se unë e di saktë se te drekat zyrtare, për vitin që e lamë pas janë shpenzuar 1.664.00 euro, unë e di se në vitin e kaluar kemi pasur edhe më shumë shpenzime sesa kjo. Kemi edhe 2-3 sqarime nëse ka mundësi për seancën jo për mua, i kemi nja dy vende, vendimet e pagesave për vendime gjyqësore, ne dy kategori i kemi, njërën e kemi te rrogat dhe pagat, që as sot nuk e kuptoj këtë term, me qenë paga edhe mëditje, por rroga dhe paga! Por kjo s'është faji ynë, është niveli i sistemit, e para është 24.073.00 euro dhe te kategoria e dytë, prapë janë shpenzime vendime gjykatës 30.600.074 euro, te mallra dhe shërbime, tash veç m'i krahasuar a janë të njëjta, se unë e di se te njëra pjesë duhet me qenë e arsimtarëve por kjo pjesa veç si krahasime, edhe një diçka që po shoh, se ka shumë shpenzime këtu, subvencionet për entitete jopublike 400.

628.00 euro në një pozitë që janë dhe në të dytin transfere kapitale për entitete jopublike, prapë janë 17.500.00. Veç këto 2-3 çështje i kishim marr për seancën.

**Enver Berisha, drejtor i DFEZH:** Realisht edhe paraprakisht, unë para se m'i rregulluar këto terme, unë i kam evituar të gjitha këto, por unë e pata parasysh që me siguri në seancë do të ngrihen. Për atë nuk i bëra sqarimet konkrete, por në krahasim sado që duken në emërtime të njëjta ose të ngjashme, kodet dallojnë, jo vetëm në këtë segment se ka plot ngjashmëri edhe me shpenzime tjera, që dmth si emërtim është i përafërt, por në buxhet dallon kodi, por për gjitha ato në seancë do të jetë e domosdoshme.

**Fadil Gashi, Kryesues:** Faleminderit, drejtor! Urdhëroni, nëse ka ndokush?

**-Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të Raportit Financiar janar-dhjetor 2022, me 5 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, rekomandoi që për Kuvend të përgatitet tabela e shpenzimeve në krahasim me vitin paraprak, po ashtu rekomandoi që raportit të kalojë për shqyrtim në Kuvend.**

**4. Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi i dytë i kryetarit të komunës me qytetarë për vitin 2022.**

**Fadil Gashi, Kryesues:** As këtë ende s'e kam kuptuar; pse duhet ne ta miratojë këtë çështje ,as nuk marrim pjesë, as s'e dimë çka kanë folur, por e kemi formalisht, kështu si na është bërë. Kush është për?

**Komiteti Për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të procesverbalit nga takimi me qytetarë i mbajtur nga kryetari i komunës z. Zenun Elezaj, me 5 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, rekomandoi që procesverbali të kalojë për shqyrtim në Kuvend.**

**5. Shqyrtimi i Planit të Punës së Prokurimit për vitin 2023.**

**Fadil Gashi, Kryesues:** Ne kemi zyrtarin e prokurimit, z.Labinot Morina, nëse dëshironi ta bëni një prezantim, faleminderit! Besoj se ju e keni pranuar planin e prokurimit.

**Labinot Morina, zyrtar i prokurimit:** Përshëndetje për të gjithë! Sa i përket planifikimit të prokurimit për vitin 2023 është bërë në bazë të kërkesave nga njësitë kërkuese që kanë ardhur për këtë vit, për planifikimin e prokurimit për vitin 2023 që përbëhet nga gjithsej 97 procedura, të cilat për furnizime janë 20 procedura që kanë vlerën 1.016.000.00 euro, përbëhet prej shërbimeve 12 procedura që e kanë vlerën rreth 300.000.00 euro dhe rreth 97 procedura për punë që e kanë vlerën prej 3.800.000.00 euro, pra, planifikimi në bazë të njërive kërkuese është rreth



5.161.000.00 euro.

Pra, në buxhet nuk janë të planifikuara edhe disa procedura që janë të lidhura me kontrata 2 dhe 3 vjeçare, që nuk shihen këto në planifikim. Po ashtu, gjatë planifikimit të prokurimit që e keni ju, është një ndryshim në faqen 17 është vetëm instalimi i kaldajës në shkollën e Budisalcit, që është në vlerë diku 30.000.00 euro që mund të futet për rend ditës, ky është planifikimi për vitin 2023.

**Fadil Gashi, Kryesues:** Faleminderit, a ka dikush tjetër?

**Tunë Dedaj:** Po, Kryesues, përshëndetje për ju të gjithë! Unë e kam një kërkesë; që me kohë të bëhet çdo gjë e mos të lihet në fund. Zyra e prokurimit me i shpall tenderët e këto, por gjithmonë të bëhet në fillim të vitit edhe në këtë kohë të punohet sa më mirë edhe sa më kualitet, dhe nëse në ndërmarrje nuk i kryen punët me kohë, me vënë në listë të zezë.

Pra, gjitha këto me kohë me i bërë e jo me prit në fund ose me prit në shtator-tetor, kur është në përfundim të vitit e pastaj m'i kryer punët me nguti, kaq!

**Labinot Morina:** Po, Tunë, faleminderit, por sa i përket inicimit të procedurave zakonisht bëhet prej Drejtorive, ne nuk mund ta fillojmë një procedurë pa na ardhur kërkesa për inicim, kështu që, këtë adresim më mirë është Drejtorive, e sa i përket penalizimit, këtë vit janë bërë 7 ndërprerje të kontratave me penalizime, disa me pajtueshmëri të dyanshme me ndryshime të çmimeve të inflacionit, kështu që, as ajo nuk është për fajin e zyrës.

**Enver Berisha, drejtor i DFEZH:** Unë në fillim e thash, që ky vit ka pasur probleme me shpalljen e tenderëve për shkak se nuk ka funksionuar OSHP-ja disa muaj edhe komuna jo e Klinës po e gjithë Kosovës s'kanë mundur të shpallin projektet, pastaj kërkesat prej drejtorive, po edhe menaxhimi i krejt projekteve është i drejtorisë në aspektin teknik të shpalljes edhe përcjelljen e tenderit në marrje pune, tutje është menaxheri i kontratës dhe Drejtoria që duhet me përcjell, po unë jam më se i sigurt që në këtë vit është një risi sepse secila Drejtori duhet të planifikojë buxhetin me shpenzuar sipas tremujorshave dhe ajo pjesë që nuk shpenzohet, ajo rrezikohet të na merret në fund të vitit. Këtë vit unë besoj që ka me qenë vit më i kujdesshëm edhe për drejtoritë sepse ato para që i kanë të planifikuara në buxhet ata duhet të fillojnë shumë shpejt me procedura për t'i shpenzuar, sepse në fund nuk ka më ashtu, po unë mund të pajtohem veç me një qasje që ju e thatë, që edhe aspekti i mbikëqyrjes edhe i kualitetit, këtu kisha thënë që drejtorët, cilido, dhe menaxherët e kontratës të kenë kujdes që të paktën punët të kryhen me efikasitet dhe me kualitet të mirë.

**Fadil Gashi, Kryesues:** Për ne, drejtor, ne i kemi drejtoritë, i kemi njësitë shpenzuese që në të njëjtën kohë janë edhe njësitë kërkuese, po unë po besoj që edhe zyra e prokurimit edhe pjesa tjetër që janë të veshur me përgjegjësi, është mirë, ne po lutemi gjithë mos me na ndodh. Unë tash e jap një shembull të zyrës sonë; që 6-7 muaj e kemi pritur një top letër me na ardh, me na rregulluar një printer së pari, që s'punonte edhe veç te ne në Kosovë e di që jemi "sui generis" me ditë Prishtina sa metra letër na vyen neve, ne duhet me prit deri ta lëshojnë ata një top letër me na sjell, i kemi harxhuar zyra jonë duke ja dhanë zyrës së ofiqarisë atje, se s'kishin për t'i

kryer palët. Nuk është faji i komunës, është faji i atyre që na përcaktojnë, merre me mend, jua përcaktojnë sa letër keni me shpenzuar, kjo është absurditet i llojit të vet edhe unë po shoh që këto janë planifikuar të blihen disa letra por nuk duhet me mbet në mëshirën e një të papërgjegjshmi atje, një kompani që mundohet ta mbulojë krejt Kosovën edhe deri t'i vjen rendi për Klinë nëpër zyrat tona, nëpër njësitë tona ose Drejtoritë tona, është e papërgjegjshme dhe pjesa tjetër te planifikimet që ju bëhen Drejtorive është mirë më herët qysh thotë edhe Tuna, me filluar me i bërë kërkesat në zyre të prokurimit. Ne, tani kemi hyrë në këtë vit, këta me shkolla tona p.sh.,e dinë që ka me ardh dimri, pse mos të fillojnë që tani, të përgatiten me drunj. Unë po marr shembull veç shkollat, por ka edhe njësi tjera që mund të kryhen shumë më herët, e keni parasysh me pas ankesa qysh bëhen vonesat pastaj, i nxjerrim telashe edhe zyrës së prokurimit, ne të gjithë nga pak jemi përgjegjës, por, me këtë ndryshimin që e propozoj edhe zyrtari Labi dhe e kemi pranuar, ne kemi shqyrtuar në seancë, unë edhe njëherë po kërkoj nëse keni edhe ju diçka tjetër, është procedurë që ne duhet ta shqyrtojmë këtë planifikim dhe ta procedojmë, ta miratojmë dhe pastaj në afate janë të shkoqitura, a ka dikush?

**Enver Berisha, drejtor i DFEZH:** Ne si ekzekutiv, kësaj here kemi vendosur që secila Drejtori veç e veç me e përgatitur Planin e punës dhe atë plan me unifikuar në kuadër të gjitha Drejtorive dhe me bërë në formë të broshurës dhe besoj shumë shpejt do ta keni edhe ju si asamblistë por edhe qytetarët, kushdo që është i interesuar ta ketë dhe me e parë se secila Drejtori çka ka planifikuar për vitin 2023. Unë besoj që kjo është një risi por është risi e mirë, të njëjtën formë ta bëjmë edhe raportin e punës, edhe ata do ta vëmë bashkërisht të gjitha Drejtoritë çka është kryer në vitin 2022 dhe në fund të broshurës atë raport me pas edhe ekzekutivi edhe qytetarët që kushdo që është i interesuar me ditur çka ka bërë komuna për 2022-tën dhe çka planifikon për 2023-tën, me pas në formë të broshurës.

**Fadil Gashi, Kryesues:** Faleminderit drejtor, ju po e shihni, ne e kemi Planin e punës edhe të ekzekutivit edhe anëtarët e Kuvendit në vazhdimësi në seancë mund t'i shikojnë a po implementohen planet apo s'po implementohen, a ka dikush tjetër?

**-Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të draft-planifikimit të prokurimit për vitin 2023, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 5 vota për, rekomandoi që draft-planifikimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

## **6. Shqyrtimi i Planit të Punës së KKS-së për vitin 2023.**

**Fadil Gashi, Kryesues:** Kush po na prezanton këtë? Është dashtë edhe nënkryetarja me qenë këtu, edhe ky plan është çështje e rregullt, është procedurë e rregullt, se ne për çdo vit e miratojmë Planin e Këshillit të Sigurisë në Bashkësi dhe ata e vazhdojnë punën e vet duke u bazuar edhe në planifikime edhe në takime edhe në aktivitete, ashtu qysh si i kanë paraparë. Pjesën dërrmuese ju veç po e shihni, kënde janë pa kosto buxhetore, nuk e ka ndonjë implikim, kështu që, me thënë përpos atyre që ne veç i kemi planifikuar në buxhet për një vit fiskal. A ka dikush për këtë plan, kush është për?

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të draft-planit të KKSB-së për vitin 2023, me 5 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, rekomandoi që të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

## **7. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin dhjetor 2022- janar 2023.**

### **Kërkesë 1.**

Kërkesë për shfrytëzimin e parcelës P-71011030- 00116-0, Zona Kadastrale Drenoc, Klinë. Parashtrues i kërkesës, Gievdet Feiza Prebreza, thekson: Po e dorëzoj këtë kërkesë për marrje në shfrytëzim të parcelës me numër P-71011030-00116-0, zona kadastrale Drenoc, me sipërfaqe 3503 m2 e cila gjendet para parcelës time me numër P-71011030-00117-3, parcelë në të cilën unë kam dy shtëpitë në të cilat banoj me familje. Parcela gjendet para parcelës time në komplet gjatësinë, andaj më duhet shfrytëzimi i saj për pastrim nga shkurret, mbjellje të drunjve dekorativ, hapësirë gjelbëruese. Shprehem i gatshëm që në rast të dhënies në shfrytëzim të kësaj parcele do të jem i gatshëm të paguaj taksat sipas ligjeve në fuqi dhe që ta kthej prapë kurdo që kërkohet. Po ashtu, zotohem në mirëmbajtjen në mosdëmtim të mjedisit brenda kësaj parcele.

**Fadil Gashi, Kryesues:** Ju e dini procedurën për dhënie në shfrytëzim të hapësirave publike, ne e kemi miratuar në seancën e fundit listën dhe për këtë vit tash kjo parcelë nuk është e planifikuar, tash këtu duhet me filluar me ju dhanë përgjigje palëve pak më ndryshe.

Vitin e kaluar, ne nuk kemi pasur listë të publikuar, tani për këtë vit e kemi listën e publikuar dhe për parcelat që nuk janë në listë ju e dini se ne nuk mund t'i fillojmë procedurat fare me i dhanë. Nuk e di a jam i qartë sepse e kemi tash një ndryshim për këtë vit, që kemi me u ballafaquar edhe me kërkesa tjera, tash për ato që nuk janë në listë, ne, nuk mund të fillojmë asnjë inicim, a ka dikush ? Si duket nuk ka, atëherë a po pajtoheni me këtë që unë e thash, se fillimisht parcela duhet me qenë në listë, ne edhe njëherë për siguri e marrim konfirmimin prej shërbimeve edhe gjeodetëve edhe atyre dhe kur t'i kthejmë përgjigjen palëve duhet me jua kompletuar me referenca të sakta. Kush është për ?

**-Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, rekomandoi që kjo kërkesë të kalojë për shqyrtim në Zyrën e Kryetarit dhe në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, të trajtohet në bazë të Ligjit Nr.06./L-092 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.**

**Pika 8. Inicimi i plotësim-ndryshimit të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Klinës.**

**Fadil Gashi, Kryesues:** Ne e kemi një kërkesë realisht nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, që kërkon që të fillohet ndryshimi i rregullores për shkak të kostove, për shkak të ndryshimeve dhe të shpenzimeve dhe të arsyeve që ata i bëjnë. Ju e dini procedurën si bëhet plotësim-ndryshimi i rregullores, ne veç e kem rregulloren që është miratuar në vitin 2017, rregulloren komunale për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Klinës. Ne sot por edhe në seancën që vjen e marrim vendim veç për iniciimin edhe me lëshu në shqyrtim publik, edhe kjo është detyra jonë e parë, pastaj fillon shqyrtimi publik edhe tek në tjetrën seancë kur t'i kryejmë këto procedura ne shkojmë në miratim në seancë, por, pasi ne duhet me vendos për ndryshim për iniciim të plotësismit, unë po hap debat rreth kësaj, nëse ka dikush, urdhëroni?

**Tunë Dedaj:** Po, Kryesues, duke e marrë parasysh se janë rritur të gjitha, dmth janë rritur dhe derivatet e janë rritur të gjitha, edhe unë dhe grupi i AAK-së e mbështesim që të shqyrtohet mundësia që tu dilet në ndihmë, që të kenë ata mundësi m'i marr mbeturinat, se tash e dimë sa ka qenë 1 litër naftë, 1.00 euro dhe sot është 1.50 edhe në mënyrë automatike shpenzimet për t'i hequr mbeturinat nëpër shtëpia edhe më të mëdha dhe besoj që edhe qytetarët do ta presin me mirëkuptim një rritje sado e vogël që ju bëhet edhe le t'i del në ndihme kompanisë, për arsye që e keni vërejtur, pastrimi i qytetit dhe fshatrave për mua është i shkëlqyeshëm. Gjithmonë ka me ardh te unë kamioni, po flas për fshatin tim, të shtunën në ora 8:00 m'i marr mbeturinat në këtë fshat edhe besoj se është në gjitha fshatrat e komunës së Klinës kështu edhe në qytet dhe unë e arsyetoj këtë kërkesë të tyre, jam për ta shqyrtuar mundësinë për t'iu dal në ndihmë, për me ndryshuar rregulloren. Faleminderit shumë!

**Fadil Gashi, Kryesues:** Faleminderit, Tunë! Ne e kemi edhe një komision të cilin ne veç e kemi miratuar në këtë Kuvend, por unë po besoj që është edhe me shqyrtime edhe me raport të tyre, po besoj edhe këto që u thanë edhe ato që i kemi kërkesë në vazhdim, po ju them juve qysh e kanë pranuar edhe qysh kanë biseduar jo veç prej ekzekutivit tonë por edhe komunave tjera, të gjitha kanë hyrë në ndryshime sepse janë rritur kostot, ne jemi të vetëdijshëm a ka vend me i shikuar se pak ishin në rreth që po mujshim me pa çka mundemi me bërë. Pra, kjo kur të fillojë me fazë tjetër, kur të kalojmë në shqyrtim, sot po e fillojmë veç si iniciim, meqë e kemi rregulloren paraprake ne veç po bëjmë plotësim-ndryshim të rregullores në hapa të tjerë edhe në fund ne e përcjellim për të mundur këto ndërmarrje publike krejt me i kthyer te ne edhe mos me pas punë hiç me regjione as me të tjerët. Besoj që edhe dukshëm kishte me u përmirësuar edhe jo veç si ndërmarrje por edhe si funksion edhe si punë, a ka dikush, nëse s'ka, kush është për?

**-Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, pas shqyrtimit të Draft- Rregullores Komunale për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Klinës, rekomandoi që të kalojë për shqyrtim në Kuvend dhe të merret vendim për vënien në diskutim publik.**

**Pika 9. Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027.**

**Fadil Gashi, Kryesues:** Ju tash veç e keni lidhshmërinë si e thash edhe unë që kjo lidhet me të parën, është plan që votohet. Më ka bërë përshtypje te të hyrat, në Klinë inkasohen të hyrat e mbeturinave, në fakt 87.4% është shifër bukur e madhe, unë po flas gjithmonë duke ju referuar këtij raporti dhe që është për t'i përgëzuar gjithë qytetarët tanë sepse 87.4% është te amvisëritë dhe çka është më e keqja më shumë kanë dështuar në përqindje institucionet dhe bizneset sesa amvisëritë, është një përqindje që mua përnjëmend më ka lënë përshtypje të mirë në të hyrat që ka krijuar ndërmarrja.

Në faqen 24 unë po jua lexoj të hyrat dhe ofrimi i shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, të hyrat në amvisëri, shifra 88.3% , te bizneset 85% , te institucionet qenka 86% dhe prijnë amvisëritë që e kanë pagesën më të madhe që është për çdo inkurajim tjetër për këto biznese që nuk e lajnë, megjithëse për këtë ka edhe mekanizëm që mund t'i detyrojnë me bërë pagesa, urdhëro, Tunë?

**Tunë Dedaj:** Po, Kryesues, nuk është fort në pyetje mekanizmi por punëtorët janë shumë punëtorë që i mbledhin ato edhe qytetarët janë bindur që duhet të paguhet bartja e mbeturinave, janë bindur që kanë nevojë. Por unë e kisha kërkuar nga ju dhe nga kryetari i komunës, që të formohet një kompani komunale për bartjen e mbeturinave që nuk i marrin këta, p.sh., drunjtë, hekurat, këto të ngurtat, që nuk i marrin, me formuar një kompani komunale edhe m'i marr disa punëtorë, me ble një kamion ose me traktor edhe p.sh., një herë në muaj me shkuar bile nëpër fshatra, me qenë pikat e grumbullimit, e ato me marr e m'i dërguar në vende të destinuara. Kjo kishte me qenë edhe më e mirë se ato kanë mbetur pak, se nuk është diçka e hijshme p.sh., dikush krevatin e merr e gjuan dhe e len aty edhe kompania nuk ja merr se nuk ka si me e marr edhe kjo do të ishte mirë për komunën, për qytetarët, me formuar një këso lloj kompanie komunale, me gjet një mënyrë, kaq!

**Fadil Gashi, Kryesues:** Jo, mënyra është e gatshme, ne jemi tash në ndryshim të rregullores me paraparë nëse kemi mundësi ne, me bazë ligjore me paraparë për me marrë, a ka dikush tjetër?

**Tunë Dedaj:** Silvija Rashkoviç e ka një vërejtje se, afër Rudicës atje është një grumbullim i mbeturinave dhe kërkon që të shkojnë ta heqin, por nuk është e mundur me qenë 100% në çdo vend, po duhet me bërë përpjekje.

**Fadil Gashi, Kryesues:** Mirë, dikush tjetër? Nëse s'ka, kush është për ta rekomanduar për Kuvend?

**-Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të Draft-Planit Komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027, me 5 vota për, rekomandoi që të kalojë për shqyrtim në Kuvend dhe të merret vendim për vënie në diskutim publik.**

**Pika 10. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Klinës për vitin 2023.**

**Fadil Gashi, Kryesues:** Edhe këtë po besoj që e keni pranuar pak më me vonesë, por besoj që e keni dhe sot po e debatojmë. Unë po hap debat rreth kësaj, është një plan bukur i mirë, këtu i kanë përshkruar përgjegjësitë që i kanë, përgjegjësitë veç i dimë, por çka kanë me bërë për këtë vit është dashur ta shkruajnë, plani këtë e ka, e jo çka ka përgjegjësi. Unë po hap debat rreth Planit të ekzekutivit, nëse ka dikush, urdhëroni?

**-Pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota për, rekomandoi që Plani i Punës së Ekzekutivit për vitin 2023 të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Fadil Gashi, Kryesues:** Me kaq po e përfundoj, faleminderit të gjithëve për pjesëmarrje dhe për angazhim!

**Procesmbajtësja,  
Monika Palushi**

**KRYESUESI,  
Fadil Gashi**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-klina.org](http://www.komuna-klina.org)

---

## **RAPORTI I PUNËS SË EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS SË KLINËS PËR VITIN 2022**

## **Përmbajtja:**

<b>1. Hyrje.....</b>	<b>3</b>
<b>2. Drejtoria e Administratës.....</b>	<b>4</b>
<b>3. Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.....</b>	<b>17</b>
<b>4. Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.....</b>	<b>38</b>
<b>5. Drejtoria e Arsimit.....</b>	<b>42</b>
<b>6. Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.....</b>	<b>51</b>
<b>7. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.....</b>	<b>54</b>
<b>8. Drejtoria e për Punë Inspektuese.....</b>	<b>58</b>
<b>9. Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.....</b>	<b>63</b>
<b>10. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.....</b>	<b>67</b>
<b>11. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.....</b>	<b>80</b>



## 1. Hyrje

Në mbështetje të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Planit të Punës për vitin 2022, kam nderin që të paraqes raportin njëvjeçar të punës për periudhën 01 janar deri më 31 dhjetor 2022, i cili përfshinë punën njëvjeçare, të arriturat e komunës dhe vështirësitë me të cilat jemi ballafaquar gjatë vitit 2022.

Viti 2022 karakterizohet si vit me rritjen e madhe të çmimeve të artikujve të ndryshëm, ndër ta edhe materialit ndërtimor, por pavarësisht kësaj për ekzekutivin është një vit i realizimit të synimeve dhe objektivave të planifikuara sipas ligjeve aplikative në fuqi, në përputhje me strategjinë zhvillimore dhe aktet e tjera valide për zhvillimin dhe funksionimin më të mirë për komunën tonë.

Kryetari i komunës gjatë vitit 2022 ka mbajtur edhe shumë dëgjime të rregullta më publikun si dhe dëgjime për planifikimin buxhetor për vitin 2023 në qytet dhe në lokalitete të fshatrave në komunën e Klinës.

Gjatë vitit 2022 komuna ka pasur qëllimin e arritjes së këtyre objektivave:

- Administratë publike funksionale në shërbim të qytetarëve;
- Hapje e komunës ndaj qytetarëve;
- Avancimi i së drejtës për informim;
- Pjesëmarrje aktive e qytetarëve në vendimmarrje;
- Ruajtja e hapësirave publike;
- Avancimi i masave kundër ndotjes së ambientit;
- Mbrojtja e lumenjve dhe parqeve;
- Ngritja e kapaciteteve në infrastrukturë;
- Zhvillimi i bizneseve të vogla e të mesme dhe joshja e tyre për investime të reja;
- Subvencionimi në bujqësi;
- Ngritja e treguesve të cilësisë në shëndetësi, arsim, kulturë, rini e sport;
- Qasja në dokumente zyrtare;
- Llogaridhënia e zyrtarëve ndaj qytetarëve si dhe punë dhe aktivitete të tjera profesionale që dalin nga plani i punës i vitit 2022 dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- Realizim të të gjitha projekteve të planifikuara.

## **2. DREJTORIA E ADMINISTRATËS**

Raportin vjetor të punës për periudhën 1 janar 31 dhjetor 2022, i cili përmban punën dhe aktivitetet njëvjeçare të Drejtorisë së Administratës dhe njëkohësisht vështirësitë më të cilat jemi përballur gjatë vitit 2022. Me gjithë vështirësitë me angazhim është arritur të realizohen synimet dhe objektivat e parapara sipas ligjeve aplikative në fuqi, duke shënuar shumë të arritura dhe angazhime të administratës komunale, me qëllim që të arrihen objektivat e parapara në planin e punës për kushte sa më të mira për qytetarët e kësaj komune. Administrata komunale gjatë periudhës 2022 ishte funksionale dhe efikase në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe profesionale të qytetarëve, në riorganizimin profesional dhe reformimin krahas reformës së administratës publike, punën transparente me media, OJQ, shoqëri civile, duke ofruar qasje në dokumentet zyrtare, duke demonstruar qeverisje transparente dhe komunikim dhe qasje transparente me qytetarët.

Gjatë vitit 2022 komuna e Klinës ka pasur qëllim të arritjes së këtyre objektivave:

- Administratë publike në shërbim të qytetarëve,
- Hapje e Komunës për qytetarët,
- E drejta për t'u informuar, e cila është e drejtë e garantuar më ligj, e cila në Komunën e Klinës zbatohet dhe respektohet,
- Kthimi i besimit të qytetarët në institucionet publike përmes transparencës dhe qasjes së lehtë në shërbime komunale,
- Qytetarët të bëhen pjesë aktive e vendimeve të komunës,
- Klina më Platformë Digjitale për pjesëmarrje më publikun,
- Lajmërimi nga qytetarët për parregullsitë në çdo kohë dhe në çdo vend,
- Qasja në dokumentet zyrtare.

Prandaj, në pajtim të plotë më planin e veprimit për vitin 2022, besojmë që të gjitha obligimet që dalin nga këto plane dhe në përputhshmëri të plotë me ligjet aplikative në fuqi do t'i përmbushim edhe në vitin 2023. Drejtoria e Administratës për vitit 2022 ka realizuar punët sipas planit të punës së drejtorisë, duke ofruar shërbime për qytetarë nga të gjitha zyrat me të cilat administrojnë, të specifikuar si më poshtë, janë kryer punët si në vijim:

### **SEKTORI I GJENDJES CIVILE DHE REGJISTRIMIT**

Nga Sektori i gjendjes civile dhe regjistrimit në periudhën raportuese janë bërë 1111 regjistrime të ndryshme: lindjes, martese dhe vdekjes; janë lëshuar gjithsej 39.316 lloje të certifikatave dhe akte tjera:

- Aplikacione për humbje të shtetësisë, 152;
- Aktvendime për regjistrim të mëvonshëm, ndërrim të emrit dhe mbiemrit, korrigjime 91.

Janë inkasuar taksa administrative nga sektori i gjendjes civile gjithsej 40.296,00 €.

Projektet e përfunduara kapitale gjatë vitit 2022.

- Rinovimi i objektit të komunës- Zyra e Kryetarit si dhe Zyra e Prokurimit.

## ZYRA E PROKURIMIT

Puna e Zyrës së prokurimit e themeluar në bazë të LPP dhe organogramit të komunës. Punën e vet e kryen bazuar në LPP 04/L-042 dhe rregulloreve në fuqi mbi prokurimin publik dhe Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike.

Zyra në afatin ligjor ka bërë planifikimin e PP, i cili është miratuar në Kuvendin \Komunal dhe është dorëzuar në APP.

Në vitin 2022 kemi iniciuar 123 procedura të prokurimit.

Vlera e tërësishme e buxhetit është 2.343.825.00 €.

Siç parashihet me nenin 9 të LPP është bërë planifikimi i prokurimit dhe i njëjti në bazë të kërkesave të drejtorive është miratuar edhe nga Kuvendit i Komunës që në bazë të llojit janë:

1. Inicime 123 procedura apo 32%
2. Kontrata të lidhura 123 procedura apo 26%
3. Kërkesa për qasje në dokumente 29 procedura apo 40%
4. Kërkesa për rishqyrtim 35 procedura apo 2%

Totali i planifikuar 119 procedura apo në vlerën e buxhetit 4.167.267.50 €.

- Procedimi:
  1. Janë iniciuar 139 procedura prokurimi apo 116%
- Llojet e prokurimit janë :
  1. Furnizime 32 procedura apo 18%
  2. Shërbime 30 procedura apo 25%
  3. Punë 42 procedura apo 35%
  4. Konkurse 2 procedura apo 0.2%
- Procedurat sipas vlerave të kontratave:
  1. Vlerë e madhe 2
  2. Vlerë e mesme 70
  3. Vlerë e vogël 37
  4. Vlerë minimale 14

- Procedurat e prokurimit:
  1. Procedurë e hapur 68
  2. E negociuar ( punë shtesë) 8
  3. Kuotimi 32
  4. Vlerë minimale 14
  5. Procedura të qiramarrjes 1

## ZYRA LIGJORE DHE E PËRFAQËSIMIT

Si në periudhat e viteve të mëparshme edhe gjatë vitit 2022 Zyra Ligjore dhe e Përfaqësimit, në bazë të ligjit dhe rregullativës ligjore ka kryer dhe përmbushur detyrat dhe përgjegjësit që i ka pasur në kompetencën e saj. Në kuadër të kompetencës së saj zyra ka kryer përfaqësimin e komunës në të gjitha shkallet e gjyqësorit në nivel vendi, duke përfshi tërë aktivitetin e përgjegjësisë së përfaqësimit gjegjësisht avokaturës shtetërore. Përveç përgjegjësisë së lartcekur Zyra Ligjore ishte edhe pjesë e të gjitha debateve dhe takimeve tjera me publikun që ishin mbajtur gjatë periudhës raportuese. Zyra Ligjore po ashtu ishte pjesë e të gjitha seancave të Kuvendit të Komunës. Më poshtë këtij raporti paraqitet tabelari i lëndëve gjyqësore të aktualizuara gjatë vitit 2022 si dhe më tutje edhe tabelari i seancave të mbajtura gjyqësore gjatë periudhës raportuese.

### Tabelari dhe komparacioni i lëndëve gjyqësore të aktualizuara-paraqitura gjatë vitit 2022 në raport me të njëjtën periudhë të vitit 2021

---

**I.**

**II.**

---

Gjithsej numri i lëndëve

Vërejtje

në tërë vitin 2022

(Janar-dhjetor)

---

**33**

Të gjitha lëndët e tilla janë në procedurë e e sipër të gjykatat kompetente.

---

Gjithsej numri i lëndëve

Vërejtje

në vitin 2021

(Janar-dhjetor)

---

Gjatë vitit 2022 duke filluar nga muaji prill janë paraqitur gjithsej 383 lëndë të reja që ndërlidhen me padite e personelit arsimor të komunës së Klinës e të cilat padi janë të mbështetura në kontratën kolektive sektoriale të arsimit të datës 18.04.2017 e që kërkesëpaditë e tilla kanë të bëjnë me kompensimin e shujtave ditore, shpenzimeve të udhëtimit si dhe kompensimin e diferencës në pagën bazë sipas kualifikimit-licencimit. Këto lëndë janë në procedim e sipër. Po ashtu, komuna e Klinës në gusht të vitit 2022 ka bërë 2 padi gjyqësore kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës-Ministrisë së Shëndetësisë dhe asaj të Arsimit, që kanë të bëjnë me kontratat kolektive sektoriale të arsimit dhe atë të shëndetësisë e me bazë juridike kompensimin e demit material, lëndë këto të cilat janë në procedim e sipër. Siç shihet nga krahasimet e periudhave raportuese, në vitin 2022 ishin aktualizuar gjithsej **33 lëndë të reja gjyqësore**, përderisa që ai numër i lëndëve në vitin 2021 ishte gjithsej **29 lëndë**. Nga kjo pasqyrë shihet se numri i lëndëve në vitin 2022 ishte më i madh për **4 lëndë**. Po ashtu, me poshtë mund të shihni numrin e seancave të mbajtura nga gjykata. Sa i përket shqyrtimeve gjyqësore dhe seancave gjyqësore të mbajtura te gjykatat e vendit gjatë tërë vitit 2022 janë mbajtur gjithsej **172 seanca të shqyrtimeve gjyqësore** duke përfshirë ato përgatitore dhe ato të rregullta. Në krahasim më vitin paraprak 2021 që ishin mbajtur **171 seanca gjyqësore** del diferenca që në vitin 2022 janë mbajtur 1 seanca më shumë.

**Tabelari dhe komparacioni i seancave gjyqësore të mbajtura gjatë tërë vitit 2021 në raport me të njëjtën periudhë të vitit 2020**

---

**I.**

**II.**

---

Gjithsej numri i seancave  
në vitin 2022  
(Janar-dhjetor)

Vërejtje

---

**172**

---

Gjithsej numri i seancave  
në vitin 2021 (Janar-dhjetor)

Vërejtje

---

**171**

---

Zyra ligjore dhe Përfaqësimit si në të gjitha vitet e mëparshme ka përfaqësuar komunën edhe në nivelet ministrore sa i përket përfaqësimit të lëndëve konkrete administrative, ku ka lind nevoja, po edhe të këshillimeve përkatëse për të gjitha çështjet juridike. Në këtë drejtim zyra ka marr pjesë në disa takime online si dhe disa me prezence fizike të organizuara nga Asociacioni i Komunave të Kosovës që kanë të bëjnë më zyrtarët ligjor. Kjo është me rëndësi të ceket se në ato takime behën përpykjet e unifikimit të veprimeve dhe të gjitha procedurave ligjore në nivel vendi.

Zyra Ligjore po ashtu në kuadër të kompetencave të veta gjatë tërë vitit 2022 ka lëshuar edhe akte të tjera juridike, si për Zyrën e Kryetarit të Komunës po ashtu edhe për tërë ekzekutivin komunal, si: vendime, urdhëresa, pëlqime, ka hartuar marrëveshje të ndryshme, autorizime, shkresa dhe akte të tjera të cilat radhitën si në vijim:

Sipas kërkesave për subvencionim me rastin e lindjes se fëmijëve gjatë vitit 2022 janë aprovuar 349 vendime për 354 fëmije të lindur, nga të cilat, 117 vendime për lindjen e parë, 104 vendime për lindjen e dytë, 80 vendime për lindjen e tretë, 37 vendime për lindjen e katërt, 12 vendime për lindjen e pestë, 3 vendime për lindjen e gjashtë si dhe 1 vendim për lindjen e shtatë, ndërsa 3 kërkesa janë refuzuar me vendime si të pabazuara. Për kompensimin e shpenzimeve të varrimit gjatë vitit 2022 janë aprovuar 206 kërkesa, ku për këto janë lëshuar 206 vendime. Për ndihmë shëndetësore momentale-subvencionime sipas kërkesave janë aprovuar 97 vendime, si dhe janë hartuar 72 vendime të natyrave procedurale të ndryshme 10 nga të cilat me karakter të përgjithshëm. Në total gjatë vitit 2022 hartuar 730 vendime, 27 kërkesa, 10 autorizime, 4 marrëveshje, 18 kontrata, 4 pëlqime, 12 lista, 10 përgjigje, 3 njoftime, 1 padi, 3 ankesa, 6 mendime juridike si dhe disa shkresa përcjellëse.

Për të gjitha kërkesat dhe aktet tjera zyrtare të cilat janë futur në shërbimin e intranetit të Zyra e Kryetarit si te Zyra Ligjore dhe Përfaqësimit ka menaxhuar me statusin e lëndëve lidhur me vendosjen e tyre nga organet kompetente. Në kuadër të aktiviteteve tjera ligjore zyra po ashtu ka ofruar të gjitha këshillat e nevojshme dhe të kërkuara nga strukturat tjera të administratës komunale. Për përfundim mund të konkludojmë se Zyra Ligjore dhe e Përfaqësimit gjatë vitit 2022 ka pasur një aktivitet më të shtuar në përmbushjen e kompetencave ligjore të saja në respektim të ligjit.

## **SHËRBIMI PËR PUNË TË KUVENDIT**

Shërbimi për punë të Kuvendit për vitin 2022 ka përgatitur materialin për 11 seanca të rregullta, 2 seanca të jashtëzakonshme dhe 1 seancë solemne, debate me publikun janë mbajtur 3, gjatë periudhës janar dhjetor 2022 janë miratuar 65 vendime, 5 plane të punës nga aktet e miratuara në kuvend pas vlerësimit të ligjshmërisë 6-janë kthyer në rishqyrtim dhe një plan veprimi të cilat brenda afatit prej 30 ditësh janë rishqyrtuar në Kuvend dhe janë dërguar për konfirmim të ligjshmërisë. Projekt- rregulloreve komunale për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale në kohëzgjatje deri në një vit, janë miratuar vendime dhe rregullore të K.K. Klinës, janë shqyrtuar dhe miratuar raporte financiare, të gjitha vendimet dhe rregulloret janë dërguar për konfirmim të ligjshmërisë në afat të caktuar në MAPL.

Komiteti për Politikë e Financa ka mbajtur 10 ( dhjetë ) takime.

Komiteti për Komunitete 8 ( tetë ) takime.

Komiteti për Arsim, Kulturë Rini dhe sport 3 ( tri ) takime.

Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale 3 ( tri ) takime.

Komiteti për Shërbime Publike 2 ( dy ) takime.

Komiteti për Pronë 4 ( katër ) takime.

Komiteti për Planifikim Urban, Ekonomi dhe Zhvillim 1 ( një ) takim.

Komiteti për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Komiteti për çështje Emergjente janë zhvillu procedurat dhe janë themeluar këto dy Komitete pasi që anëtareve të mëhershëm ju ka skaduar mandati.

Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi (KKSB) 6 takime.

Takime me qytetarët – Kryetari ka mbajtur 2 takime.

### **ZYRA PRITËSE-ARKIVA**

Nga Sektori i Zyrës Pritëse në periudhën raportuese gjatë vitit 2022 ka regjistruar, skanuar dhe evidentuar në librin intern sipas drejtorive:

1. Drejtoria e Administratës, gjithsej lëndë të regjistruara	1.186
2. Drejtoria për Shën. dhe Mirëqenies Sociale gjithsej lëndë të regjistruara:	33
3. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, gjithsej lëndë të regjistruara:	341
4. Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi gjithsej lëndë të regjistruara:	505
5 Drejtoria për Financa, gjithsej taksë te inkasuar:	832
6.Drejtoria e Arsimit, gjithsej lëndë të regjistruara:	1.865
7.Drejtoria e Bujqësisë, gjithsej lëndë të regjistruara:	1.694
8.Drejtoria e Shërbimeve Publike, gjithsej lëndë të regjistruara:	473
9.Drejtoria e Urbanizmit, gjithsej lëndë të regjistruara:	950
10.Drejtria i Inspektoratit gjithsej lëndë të regjistruara:	297
11.Asambeja, gjithsej lëndë të regjistruara:	305
12. Presidenca, gjithsej lëndë të regjistruara:	1.288
13.Zyra e Prokurimit, gjithsej lëndë të regjistruara:	363
14. Zyra për kthim dhe komunitete, gjithsej lëndë të regjistruara:	93
15. Zyra Ligjore:	399

Totali i lëndëve të regjistruara për vitin 2022 është 11.158 lëndë

Vlera totale e taksave të inkasuara për vitin 2022 është 2.090.61 €

Ky sektor përpos kësaj janë regjistruar edhe vërtetuar, përshkrime dhe dorëshkrime gjatë kësaj periudhe edhe kërkesa të palëve. Ky sektor përpos kësaj që u cek më lartë në regjistrin e vërtetimeve, përshkrimeve dhe dorëshkrimeve gjatë kësaj periudhe ka lëshuar edhe vërtetime, deklarata etj., me kërkesë të klientëve . Në Librin e postës janë regjistruar dërgesa, të cilat janë dorëzuar PTK-së në Klinë. Në regjistrin e postës në vend janë regjistruar shkresa të dala nga KK, të cilat janë shpërndarë në teren, te gazetave zyrtare.

## ZYRA E INFORMIMIT

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publik gjatë vitit 2022, në kuadër të komunës së Klinës, i ka mbuluar të gjitha aktivitetet që janë zhvilluar në komunë. Në vazhdimësi kemi lëshuar komunikata për media për të gjitha aktivitetet që janë zhvilluar në komunën e Klinës, në ueb faqen e komunës si në facebook. Përmes ueb faqes, qytetarët janë informuar për çdo ngjarje në kohë. Po ashtu, përmes postimeve të vazhdueshme dhe në kohë në ueb faqe si dhe në facebook të komunës së Klinës, kemi vërejtur se interesimi i qytetarëve për ti përcjellë zhvillimet komunale secilin vit është duke u rritur, dhe kemi kërkesa që na drejtohen po nga mesazhet e facebookut, të cilat përcillen tek sektorët përkatës. Sektori mban kontakte të rregullta me përfaqësuesit e mediave, koordinon aktivitetet mediale të përfaqësuesve të komunës, ndërmjetëson në caktimin e intervistave të udhëheqësve komunalë për shtypin, monitoron mediat dhe informon kryetarin dhe drejtuesit e tjerë në lidhje me përmbajtjen e tyre.

Më tej, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun mirëmban uebfaqen e Komunës, duke publikuar të gjitha njoftimet për mbledhjet, informatat nga takimet e Kryetarit të Komunës, Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, planet dhe raportet e Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, si dhe koordinon publikimin e shpalljeve, konkurseve dhe tenderëve si dhe të gjitha informatat dhe publikimet tjera me rëndësi për qytetarët dhe opinionin e gjerë. Zyra për Informim që nga muaji janar e deri më tani ka rritur të mbuloj në teren rreth **184 ngjarje**, që përfshijnë vizita, takime e evenimente të ndryshme të të gjitha dikastereve institucionale të cilat janë shpalosur me kohë për publikun dhe mediat. Uebfaqja e Komunës së Klinës mbetet kanali më i rëndësishëm i komunës për komunikim zyrtar me audiencat e jashtme. Faqja zyrtare në internet po mirëmbahet rregullisht dhe po shërben si një burim i rëndësishëm dhe i besueshëm i informimit për qytetarët komunës dhe palët tjera të interesuara. Në periudhën e lartcekur në ueb faqe janë populluar rreth **220 njoftime**, ku shumica prej tyre lidhen me konkurset, thirrjet publike, rezultate, njoftime për programe, lista etj. Në kuadër të kategorisë së prokurimit publik, janë bërë publike 256 aktivitete të prokurimit dhe 109 kontrata publike. Në vitin 2022 komuna ka filluar transmetimin online të seancave të rregullta të punës së Kuvendit komunal. Në kategorinë dokumente janë publikuar 23 dokumente që janë plane të punës dhe plane veprimi, strategji, aplikacione etj. Rol të rëndësishëm kanë edhe kërkesat e qytetarëve në Qasjen e Dokumenteve Publike, ku përveç raportit vjetor të “Agjencia për Informim dhe Privatësi”, raportin e protokolluar e plasoj edhe në ueb faqe të komunës. Kur jemi te raportit i fundit në Qasjen e Dokumenteve Publike, janë gjithsej 40 kërkesa, ku 37 kanë marr përgjigjeje ndërsa 1 është duke u shqyrtuar brenda afatit ligjor, 2 janë pa përgjigjeje. Raporti është punuar sipas ligjit Qasjen e Dokumenteve Publike i cili është në fuqi.

Zyra për Informim ka luajtur një rol të rëndësishëm sa i përket mbledhjes dhe raportimit të të dhënave në Raportin e Përformancës Komunale 2021, duke përmbushur tre kategori me mbi 60 të dhëna. Në avancimin tutje të transparencës komunale, zyra për Informim ka dhënë 7 rekomandime, tashmë të realizuar e të cilat do të luaj një rol poentues në raportin e performancës si dhe raportin e përmbushjes së obligimeve të komunës ndaj agjendës evropiane. Sfidë mbetet mungesa e burimeve njerëzore në Zyrën për Informim si dhe nevoja për tu trajnuar në fushat e marketingut digjital, mbi përdorimin efikas të platformave sociale (FB, Insatgram, YouTube), për personelin në ZIMP, për mobilizim dhe aktivizim të audiencës në formatet më bashkëkohore.



## **NJËSIA PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE ZBGJ-RE**

Zyra për Barazi Gjinore gjatë këtij është preokupuar në realizimin e plotë të punëve të planifikuara dhe mund të konstatojmë se ka qenë një vit shumë i suksesshëm. Qëllimi i Z.B.GJ ishte promovimi i të drejtave të barabarta të grave dhe dhuna në familje; Zbatimi dhe monitorimi i Ligjit kundër dhunës në familje; Ngritja e vetëdijes për dhunë në familje; Mbështetja e infrastrukturës për mbrojtjen dhe integrimin e viktimave të dhunës; Nxitja dhe vetëdijesimi i grave ,vajzave mbi të drejtën e trashëgimisë; Aktivitetet për shënimin e Ditëve Ndërkombëtare, etj., Të gjitha aktivitetet janë bërë në koordinim me A,B,GJ, Drejtorit Komunale, Shoqëritë Civile dhe OJQ- të të cilat kanë qenë shumë aktive, ndërsa përkrahja me e madhe ishte angazhimi dhe prania e nënkryetares së komunës në çdo aktivitet të realizuar gjatë vitit 2022. Pasi që Qeveria e Kosovës këtë vit e ka shpall vit të personave me aftësi të kufizuar. Komuna jonë ka marrë vendim për formimin e Këshillit Komunal për Persona me Aftësi të Kufizuara prej 9 anëtareve, ku kryesuese e këtij Këshilli jam unë si zyrtare për barazi gjinore. Qëllimi i këtij Këshilli është mbështetja e grupeve të marginalizuara, kërkesa e gjithë grupit ishte që 15 personave të njëjtë grup të ju mundësohet një praktik 2 ditore në komunë që të shohin dhe njoftohen për së afërmi me punët e administratës komunale, duke i stimuluar me një shumë prej 50 €. Këtë vit është formuar edhe Grupi i Grave Avokuese ku qëllimi i këtij grupi është fuqizimi ekonomik të grave dhe vajzave në Komunën e Klinës. Ky grup e ka punuar strategjinë dhe planin e punës për tri vitet e ardhshme ku shpresojmë se ky plan do të ketë sukses në fuqizimin ekonomik. Në këtë raport janë përfshirë aktivitetet e realizuara qoftë trajnime/punëtori, tryezë, fushata etj., me përshkrime të shkurta, të cilat janë gjithsej 30 aktivitete.

### **ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE**

Aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2022:

-Në janar kamë përcjellur në MAPL Raportin për përmbushjen e obligimeve të Komunës së Klinës nga agjenda Evropiane e vendit për periudhën Janar – Dhjetor 2021;

-Në janar kamë dërguar Drejtorit Raportin vjetor të punës për vitin 2021;

-Me MAPL-në në vazhdimësi komunikojmë për informime dhe koordinime të ndërsjella , sipas kërkesës i janë përcjellur disa nga planet dhe strategjitë Komunale, gjithashtu kam marrë pjesë në takimet online të organizuara për ZKIE-të.

-Në shkurt, kam dërguar në MAPL Raportin mbi përmbushjen e obligimeve të Komunës së Klinës ndaj Agjendës Evropiane, për periudhën janar-qershor 2021.

- Pas dërgimit të raporteve të komunave MAPL Draft - Raporti i përmbushjes së obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar – Dhjetor 2021, si dhe kam përcjellë rekomandimet e dhëna për Komunën e Klinës nga Agjenda Evropiane.

-Në muajin Prill sipas kërkesës së MAPL-së kam dërguar të dhënat nga Komuna e Klinës për Marrëveshjet e binjakëzimit me komunat dhe marrëveshjet ndërkomunale me komunat vendore për periudhën 2010-2021.

-Në qershor kam filluar me komunikimet dhe mbledhjen e të dhënave për raportin gjashtëmuhor.

-Në fillim të korrikut kam dërguar raportin mbi përmbushjen e obligimeve nga Agjenda Evropiane e Komunës së Klinës për periudhën janar - qershor 2022.

Rekomandimet nga Raporti i përmbushjes së obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për Komunën e Klinës janë:

1. Të hartohet Strategjia kundër dhunës në familje;
2. Të hartohet Plani Lokal për Integritet;
3. Të hartohet Plani tre-vjeçar për strehim Social;
4. Të hartohet Plani për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore;
5. Të hartohet Plan Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
6. Të hartohet Plani Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar;
7. Të miratohet Plani për Menaxhimin e tokave rurale;
8. Të hartohet Plani i veprimit për cilësinë e ajrit;
9. Të themelohet dhe të funksionalizohet Ekipi Vepruese për Siguri (EVS);
10. Të themelohen Këshillat në Fshatra;
11. Të caktohet zyrtari për mbrojtjen nga diskriminimi;
12. Të caktohet zyrtari që raporton për planin për integritet;
13. Të caktohet zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës;
14. Të hartohet Plan Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
15. Të hartohet plani për Eficiencë të Energjisë;
16. Të hartohet plani për menaxhimin e mbeturinave;
17. Të hartohet Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian;
18. Të caktohet koordinatori që monitoron dhe raporton lidhur me planin për integritet;
19. Të organizohen fushata vetëdijësuese për mbrojtjen e tokave bujqësore dhe promovimin e rëndësisë së tokave bujqësore;
20. Të organizohen fushata vetëdijësuese për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve;
21. Të organizohen fushata me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së mjedisit;
22. Të ndërmerren aktivitete në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut;
23. Të themelohet Këshilli komunal për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në baza gjinore;
24. Të themelohet komiteti lokal për zbatimin e Strategjisë për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian;
25. Të funksionalizohet Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuar.

## **ZYRA PER TEKNOLOGJI INFORMATIVE**

Gjatë kësaj periode janë kryer punët si në vijim: Është përkrahur stafi i administratës komunale në aspektin e teknologjisë informative, duke përfshirë intervenime në pajisje e TI-së dhe pajisje tjera periferike për të mbarëvajtur punët në normalitet, të jenë sa më efikas për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Shërbimi i IT-së ka bërë instalimin e kompjuterëve të rinj të cilët janë blerë nga administrata për gjatë vitit 2022 duke instaluar softuer të nevojshëm me konfigurimet e nevojshme konform udhëzimeve administrative dhe ligjeve në fuqi si dhe ku ka qenë e nevojshëm i janë bartur shërbimet nga pajisjet e vjetra në pajisjet e reja. Në këtë pikë konsideroj që Komuna e Klinës e ka të nevojshëm që të ngritë kapacitetet e pajisjeve të IT-së sidomos për kompjuter ku në disa shërbime ka kompjuter që janë aktive duke punuar rreth 10 vite dhe me rekomandimet nga Microsoft për të kaluar në sistemet e fundit operative pasi që tani edhe Uindoës 7 dhe 8.1 nuk ka me support është e pamundur që të realizohet një gjë e tillë pa blerjen e kompjuterëve të rinj dhe kjo është e nevojshme që rreth 15% e kompjuterëve të zëvendësohen me të rinj. Në fillim të kësaj periudhe janë gjëndëruar raportet nga sistem i intranetit për lendet te cilat janë gjëndëruar nga sistemi si dhe nga ky shërbim është bërë edhe raportimi për MAPL-në në tre indikatorët e parë të vlerësimit të performances, Janë bërë të gjitha përditësimet e sistemeve të brendshme që ofrojnë shërbime për qytetaret dhe për stafin komunal në përputhje me udhëzime administrative nga agjencioni i shoqërisë së informacionit si dhe rekomandimet e prodhuesve. Po ashtu, gjatë këtij viti është bërë edhe përkrahja në aspektin teknik për Zyrat e Gjendjes Civile në teren ku janë bërë intervenime në distanca por në bazë të nevojave është bërë edhe intervenim lokal që të jenë funksionale të gjitha zyrat si në aspektin e lidhjeve VPN po ashtu edhe në funksionalitetin e pajisjeve si kompjuter, monitor, printer, fotokopjues dhe skaner. Gjatë këtij viti është përkrahur zyra e informimit për publikimin e materialeve në ueb faqe. Për vitin 2022 janë bërë të gjitha përditësimet e sistemeve të brendshme me rekomandimet e Microsoft-it dhe ASHI-së. Po ashtu, janë kryer edhe punë të tjera me kërkesë nga eprori që kanë ndërlidhje me TI-në.

## **ZYRA E PRANIMIT TË MALLIT**

Nga ky sektor është kryer puna e pranimit të mallit, të gjitha hyrjet dhe daljet e materialeve shpenzuese dhe kompjuterëve, printerëve, fotokopjeve e materiale tjetër shpenzuese. Gjithashtu janë kryer edhe raporte të pagesave në free-balanc.

## **ZYRA E PËRKTHIMEVE**

Është përgjegjës për punët në lëmin e përkthimeve nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas.

Gjatë vitit 2022 kjo Zyrë ka zhvilluar gjithsej:

- Njoftime ( Kuvendi, Komiteti i Komuniteteve, KKSB dhe komiteteve tjera 65 ( 120 faqe)
- Vendime të Kuvendit Komunal 60 ( 130 faqe)
- Ftesa për debate të ndryshme Publike 10 ( 20 faqe)
- Procesverbale të takimeve të ndryshme 90 ( 450 faqe)
- Konkurse 15 ( 25 faqe)

- Kërkesa, vërtetime, Plane Pune-Veprimi, strategji

80 ( 250 faqe)

TOTAL

320 ( 995 faqe A4 )

Përveç të cekurave, janë bërë përkthime në takime të ndryshme si në takimet e Komitetit të Komuniteteve ( 11 ), KKSb-së ( 6 ), takime me OJQ dhe me Komunitete ( 10 ). Në total, në takime të tilla janë rreth 80 orë përkthimi.

## ZYRA E PERSONELIT

Gjatë vitit 2022 kjo zyrë ka zhvilluar gjithsej:

- |  |             |
|--|-------------|
| • Konkurse, procedurë e brendshme                        | 1           |
| • Procedurë e avancimit                                  | 1           |
| • Konkurse të jashtme, procedura                         | 10          |
| • Vendime për pushime vjetore, janë lëshuar              | 1           |
| • Përgjigjeje në ankes KPMKSHC-së                        | 17          |
| • Raporte për MAPL-MAP, gjatë vitit 2022 sipas kërkesave | 2           |
| • Janë miratuar gjithsej                                 | 1.520 lëndë |
| • Konkurse në Shëndetësi                                 | 6           |
| • Konkurse ne Drejtorin e Arsimit                        | 20          |
| • Vendime për ndërprerje të punës ( Pensionim)           | 7           |
| • Trajnime të zhvilluara                                 | 32          |
| • Vendime për pushime të lehonisë                        | 1           |
| • Ndërprerje vullnetare e punës                          | 3           |

## SEKTORI TEKNIK – LOGJISTIKA

Nga ky Sektor është gjatë vitit 2022 me sukses janë kryer: Ruajtja e Objektivit të Komunës, organizimi i punës me palë, mirëmbajtja e pastërtisë, mirëmbajtja e ngrohjes, përcjellja e shpenzimeve të derivateve, mirëmbajtja e veturave zyrtare, përcjellja e shkresave për organe dhe palët dhe pune tjera sipas nevojës.

## NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Për periudhën raportuese për vitin 2022, sipas planit të punës të NjAB, kanë qenë të parapara 4 (katër ) auditime të cilat janë zhvilluar në disa njësi organizative – drejtori në kuadër të komunës.

Këto auditime janë kryer që të gjitha në pajtueshmëri me planin e aprovuar vjetor të Njesisë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2022, krejt kjo në bazë të nevojave reale dhe gjendjes së analizuar nga Auditorët, Komiteti i Auditimit dhe menaxhmenti i Komunës, që si qellim parësor kanë mbështetjen e organeve të administratës së nivelit komunal, zhvillimin dhe fuqizimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të financave publike në komunë.

**Gjatë vitit 2022 nga Njësia e AB janë realizuar auditimet dhe punët si në vijim:**

1. Menaxhimi i objekteve, banesave dhe lokaleve afariste në pronësi të komunës për vitin 2021.
2. Shpenzimet në drejtorinë e Shërbimeve Publike për vitin 2021, Janar – Qershor 2022.
3. Shërbimet tjera kontraktuese, shpenzimet për vitin 2022.
4. Shpenzimet për investime kapitale për vitin 2022.

**Nga auditimet e përfunduara për vitin 2022, gjendja statistikore e objektivave, të gjeturave dhe rekomandimeve është kjo:**

- Janë përcaktuar 14 objektiva të shpërndara në 4 auditimet e përfunduara.
- Të gjeturat nga auditimet e përfunduara për vitin 2022 janë 44 dhe të cilat janë vlerësuar si rrezik për funksionim në temat të cilat kanë qenë të audituara.
- Nga auditimet e përfunduara janë dhënë 29 rekomandime, me qellim të përmirësimit të të gjeturave dhe punës nga subjektet e audituara.

**Krahas auditimeve të përfunduara nga NjAB janë kryer edhe punë tjera si:**

- Përgatitja e Planit Strategjik për Njësinë e Auditimit të Brendshëm për periudhën trevjeçare 2023- 2025.
- Përgatitja e Planit vjetor për Njësinë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2023.
- Përgatitja e 4 Planeve të auditimit të punës për secilin auditim të veçantë, me formularët e duhur përcjellës.
- Përgatitja e raporteve 6 mujore dhe raportit vjetor të punës për NjQHAB dhe Kryetarin e Komunës.
- Përgatitja e 4 Planeve të Veprimit të Menaxhmentit për implementimin e rekomandimeve.
- Përgatitja e Orareve përcjellës të rekomandimeve për monitorim nga auditimi i brendshëm për të gjitha auditimet e përfunduara për vitin 2022.
- Mbajta e takimeve të rregullta me Komitetin e Auditimit.
- Bashkëpunimi me Auditorët e Jashtëm rreth punës së NjAB dhe ofrimi i shënimeve të cilat janë kërkuar nga ana e tyre.
- Përcjellja e trajnimeve që kanë të bëjnë me auditimin e brendshëm që është obligative për të mundur të ushtrosh punën e Auditorit dhe për vazhdimin e licencimit.
- Konsultime me menaxhmentin lidhur me auditimet.
- Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna për menaxhmentin dhe sektorët e veçanta.

- Konsultime profesionale me NjQHAB.
- Janë kryer edhe konsultime duke dhënë rekomandime gojore tjera me ekzekutivin dhe punëtorët e administratës sipas nevojës dhe kërkesave.

### **ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIMIT**

Gjendja e Sigurisë gjatë vitit 2022: Sa i përket gjendjes së sigurisë janar – dhjetor 2022 në Komunën e Klinës lëvizja e qytetarëve është e lirë dhe në nivel të kënaqshëm. Nuk ka asnjë eksces në lëvizjen e lirë të të komuniteteve pakicë në Komunën e Klinës. Përveç këtyre, Zyra ka kryer punët e saj të përditshme në terren si dhe përcjelljen e gjendjes dhe nevoja të të kthyerve si dhe punët brenda Zyrës.

### **3. DREJTORIA E FINANCAVE, EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT**

#### **Përmbledhje**

Në fillim të vitit 2022, gjatë hartimit të planit të punës së Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim kishim përcaktuar disa objektiva për t'i realizuar. Prej tyre ndër me të rëndësishmet ishin:

1. Ngritja dhe përmirësimi i inkasimit të të hyrave vetanake,
2. Menaxhimi efikas dhe transparent i buxhetit të komunës së Klinës për vitin 2022,
3. Përgatitja dhe hartimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve buxhetore 2023-2025 dhe propozim buxhetit për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitin 2023 dhe 2025,
4. Marrja e masave për përkrahjen dhe mbështetjen e bizneseve lokale të komunës së Klinës.

Po mbi bazën e këtyre katër objektivave, për secilin objektiv ne kishim përcaktuar një numër nënobjektivash si dhe një plan operativ të afatizuar dhe me veprime konkrete për realizimin e planit të punës për vitin 2022 dhe tani kur po bëjmë bilancin e të arriturave, përkatësisht raportin e punës së drejtorisë për vitin 2022, mund të konstatojmë se kemi arritur të realizojmë një pjesë të këtyre pritjeve të cilat i kemi parashtruar me planin e punës për vitin 2022.

1. Nëse fillojmë me objektivin e parë, përkatësisht inkasimit të të hyrave vetanake të komunës, si një nga burimet e rëndësishme të buxhetit komunal, gjatë vitit 2022 ka vazhduar trendi i mirë i inkasimit të të hyrave vetanake sikurse edhe në vitin 2021, por edhe pse kemi pasur vështirësi me inflacionin që goditi vendin, kemi arritur që të hyrat komunale t'i realizojmë dhe ta tejkalojmë planifikimin e paraparë, kjo falë angazhimit permanent të të gjithë faktorëve relevant të komunës.

Në këtë mënyrë po pasqyrojmë periudhat vjetore të realizimit të të hyrave sipas viteve siç vijon:

- **Të hyrat vetanake të Komunës së Klinës në vitin 2018**

- Me donacione dhe participime 1.140.944,26 euro
- Pa donacione dhe participime 1.011.520,40 euro

- **Të hyrat vetanake të Komunës së Klinës në vitin 2019**

- Me donacione dhe participime 1.163.859,33 euro
- Pa donacione dhe participime 1.144.244,10 euro

- **Të hyrat vetanake të Komunës së Klinës në vitin 2020**

- Me donacione dhe participime 986,325.58 euro
- Pa donacione dhe participime 975,015.58 euro

- **Të hyrat vetanake të Komunës së Klinës në vitin 2021.**

- Me donacione, participime dhe gjoba 1,675,600,05
- Pa donacione, participime dhe gjoba 1.365.338,25

- **Të hyrat vetanake të Komunës së Klinës për vitin 2022**

- Me donacione, participime dhe gjoba 1,573,242.79
- Pa donacione participime dhe gjoba 1,206,618.11
- Vërejtje: Në totalin e THV në vlerë 1,573,242.79€ nuk janë përfshirë të hyrat nga gjobat dhe participimet e tremujorit të fundit, të cilat ende nuk janë ardhur nga MFT.

Trendi pozitiv i inkasimit të të hyrave edhe përkundër prezencës së pandemisë së Covid-19 dhe inflacionit global, kjo drejtori ka arritur rezultate të lakmueshme si në realizimin e të hyrave ashtu edhe në shpenzimin e tyre në harmoni me ligjet aplikative dhe planin e punës për vitin 2022.

2. Sa i përket objektivit të dytë që ka të bëjë me menaxhimin e buxhetit, rregullisht është monitoruar dhe analizuar ekzekutimi i buxhetit nga programet buxhetore komunale (drejtoritë komunale). Në vazhdimësi janë propozuar masa përkatëse në drejtim të përmirësimit të menaxhimit dhe transparencës në shpenzimin e buxhetit të komunës.

Drejtoritë komunale janë njoftuar rregullisht me rrjedhat dhe progresin e zbatimit të buxhetit, me vlerat e shpenzuara të buxhetit dhe vlerën e mjeteve në dispozicion. Është kërkuar nga drejtorët e drejtorive që shpenzimi i buxhetit të jetë sa më racional, që të mos kemi tejkalime buxhetore por as teprice mjeteve për pasojë të menaxhimit jo të mirë të mjeteve, dhe kjo në veçanti sa i përket projekteve kapitale. Janë përgatitur dhe realizuar disa kërkesa për rialokim dhe transfer të mjeteve ndërmjet dhe brenda programeve buxhetore komunale me qëllim të ndarjes së mjeteve buxhetore për përballimin e pasojave të pandemisë, por edhe për shfrytëzimin sa më racional të parave publike si rezultat i procedurave të tenderimit për projektet kapitale.

3. Një objektiv tjetër gjatë vitit 2022 që zhvillohet në formë të një procesi të rregullt buxhetor, përkatësisht një cikli vjetor buxhetor ka qenë përgatitja dhe hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore(KAB) 2023-2025, që ka filluar në muajin prill dhe është finalizuar në muajin qershor 2022 me aprovim nga ana e Kuvendit komunal. Si përgatitja dhe dorëzimi në Kuvendin Komunal i draft buxhetit për vitin 2023 si dhe vlerësimet e hershme për vitin 2024 dhe 2025 në fillim të shtatorit dhe që është shqyrtuar dhe aprovuar në fund të muajit shtator 2022.

Procesi buxhetor është zhvilluar me muaj të tërë, përkundër gjendjes së krijuar nga pandemia dhe inflacioni global si dhe janë mbajtur një numër debatesh publike me qytetarë duke respektuar rekomandimet dhe masat për mbrojtje nga pandemia nga ana e Institutit të Shëndetësisë. Kemi mbajtur 15 dëgjime me publikun që kanë dhënë rezultate shumë pozitive, ku janë marrur për bazë në hartimin e buxhetit për vitin 2023. Sa i përket përgatitjes dhe raportimeve financiare, si drejtori kemi përgatitur raporte të rregullta financiare tremujore dhe kemi raportuar në mënyrë të rregullt në Kuvendin Komunal si dhe jemi në përgatitje të raportit përfundimtar vjetor financiar për vitin 2022.

4. Lidhur me objektivin e katërt, gjatë vitit 2022 është zhvilluar edhe një aktivitet në drejtim të informimit të bizneseve lidhur me mundësitë e ofruara për financim të aktiviteteve biznesore nga grantet, donacionet dhe formave tjera të përkrahjes nga ministritë përkatëse të Qeverisë së Kosovës dhe organizatave të ndryshme joqeveritare që kanë programe dhe ndajnë mjete në përkrahje të bizneseve. Gjithashtu në vitin 2022 janë ndihmuar disa biznese që janë dëmtuar nga vërshimet e fundvitit 2022, nga subvencionet nga zyra e kryetarit që janë zbatuar nga Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.



Ndër aktivitetet dhe sukseset e arritura gjatë vitit 2022 mund të përmendim edhe këto:

Kemi vazhduar me pagesën e pagave përcjellëse të mësimdhënësve dhe profesorëve të pensionuar, si obligim ligjor në bazë të kontratës kolektive të Qeverisë së Kosovës dhe SBASHK-ut për vitet paraprake si edhe për periudhën vijuese, të cilin aktivitet gati e kemi përmbyllur deri në fund të vitit 2022. Një numër të rekomandimeve të raportit të auditimit të jashtëm kemi arrit ta zbatojmë plotësisht dhe për disa të tjera jemi në proces të zbatimit të tyre.

Aktivitetet administrative të punëve të përditshme të realizuara në Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim:

Sa i përket aspektit të angazhimeve të stafit të drejtorisë në realizimin e punëve administrative dhe detyrave të përditshme të punës, ato janë kryer në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, me Statutin Komunal, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, Ligjin mbi Financat Lokale, Ligjin e Tatimit në Pronën e Paluajtshme dhe udhëzimeve administrative nga Qeveria Republikës së Kosovës në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi që dalin nga to dhe bazuar në planin e punës së aprovuar nga Kuvendi Komunal për vitin 2022, siç vijon:

- Janë përgatitur dhe janë lëshuar 1550 aktvendime për biznese që operojnë në Komunën e Klinës për ushtrim të veprimtarive afariste, të cilat janë bazuar në Rregulloren Komunale Mbi Ngarkesat, Tarifat, Gjobat dhe Taksat Komunale.
- Këto aktvendime janë lëshuar në kohën e përcaktuar sipas këtyre akteve ligjore dhe nënligjore, duke i dërguar përmes postës të çdo obligues i këtyre taksave.
- Janë vendosur në procedura ligjore 05 ankesa të ushtruara nga obliguesit e këtyre taksave, duke i informuar ushtruesit e këtyre ankesave për epilogun e vendosjes së tyre.
- Janë lëshuar 17 kontrata për obliguesit e taksave komunale që nuk i kanë përmbushur obligimet e që kanë dëshiruar që ato obligime t'i kryejnë me marrëveshje të dakorduar mes obliguesit dhe drejtorisë përkatëse.
- Në këtë vit drejtoria ka lëshuar vërejtje me shkrim për bizneset që nuk i kanë përmbush obligimet e taksave.
- Në këtë vit janë marrur vendime në bazë të kërkesës së kësaj drejtorie në kuvend për lirim të qirave të kategorive sociale dhe organizatave të luftës si dhe qirave komunale të bizneseve, që vendimet e kuvendit janë ekzekutuar tërësisht nga kjo drejtori.
- Janë përgatitur 100 kërkesa për përmbarim, të cilat nuk janë dërguar të përmbaruesit për ekzekutim të obligimeve të pakryera me disa vite me radhë, si shkak i pandemisë dhe inflacionit si dhe respektimit të kalimit të afatit nga vërejtjet e lëshuara nga kjo drejtori por tani janë në proces të dërgimit.
- Në vitin 2022 janë regjistruar 95 biznese të reja.
- Shuarje të bizneseve kanë qenë 24 biznese.
- Ndryshime në biznese 42.
- Marrja e certifikatave të reja të bizneseve-ndërrime nga certifikatat 160.
- Lëshimin e aktvendimeve për zgjatje të orarit - 15 aktvendime.
- Leje për autotaxi - 76 leje.
- Leje për itinerar të autobusëve - 4 leje.

Raporte periodike tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore etj.

- Janë kryer të gjitha punët profesionale të planifikuara, si regjistrimi dhe raportimi i të gjitha të hyrave në organet lokale dhe ato qendrore, zotimi i të gjitha mjeteve buxhetore, pagesa e të gjitha taksave komunale, lëshimi i vërtetimeve për kryerje të obligimeve për qytetarët, certifikimi dhe shpenzimi i pagesave në zyrën e thesarit, regjistrimi i pasurisë komunale në FRIBALANCE, përgatitja e formularëve për ndryshim të pagave sipas kërkesave, tërheqja dhe menaxhimi i PTIKASH-it, si dhe shumë punë tjera profesionale sipas Planit të paraparë vjetor.

## **ZYRA E TATIMIT NË PRONË**

Zyra Komunale e Tatimit në Pronë për periudhën janar-dhjetor të vitit 2022 ka përmbushur relativisht mirë obligimet dhe detyrat që dalin nga Ligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr.06/L-005 dhe Rregullores Komunale të Tatimit në Pronë.

Janë përgatitur dhe rifreskuar të dhënat për printimin e rreth dhjetë mijë faturave të tatimpaguesve. I gjithë ky material i shtypur dhe i zarfuar iu është shpërndarë tatimpaguesve përmes Postes së Kosovës në bazë të kontratës.

Vlera e realizimit të tatimit në pronë në vitin 2022 është: 453,281.30€

Inkasimi për objekte dhe pasuri të paluajtshme edhe në këtë vit është i barabartë me vitin paraprak. Pra, sipas të dhënave Zyra Komunale e Tatimit në pronë ka siguruar më shumë se 35.5% të të hyrave direkte në buxhetin e Komunës së Klinës. Në vitin 2022 kjo zyrë ka kryer edhe shumë punë tjera si lëshimi i certifikatave, kartelave financiare, njoftime për tatimpagues jo të rregullt, faturave të rregullta për qytetarë, pra për persona fizik dhe persona juridik. Tatimpaguesve jo të rregullt ua kemi dërguar 205 letërkujtesa së bashku me shumën e obligimeve dhe mundësive ligjore për riprogramim të obligimeve si dhe masat tjera nëse nuk paguhen detyrimet e tatimit në pronë, kamata dënimi etj., do fillojnë edhe masat për mbledhje të detyrueshme. Kjo përfshinë pezullimin e shërbimeve komunale si dhe propozimin për mbledhjen e detyruar të detyrimeve të papaguara përmes përmbaruesve. Pas këtyre letërkujtesave është vërejtur një interesim i qytetarëve për pagim të detyrimeve apo lidhjes së kontratave për riprogramim të tyre. Janë shqyrtuar tridhjetë ankesa, pra ankesa ndaj faturës së tatimit në pronë si dhe ankesa ndaj certifikatës së vlerës së vlerësuar dhe mbi njëqind kërkesa të ndryshme. Janë kryer në teren regjistrime të reja të pronave(objekteve), 470 verifikim me ndryshime,

Objekte 312 dhe verifikime pa ndryshime 2980 objekte. Gjithsej verifikime 3 667 lëndë.

Sipas Nenit 15 pika 2 të Ligjit nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, komuna duhet inspektuar 20% të pronave (Klina ka mbi dhjetë mijë tatimpagues, ndërsa ka inspektuar 3.667 prona) pra, jemi në limitet e kërkuar sipas ligjit.

Modifikime tjera; regjistrim të nr. personal, përmirësime emri, mbiemri, ndryshime të emrave të tatimpaguesve etj. gjithsej 3 738 lëndë. Janë dërguar në MF, përkatësisht në Departamentin e TP 69 shkresa me shënime të pagesave të paregjistruara në sistemin e tatimit në pronë.

Vështirësitë që na përcjellin sistematikisht janë: mungesë veture. Edhe pse drejtori është përpjekur të mos ndihet mungesë për punë terreni, por ua kujtoj se kjo zyrë kishte veturë që nga viti 2002 deri në vitin 2017. Në Kosovë nuk ka komunë që nuk e ka veturë për këtë shërbim. Kemi edhe vështirësi tjera që na paraqiten gjatë zhvillimit të realizimit të detyrave të përcaktuara si hezitimi i qytetarëve për pagesa të kamatave dhe ndëshkimeve ata që s'i kryejnë obligimet me kohë e që përcaktohen më Ligjin Për tatimin në Pronë në fuqi. Pavarësisht prej këtyre vështirësive mendojmë se puna e kësaj zyre ka arritur suksese në inkasim të mjeteve financiare dhe punëve tjera që kanë të bëjnë me tatimin në pronën e paluajtshme dhe tatimpaguesit për vitin 2022.

## **RAPORT I MENAXHIMIT FINANCIAR KOMUNAL PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR 2022**

### **Raport financiar për buxhetin, të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar dhjetor 2022.**

Për të analizuar realizimin e buxhetit në periudhën janar dhjetor 2022 do të japim një pasqyrë të buxhetit, të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore do të analizojmë disa trende të këtyre kategorive buxhetore si dhe do të bëjmë disa krahasime me parametrat buxhetor për këtë periudhë dhe disa krahasime me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Raporti për periudhën janar-dhjetor 2022, është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit nr. 03/L – 048, për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Raporti i përgatitur paraqet buxhetin në SIMFK, shpenzimet dhe arkëtimin e të hyrave.

	<b>Buxheti në SIMF 2022</b>	<b>% në total</b>	<b>Buxheti sipas SIMFK 2021</b>	<b>Ndryshimi nga 2020 në %</b>
--	---------------------------------	-------------------	-------------------------------------	------------------------------------

### **Të hyrat buxhetore të komunës së Klinës për periudhën janar- dhjetor 2022**

#### **Buxheti në SIMFK sipas burimit**

Granti qeveritar	10,372,411.74	81.79	10,223,170.63	1.46
Të hyrat vetanake 2021	1,065,865.00	8.40	830,437.00	28.35
Të hyrat e bartura	1,196,666.06	9.44	554,975.41	115.63
Participimi i qytetarëve	41,443.63	0.33	21,212.12	95.38
Save the Children	5,437.68	0.04	5,000.00	8.75
<b>TOTALI :</b>	<b>12,681,824.11</b>	<b>100</b>	<b>11,634,795.16</b>	<b>9.00</b>

**Tabela 1. Buxheti në SIMFK për vitin 2022 sipas burimit dhe krahasimi me 2021**

**Buxheti për këtë periudhë ishte 12,681,824.11 €**

Siç shihet nga tabela më lartë buxheti sipas SIMFK për janar-dhjetor 2022 është më i lartë për rreth 9 % se

buxheti në periudhën e njëjtë të vitit 2021.

### 1. Granti Qeveritar

Granti Qeveritar në vlerë 10,372,411.74 € është burimi kryesor i financimit të buxhetit komunal, 81.79% e buxhetit total në këtë periudhë.

Në raport me vitin paraprak buxheti nga GQ është 1.46 % më i lartë.

### 2. Të hyrat vetanake


Siç shihet edhe në tabelë buxheti nga THV të vitit 2022 është 1,065,865.00 € ( 8.40 % e buxhetit total në këtë periudhë), ndërsa në raport me vitin paraprak buxheti nga THV është më i lartë për rreth 28.35% . Të hyrat e bartura janë 1,196,666.06 € (9.44 % e buxhetit total në këtë periudhë). Në raport me vitin paraprak janë më të larta për rreth 115.63 %.

### 3. Donacionet

Përveç Grantit Qeveritar dhe THV si burime të rregullta të financimit, si burim të financimit në këtë periudhë kemi edhe donacionet siç janë:

- Participimi i qytetarëve në vlerë 41,443.63 € (0.33 % e buxhetit total në këtë periudhë), në raport me vitin paraprak buxheti nga participimet me qytetarë është rreth 95.38 % më i lartë se në vitin paraprak.

- Donacioni nga Save the Children është 5,437.68 €



**Grafiku 1. Buxheti në SIMFK sipas burimit**

	<b>Buxheti sipas SIMFK 2022</b>	<b>% në total</b>	<b>Buxheti i shpenzuar janar-dhjetor 2022</b>	<b>Progresi ndaj buxhetit në %</b>	<b>% në total</b>	<b>Buxheti i shpenzuar janar-dhjetor 2021</b>	<b>Krahasimi 2022 me 2021 në %</b>
Burimi							

**SHPENZIMET BUXHETORE**

**Për periudhën janar-dhjetor 2022**

Granti qeveritar	10,372,411.74	81.79	10,009,166.28	96.50	86.66	10,089,467.21	- 0.80
Të hyrat vetanake 2021	1,065,865.00	8.40	663,126.57	62.21	5.74	542,080.30	22.33
Të hyrat e bartura nga viti paraprak	1,196,666.06	9.44	850,471.49	71.07	7.36	482,004.10	76.44
Participimi i qytetarëve	41,443.63	0.33	21,361.50	51.54	0.18	16,130.00	32.43
Save the Children	5,437.68	0.04	5,437.68	100	0.05	5,000.00	8.75
<b>TOTALI :</b>	<b>12,681,824.11</b>	<b>100</b>	<b>11,549,563.52</b>	<b>91.07</b>	<b>100</b>	<b>11,134,681.61</b>	<b>3.73</b>

### Buxheti në SIMFK sipas burimit dhe buxheti i shpenzuar

**Tabela 2. Buxheti në SIMFK sipas burimit dhe buxheti i shpenzuar në periudhën janar – dhjetor 2022**

Buxheti i shpenzuar në periudhën janar – dhjetor 2022 në vlerë 11,549,563.52 € është 91.07 % e buxhetit në SIMFK për vitin 2022. Nga Granti Qeveritar 10,009,166.28 € (96.50 % në raport me buxhetin nga Granti), nga të hyrat vetanake 663,126.57 € (62.21 % në raport me buxhetin nga të hyrat 2021), nga të hyrat e bartura 850,471.49 € (71.07 % në raport me buxhetin nga të hyrat e bartura), nga participimi i qytetarëve 21,361.50 € (51.54% në raport me buxhetin nga participimet me qytetarë dhe nga Save the Children 5,437.68 € (100 % në raport me buxhetin nga ky donacion. Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në vlerë 11,549,563.52 € nga granti qeveritar janë 86.66 %, nga të hyrat vetanake 5.74 %, nga të hyrat e bartura 7.36 %, nga participimi i qytetarëve 0.18 % dhe nga Save the Children 0.05%.

Shpenzimet e buxhetit në këtë periudhë janë më të larta për rreth 3.73 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

### Shpenzimet e buxhetit sipas kategorive ekonomike

	Buxheti në		Shpenzimet	Shpenzimet	%	Shpenzimet	Krahasimi
--	------------	--	------------	------------	---	------------	-----------




<b>Përshkrimi</b>	<b>SIMFK 2022</b>	<b>% në total</b>	<b>janar-dhjetor 2022</b>	<b>në raport me buxhetin në %</b>	<b>në total e shpenz.</b>	<b>janar-dhjetor 2021</b>	<b>2022 me 2021 në %</b>
Paga dhe mëditje	6,686,270.42	52.72	6,443,170.89	96.36	55.79	6,700,218.13	- 3.84
Mallra dhe shërbime	1,369,064.00	10.80	1,340,623.85	97.92	11.61	1,211,429.32	10.66
Shërbime komunale	167,000.00	1.32	166,971.64	99.98	1.45	179,398.69	- 6.93
Subvencione dhe transf.	408,796.31	3.22	401,428.90	98.20	3.48	345,108.59	16.32
Kapitalet	4,050,693.38	31.94	3,197,368.34	78.93	27.68	2,698,526.88	18.49
<b>TOTALI</b>	<b>12,681,824.11</b>	<b>100</b>	<b>11,549,563.52</b>	<b>91.07</b>	<b>100</b>	<b>11,134,681.61</b>	<b>3.73</b>

**Tabela 3. Shpenzimet e buxhetit për periudhën janar – dhjetor 2022 sipas kategorive ekonomike**

Nga buxheti i shpenzuar në periudhën janar – dhjetor 2022 në vlerë 11,549,563.52 € për paga dhe mëditje janë shpenzuar 6,443,170.89 € (55.79 % e shpenzimeve), për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 1,340,623.85 € (11.61 % e shpenzimeve), për shërbime komunale 166,971.64 € (1.45 % e shpenzimeve), për subvencione 401,428.90 € (3.48 % e shpenzimeve) dhe për kapitale 3,197,368.34 € (27.68 % e shpenzimeve).

Shpenzimet në periudhën janar- dhjetor 2022 në vlerë 11,549,563.52 € krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2021 në vlerë 11,134,681.61 € janë rritë për rreth 3.73 %. Shpenzimet për paga dhe mëditje krahasuar me vitin paraprak janë zvogëluar rreth 3.84 %, shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritë për rreth 10.66 %, shpenzimet për shërbime komunale janë zvogëluar për rreth 6.93 %, shpenzimet për subvencione janë rritë për 16.32 % dhe shpenzimet për kapitale janë rritë për rreth 18.49 %.

## Shpenzimet për janar- dhjetor 2022 sipas kategorive



**Grafiku 2. Shpenzimet buxhetore në periudhën janar – dhjetor 2022 sipas kategorive**

Nr.	KODI EKONOMIK	LLOJET E TRANSAKSIONEVE	Nëntëmuajori	%	Nëntëmuajori	%	Krahasimi
-----	---------------	-------------------------	--------------	---	--------------	---	-----------

**Arkëtimi i të hyrave sipas llojit për vitin 2022 dhe krahasimi me të hyrat e vitit 2021**

			2021	Ne total	2022	Ne total	2021/2022
1	40110	TATIMI NË PRONË	488,480.94	29.15	453,281.30	28.81	(7.21)
2	50001	TAX REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE	76,040.00	4.54	80,326.50	5.11	5.64
3	50009	TAX PËR LEJE NDËRTIMI	192,546.98	11.49	300,448.67	19.10	56.04
4	50013	TAX CERTIFIKATAT E LINDJES	1,641.51	0.10	1,210.00	0.08	(26.29)
5	50014	TAX CERTIFIKATAT E KURORIZIMIT	12.00	0.00	1.00	0.00	-
6	50015	TAX CERTIFIKATAT E VDEKJES	2,163.50	0.13	886.00	0.06	(59.05)
7	50016	TAX CERTIFIKATA TJERA	38,239.30	2.28	39,549.20	2.51	3.43
8	50017	TAX VERIFIKIM DOK.TË NDRYSHME	303,278.25	18.10	8,389.00	0.53	(97.23)
9	50019	TAX TJERA ADMINISTRATIVE	1,913.01	0.11	2,090.61	0.13	9.28
10	50103	LARGIMI DHE DEPONIMI I AUTOMJE	580.00	0.03	1,039.50	0.07	-
11	50104	GJOBAT NGA INSPEKTORIATI	6,543.00	0.39	14,745.00	0.94	125.36
12	50205	LIC.PRANIM TEKNIK TE LOKALIT	2,387.00	0.14	6,808.55	0.43	185.23
13	50217	LIC.PËR DYQANE TË MËDHA	69,030.00	4.12	73,565.85	4.68	6.57
	50403	TE HYRAT NGA SHITJA		0.24		-	-

14		E MALLRAVE	4,092.90		-		
15	50405	SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	1,650.00	0.10	10,427.23	0.66	531.95
16	50406	PRONA PUB.PER TREG.TE HAPUR	2,315.00	0.14	3,000.00	0.19	29.59
17	50407	QIRAJA VENDOSJA OBJEKT TREGTAR	6,590.00	0.39	11,057.50	0.70	67.79
18	50408	QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	4,940.00	0.29	21,194.00	1.35	329.03
19	50409	PARTICIPIM - ARSIMI I MESEM	42,332.00	2.53	44,587.19	2.83	5.33
20	50409	PARTICIPIM - QERDHJA	21,777.46	1.30	22,956.31	1.46	5.41
21	50409	PARTICIPIM - SHENDETSIA	31,908.40	1.90	32,572.70	2.07	2.08
22	50412	DONACIONET E JASHTME	5,000.00	0.30	5,437.68	0.35	-
23	50504	TAX PER MATJEN TOKES NE TEREN	66,877.00	3.99	78,482.00	4.99	17.35
24	50409	PARTICIPIM I QYTETAREVE	4,825.00	0.29	36,361.50	2.31	-
25		GJOBAT NGA TRAFIKU	276,796.80	16.52	304,710.50	19.37	-
26		DENIMET NGA GJYKATA	23,640.00	1.41	20,115.00	1.28	-
		<b>GJITHESEJ:</b>	<b>1,675,600.05</b>	<b>100</b>	<b>1,573,242.79</b>	<b>100</b>	<b>(6.11)</b>

Komuna ka arkëtuar (inkasuar) gjithsej 1,573,242.79€ të hyra, në periudhën janar – dhjetor 2022. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak të hyrat janë më të ulëta për 6.11 % ose në vlerë për 102,357.26 €.

Vërejtje: Në totalin e të hyrave për vitin 2022 vlera 1,573,242.79€ nuk janë përfshirë të hyrat e tremujorit të fundit për gjobat nga trafiku dhe dënimet nga gjykata.

#### Shpenzimet buxhetore për periudhën janar - dhjetor 2022

Nr.rend.	Kodi ekonomik	Përshkrimi	Shuma e paguar
1	11110	PAGAT NETO PËRMES LISTAVE	5,456,602.01
2	11115	PAGESA PËR SINDIKATË	20,289.10
3	11125	ANTARSIM-ODA E INFERMIERVE TE KOSOVËS	2,349.84
4	11126	ANTARËSIM-ODA E MJEKVE TË KOSOVËS	1,920.00
5	11400	PUNËTORËT ME KONTRATË (JO NË LISTËN E PAGËS)	4,684.56
6	11500	TATIMI NË TË ARDHURA PERSONALE	331,747.54
7	11600	KONTRIBUTI PENSIONAL I PUNËTORIT	

			300,752.11
8	11700	KONTRIBUTI PENSIONAL I PUNËDHËNËSIT	300,752.11
9	11900	PAGESA PËR VENDIME GJYQËSORE	24073.62
	<b>TOTALI: 11</b>	<b>RROGAT DHE PAGAT</b>	<b>6,443,170.89</b>
10	13130	SHPENZIMET E UDHËTIMIT BRENDA	33,134.61
11	11140	SHPENZIMET E UDHËTIMEVE ZYRTARE JASHTË VENDIT	150.00
12	13141	SHPESHPENZIME TE VOGLA - PARA XHEPI	1,336.40
13	13310	SHPENZIME PËR INTERNET	2,781.75
14	13320	SHPENZIMET E TELEFONIT-VALA 900	11,565.71
15	13330	SHPENZIMET POSTARE	7,322.42
16	13430	SHËRBIME TË NDRYSHME SHËNDETËSORE	46,710.75
17	13440	SHËRBIME TË NDRYSHME INTELEK. DHE KËSHILLËDHËNËSE	5,442.00
18	13450	SHËRBIME SHTYPJE - JO MARKETING	16,503.57
19	13460	SHERB.KONTRAKTUESE TJERA	357,746.32
20	13470	SHËRBIME TEKNIKE	845.00
21	13480	SHPENZIMET PËR ANTARËSIM	8,836.80
22	13490	SHERBIMET E VARRIMIT	1,590.00
23	13501	MOBILJE (ME PAK SE 1000 Euro)	18,161.62

24	13503	KOMPJUTER ME PAK SE 1000 EURO	14,659.50
25	13509	PAISJE TJERA<1000 EURO	55,183.27
26	13510	BLERJA E LIBRAVE DHE VEPRAVE ARTISTIKE	2,999.00
27	13610	FURNIZIME PER ZYRE	36,395.97
28	13616	FURNIZIM ME ARTIKUJ BUJQËSOR	278.50
29	13620	FURNIZIM USHQIM&PIJE(JO DREKA)	61,901.93
30	13630	FURNIZIME MJEKSORE	65,817.97
31	13640	FURNIZIM PASTRIMI	12,053.03
32	13650	FURNIZIM ME VESHMBATHJE	14,296.85
33	13720	NAFT PER NGROHJE QENDRORE	66,208.17
34	13760	DRU	186,308.48
35	13770	DERIVATE PER GJENERATOR	4,432.13
36	13780	KARBURANTE PER VETURA	65,335.05
37	13920	PROVIZIONI BANKAR - BKT	30.00
38	13950	REGJ.SIGURIMI I AUTOMJETEVE	2,690.00
39	13951	REGJ.SIGURIMI I AUTOMJETEVE	5,626.33
40	14010	MIRM.RIPARIMI I AUTOMJETEVE	19,907.33
41	14020	MIRMBAJTJA E NDERTESAVE	4,853.13
42	14023	MIRMBAJTJA E SHKOLLAVE	



			45,842.71
43	14024	MIRËMBAJTJA OBJEKTEVE SHËNDETËSORE	983.00
44	14032	MIRËMBAJTJA AUTO RRUGËVE LOKALE	61,831.27
45	14040	MIREMB.E TEKNOLOGJ.INFORMATIVE	567.63
46	14050	MIRMB.PAISJEVE DHE MOBILEVE	30,763.40
47	14060	MIRËMBAJTJA RUTINORE	34,716.55
48	14210	REKLAMAT DHE KONKURSET	1,900.00
49	14230	SHPENZ.PER INFORMIM PUBLIK	576.00
50	14310	DREKAT ZYRTARE	1,664.70
51	14410	SHPENZIME-VENDIMET E GJYKATAVE	30,674.90
	<b>TOTALI: 13</b>	<b>MALLRA DHE SHËRBIME</b>	<b>1,340,623.75</b>
52	13210	RRYMA	124,749.05
53	13220	UJI	13,794.74
54	13230	MBETURINAT	25,193.28
55	13250	SHPENZIMET TELEFONIKE	3,234.57
	<b>TOTALI: 14</b>	<b>SHPENZIMET KOMUNALE</b>	<b>166,971.64</b>
56	21110	SUBVENCIONE PËR ENTITETET PUBLIKE	800.00
57	21200	SUB.PËR ENTIT.JOPUBLIKE	400,628.90
	<b>TOTALI: 20</b>	<b>SUBVENCIONET DHE TRANSFERET</b>	<b>401,428.90</b>

58	31110	NDËRTESTAT E BANIMIT	30,000.00
59	31120	NDËRTESTAT ADMINISTRATËS AFARISTE	19,972.66
60	31121	OBJEKTET ARSIMORE	100,000.00
61	31122	OBJEKTET SHËNDETËSORE	49,340.00
62	31124	OBJEKTET SPORTIVE	17,303.00
63	31230	NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE	2,146,923.20
64	31250	KANALIZIMI	221,331.31
65	31260	UJËSJELLËSI	21,000.00
66	31270	MIREMBAJTJA INVESTIVE	109,435.38
67	31510	FURNIZIMI ME RRYMË GJENRATOR TRAFNS	20,853.72
68	31620	MOBILJE	19,992.00
69	31660	PAJISJE SPECIALE MJEKËSORE	59,873.00
70	32000	INVESTIMET NE VIJIM	192,463.96
71	32110	RREGULLIMI I LUMENJËVE	117,722.89
72	32111	SISTEMI I UJITJES	53,657.22
73	33200	TRANSFERE KAPITALE - ENTITETET JOPUBLIKE	17,500.00
	<b>TOTALI: 30</b>	<b>PASURITË JOFINANCIARE</b>	<b>3,197,368.34</b>
		<b>TOTALI I PERGJITHSHEM:11,13,14,20,30</b>	<b>11,549,563.52</b>

Këto janë disa nga detyrat esenciale që ka zhvilluar kjo drejtori e që disa çështje tjera administrative nuk i kemi përfshirë, pasi që janë të përfshira në raportin financiar për vitin 2022.

#### **4. DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT**

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit gjithë fushëveprimtarinë e vet e ushtron në bazë dispozitave ligjore, rregulloreve që janë në fuqi, planeve dhe është ekzekutuese e drejtpërdrejtë e vendimeve Kuvendit të Komunës.

Në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit veprojnë:

Shërbimi i Ndërtimit dhe Banimit	<b>Ne kuadër të kësaj drejtorie ushtrohen këto veprimtari:</b>	- Punët dhe aktivitetet rreth ndërtimit dhe banimit,
Zyra për Mbrojtje të Mjedisit		- Legalizimi,
Planifikimi Urban		- Punët dhe aktivitetet rreth Urbanizmit – Planifikimit,
Zyra për Projekte		- Leje mjedisore komunale, - Mirëmbajtja e sistemit të adresave, - Hartim të paramasave dhe parallogarive, përgatitje të projekt-propozimeve, raporte teknike, procesverbale, shkresa, etj. - Menaxhim dhe mbikëqyrje të ecurisë së punimeve për të gjitha projektet, pranime teknike për projektet e tjera që janë në kuadër të kësaj drejtorie dhe drejtorive tjera, - Po ashtu, bënë inspektime në teren sipas kërkesave të palëve.

Gjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022 në këtë drejtori janë pranuar 948 lëndë si: kërkesa për leje ndërtimi, kërkesa për kushte ndërtimi, kërkesa për leje mjedisore komunale, kërkesa për legalizim, fatura dhe kërkesa të natyrave të ndryshme.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit i ka shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe ka vendosur si me poshtë:

660 lëndë të miratuara prej të cilave janë:

Kushte të ndërtimit	Leje ndërtimi	Leje mjedisore	Leje legalizimi	Leje rrënimi
52	50	8	145	1

404 lëndë janë: referenca, vërtetime, pëlqime, procesverbale, vendime, fatura, njoftime, shkresa dhe kërkesa të ndryshme.

Lëndë janë në proces	Lëndë të refuzuara	Lëndë të pezulluara	Lëndë të hedhura poshtë	Lëndë të anuluar	Të pranuar	Të ceduara
7	86	135	17	34	7	2

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të mjedisit këtë vit ka krijuar të hyra buxhetore në vlerë prej **299,392.26€** nga lejet e ndërtimit, kushtet e ndërtimit, lejet mjedisore komunale, legalizimi pëlqimet, etj.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka menaxhuar, mbikëqyrur dhe realizuar projektet si me poshtë:



Pra, gjatë periudhës një vjeçare janë punuar:

30739 m asfaltuar rrugë,

19674 m kanalizim fekal,

1900 m ujësjellës,

3990 m tretuar,

1100 m shteg për biçikleta,

1 urë mbi lumin Klina( Pogragj),

1 urë për këmbësor mbi lumin “Drini i Bardhë” ( Rastok),

3 ura të përmasave më të vogla (mbi prroje).

Gjatë kësaj periudhe punëtorët e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit kanë marrur pjesë në komisione për hapje dhe vlerësime të ofertave për projekte të ndryshme të Drejtorisë së Urbanizmit dhe drejtorive të tjera si dhe komisione të ndryshme. Janë mbajtur takime të ndryshme me donatorë si dhe dikasteret e linjës me qëllim të harmonizimit të punëve si dhe përfitimit të projekteve të ndryshme. Janë mbajtur takime të rregullta me kompanitë si “Hidrodrini”, KRM “Ambienti”, KEDS ,PTK që të na ofrojnë të gjitha projektet që kanë planifikuar për Komunën e Klinës. Gjatë kësaj periudhe është bërë raporti vjetor i punës për vitin 2021, plani i punës dhe plani i prokurimit për vitin 2022, raporte mujore rreth punës së drejtorisë, janë bërë vlerësimet dhe sistemimet e dosjeve të këtij viti si dhe punë tjera që kanë të bëjnë me planifikimin, detyrat dhe aktivitetet e drejtorisë. Është bërë shënimi i datave mjedisore siç është: Dita e tokës 22 prilli, Ta pastrojmë Kosovën 24 maji, Dita e Mjedisit 5 qershor. Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje ka bërë edhe punë tjera si inspektime në teren sipas kërkesave të palëve, paramasa dhe paralogari për rrugë, rrënim të objekteve, mirëmbajtje të rrugëve, detyra projektuese, kërkesa, projektpropozime, raporte, mbikëqyrje të projekteve, pranime teknike etj.

## **5. DREJTORIA E ARSIMIT**

Drejtoria e arsimit gjatë vitit 2022 ka ushtruar të gjitha funksionet, autorizimet dhe përgjegjësitë e saj që kanë mbështetje në kompetencat e Komunës sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale numër 03/L-040, në Ligjin për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës numër 03/L-068, në kompetencat shtesë sipas dispozitave të Ligjit për arsimin parauniversitar numër 04/L-032, në planin e punës për 2022, në rregullore e strategji që ka nxjerrë Komuna e Klinës, në të cilat përfshihet fusha e arsimit dhe avancimi i tij në aspekte të ndryshme, në udhëzimet administrative të MASHTI-t dhe në të gjitha aktet e tjera nënligjore si dhe në Kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës, pastaj në kurrikulat bërthamë dhe të gjitha dokumentet e tjera shoqëruese të saj që ndihmojnë personelin arsimor për zbatimin korrekt të kërkesave arsimore që kanë të bëjnë me mësimdhënien e nxënien, vlerësimin e nxënësve, qasjen ndërkurrikulare, bashkëpunimin kolegjial, aktivitetet jashtëkurrikulare etj..

Gjatë vitit kalendarik 2022 DKA-ja ka zhvilluar aktivitete në koordinim me të gjithë mekanizmat kompetent si MASHTI, Inspektorati i Arsimit, por edhe me organizata kompetente të akredituara nga MASHTI për të ndihmuar zhvillimet dhe avancimet në fushën e arsimit dhe sidomos në aspektin e zhvillimit të cilësisë, në trajnimin e vazhdueshëm profesional, në arsimin inkluziv, në përfshirjen e nxënësve në gara dhe olimpiada të ndryshme të lejuara nga MASHTI, në edukimin dhe zhvillimin në fëmijërinë e hershme, në këshillimin dhe orientimin e nxënësve në karrierë etj. Kështu që orientimet dhe projektet kryesore të DKA-së gjatë vitit 2022 në përgjithësi kanë përfshirë çështjet dhe aspektet si në vijim:

1. Gjithëpërfshirja në arsim (punësimi i 3 asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta, vlerësimet pedagogjike të fëmijëve me nevoja të veçanta nga ekipi komunal për vlerësim pedagogjik të këtyre fëmijëve dhe ndihmesa të tjera profesionale për këtë kategori të fëmijëve; momentalisht janë 6 asistentë dhe 2 mësues mbështetës që ofrojnë shërbime për nxënës me nevoja të veçanta)
2. Ndërtimi dhe zgjerimi i hapësirave shkollore dhe terreneve sportive për sigurimin e kushteve më të mira në procesin mësimor dhe avancimin e cilësisë.
3. Koordinimi i aktiviteteve me koordinatore të cilësisë nëpër shkolla rreth zbatimit efektiv të kurrikulës dhe krijimit të praktikave më të avancuara të planifikimit dhe të vlerësimit në procesin mësimor.
4. Instalimi i kamerave të sigurisë nëpër të gjitha objektet edukativo-arsimore.
5. Koordinimi i aktiviteteve me MASHTI-n për organizimin dhe administrimin e vlerësimit të jashtëm (testit nacional të klasës 9 dhe provimit të maturës shtetërore), por edhe për vlerësimin ndërkombëtar PISA 2022 dhe testimin provues TIMSS 2023.
6. Organizimi dhe monitorimi i garave dhe olimpiadave të niveleve të ndryshme në bashkëpunim me MASHTI-n dhe organizata që kanë lejen e MASHTI-t për zhvillim të këtyre aktiviteteve.

Edhe në pjesën e parë të vitit kalendarik 2022 sistemi arsimor iu ekspozua rrethanave të vështira si pasojë e pandemisë botërore, prandaj DKA-ja i ka kushtuar kujdesin e duhur zhvillimit të procesit mësimor në kushte të pandemisë COVID-19, kështu që me task forcën komunale dhe me task forcat shkollore si dhe me drejtorë shkollash e me këshillat e prindërve ka përcjellë situatën epidemiologjike dhe ka marrë masa në përputhje me këtë situatë dhe me masat qeveritare dhe të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, po ashtu duke zbatuar dhe



pasur parasysh Udhëzuesin e Ministrisë për zhvillimin procesit mësimor në vitin shkollor 2021/2022 në rrethana të pandemisë COVID-19.

Si rrjedhim, për shkak të gjendjes së rënduar epidemiologjike me COVID-19, task forcat shkollore në bashkëpunim me task forcën komunale kanë marrë vendim që prej datës 25 deri më 29 janar 2022 procesi mësimor të zhvillohej sipas skenarit C (online) të MASHTI-t në SHFMU “Ismet Rraci”, “Motrat Qiriazhi”, në gjimnazin “Lugj Gurakuqi” dhe SHMP-në “Fehmi Agani” të Klinës. Ashtu si në krejt rajonin dhe më gjerë, pandemia pati efektet e veta negative të cilat u vërejtën edhe në vitet e mëpastajme në lloje të ndryshme të vlerësimeve të brendshme e të jashtme.

DKA-ja gjatë sezonit dimëror është kujdesur që në çdo objekt edukativo-arsimor të funksionojnë si duhet sistemet e ngrohjes, të mirëmbahen ato dhe të ketë lëndë të mjaftueshme për ngrohje, duke ofruar kështu kushte normale për zhvillim të procesit mësimor në stinën e dimrit.

Sa i përket koordinimit dhe bashkëpunimit të DKA-së me MASHTI-n, Kolegjiunin e drejtorëve të arsimit, Inspektoratin e Arsimit e mekanizma të tjerë kompetentë, drejtori i DKA-së, përmes takimeve të punës dhe konsultave me drejtorë shkollash, ka përcjellë me kohë tek ata të gjitha udhëzimet, detyrat ose planet që kanë dalë nga takimet me organet që u cekën më lart lidhur me çështje të ndryshme të procesit mësimor dhe zbatimit të kurrikulës, vlerësimit të nxënësve dhe të drejtave të tyre, rekrutimit të personelit arsimor etj.

Sa u përket aktiviteteve jashtëkurrikulare me nxënës, më 12 shkurt 2022 janë mbajtur garat komunale të fizikës, në SHMP “Fehmi Agani”, organizuar nga Shoqata Kosovare e Fizikës në bashkëpunim me DKA-në, kurse më 19 shkurt është mbajtur olimpiada matematike komunale, organizuar nga Shoqata e Matematikanëve të Kosovës në bashkëpunim me DKA-në. Në këto aktivitete jashtëkurrikulare kanë marrë pjesë nxënës të klasave të nënta, të dhjeta, të njëmbëdhjeta e të dymbëdhjeta. Në garat e 23-ta republikane të fizikanëve të rinj të Kosovës më 27 shkurt 2022 kanë marrë pjesë nga një nxënës i këtyre klasave që është kualifikuar në garën komunale, kurse në Olimpiadën e 14-të Matematike të Kosovës më 5 mars 2022 morën pjesë nga dy nxënës të këtyre klasave, që janë kualifikuar në olimpiadën komunale. Kurse Olimpiada Matematike e Kosovës- OMK 2023 në nivel komunal është mbajtur më 19 nëntor 2022 në lokale të shkollës profesionale “Fehmi Agani” dhe në këtë olimpiadë janë kualifikuar 7 nxënës që kanë marrë pjesë në Olimpiadën Matematike të Kosovës në nivel vendi më 3 dhjetor 2022 në hapësira të gjimnazit të specializuar matematikor në Prishtinë. Nxënësit e tillë DKA-ja i ka mbështetur, i ka nderuar me mirënjohje në momente festive dhe i ka inkurajuar që të marrin pjesë në aktivitete që zhvillojnë potencialet e tyre arsimore, shkencore e kreative.

Në kuadër të interesimeve dhe bashkëpunimit të DKA-së për avancimin e edukimit dhe të kujdesit në fëmijërinë e hershme, më 14 shkurt 2022 ka filluar punën zyrtarisht paralelja parafillore në SHFMU “Emin Duraku” të Sferkës në kuadër të projektit të organizatës Save the Children për përmirësimin e qasjes dhe të cilësisë në kujdesin dhe zhvillimin në fëmijërinë e hershme (KZHFH). Edukatorja dhe mobilizuesja e terrenit (asistentja), sipas marrëveshjes ndërmjet organizatës dhe DKA-së, dy vjet do të paguhen nga fondet e organizatës Save the Children, pastaj nga komuna.

Në kuadër të bashkëpunimit të DKA-së me partnerë zhvillimorë, KCDF-ja (Fondacioni Kosovar për Zhvillim në Karrierë) ka mbajtur më 20 prill në platformën ZOOM sesion

informues me mësues të TIK-ut që japin mësim në klasa të nënta rreth versionit të ri të platformës Busulla.com e cila është avancuar tashmë me materiale të reja, të qasshme dhe të nevojshme për nxënës dhe mësime të mësimdhënës. Aktivitetet e kësaj organizate kanë vazhduar gjatë tërë vitit përmes formave të ndryshme të zhvillimit profesional për mësime të TIK-ut, por edhe në kudër të fushës së orientimit dhe të këshillimit të nxënësve në karrierë

Nga data 22 deri më 24 prill 2022 në Durrës është mbajtur seminari TOT (Trajnimi i trajnerëve)- Edukimi për të drejtat e fëmijëve “Të drejtat tona”, organizuar nga Instituti IPEDU- Prishtinë, (Instituti për Promovimin e Edukimit), përkrahur nga MASHTI dhe financuar nga Ambasada e Sllovenisë në Kosovë. Në seminar morën pjesë përfaqësues të sektorit të arsimit nga Klina (4 mësime të mësimdhënës dhe një zyrtar i DKA-së), Peja dhe Istogu. Seminari është projekt i Ministrisë së Jashtme të Sllovenisë dhe është realizuar me sukses në shumë shtete të BE-së, por edhe jashtë saj.

KCDF-ja (Fondacioni Kosovar për Zhvillim në Karrierë) ka mbajtur më 20 prill në platformën ZOOM sesion informues me mësues të TIK-ut që japin mësim në klasa të nënta rreth versionit të ri të platformës Busulla.com e cila është avancuar tashmë me materiale të reja, të qasshme dhe të nevojshme për nxënës dhe mësime të mësimdhënës. Kjo organizatë ka qenë aktive dhe në bashkëpunim me DKA-në dhe shkollat gjatë tërë vitit 2022 në kuadër të projektit për orientim dhe këshillim në karrierë sidomos me nxënës të klasave të dhjeta, por edhe me ata të klasave të nënta e të dymbëdhjeta.

Gjithashtu TLPK-ja (The Library Project Kosova) mbështetur nga Ambasada e Suedisë në Kosovë ka zhvilluar aktivitetet e veta kulturore në kuadër të projektit “Ora e leximit” ku përfshihet shkolla “Motrat Qiriazi” dhe “Atë Shtjefën Gjeçovi” e Zllakuqanit. Kjo organizatë ka mbajtur trajnime me mësues klasorë të këtyre shkollave me temën “Strategjia e lexim-kuptimit”.

DKA-ja i ka përcjellë nëpër shkollat përkatëse të gjitha materialet (broshurat, njoftimet e udhëzimet) për nxënës e mësime të mësimdhënës rreth vlerësimeve të jashtme nacionale dhe ndërkombëtare të cilat janë mbajtur dhe do të mbahen sipas kalendarit të MASHTI-t. Kështu, më datat 12 e 13 maj 2022 në SHMP “Fehmi Agani” të Klinës është mbajtur testi pilotues TIMSS 2023 në lëndët matematikë dhe njeriu dhe natyra me 79 nxënës të klasave të katërta të SHFMU “Ismet Rraci” të Klinës, të përzgjedhur nga MASHTI, kurse më 17, 18 e 19 maj 2022 u mbajt testimi në programin e vlerësimit ndërkombëtar PISA 2022 me 129 nxënës të moshës rreth 15 vjeçe (të lindur brenda periudhës kohore 1 janar-31 dhjetor 2006) të shkollës fillore “Dëshmorët e Qëndresës”-Gllarevë, “Emin Duraku”-Sferkë, Dëshmorët”-Volljak dhe të gjimnazit “Luigj Gurakuqi” e të shkollës profesionale “Fehmi Agani”, të përzgjedhur po ashtu nga MASHTI, në lexim, matematikë dhe shkenca.

DKA-ja ka përcjellë me kohë në MASHTI planifikimet e saj për regjistrim të nxënësve në klasën e parë në shkollat e mësimit të obliguar dhe në klasën e dhjetë të gjimnazit dhe shkollës profesionale në vitin shkollor 2022/2023 (575 nxënës dhe 32 paralele janë planifikuar për klasën e parë; 320 nxënës dhe 10 paralele për klasën e dhjetë gjimnaz në drejtimin e shkencave natyrore dhe në drejtimin e shkencave shoqërore-gjuhësore dhe 360 nxënës dhe 15 paralele për klasën e dhjetë të shkollës profesionale në pesë fusha mësimore dhe katërbëdhjetë profile arsimore).

Gjatë korrikut dhe gushtit 2022 DKA-ja me shërbimet e saj dhe në bashkërendim e bashkëpunim me drejtorët e shkollave ka kryer punë e aktivitete sipas përgjegjësisë së saj

sidomos në fushën e përgatitjeve të natyrave të ndryshme për krijimin e kushteve, të hapësirave dhe të ambienteve përshtatshme për fillimin me kohë, sipas kalendarit të MASHTI-t, të vitit të ri shkollor 2022/2023. Në bashkëpunim me MASHTI-n DKA-ja drejtpërdrejt ka marrë pjesë në procesin e sigurimit të të dhënave nga shkollat për përpilimin e listave për tekste shkollore për klasat 1-9, duke përfshirë numrin e saktë të nxënësve dhe kërkesat e shkollave për tekste dhe tekste alternative, kështu që në fund të gushtit dhe në ditët e para të shtatorit DKA-ja, pasi ka pranuar e regjistruar dërgesat e shtëpive botuese në pikën e grumbullimit në SHMP “Fehmi Agani”, ka bërë shpërndarjen e teksteve nëpër shkolla. Tekstet shkollore, sipas kontraktimit të MASHTI-t, janë nga shtëpitë botuese: Dukagjini, Albasi, Luarasi, Libri shkollor, Pegi, Magjia e librit, Berati.

Pas grevës njëmuajore të shpallur nga SBASHK-u, viti i ri shkollor 2022/2023 ka filluar më 3 tetor 2022 në të gjitha institucionet arsimore dhe edukative të komunës së Klinës. Kanë humbur 22 ditë mësimi dhe MASHTI ka nxjerrë vendimin për ndryshimin e kalendarit shkollor 2022/2023 ku janë paraparë datat kur duhen realizuar orët e humbura mësimore.

Ndërsa sipas sistemit SMIA (Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim që menaxhohet nga divizioni për grumbullimin dhe analizën e të dhënave) të MASHTI-t ku ka përfunduar më 24 tetor 2022 afati për futjen e të dhënave në të, në institucionet edukativo arsimore të komunës së Klinës në vitin shkollor 2022/2023 vijnë procesin edukativo-arsimor 6797 nxënës (vitin e kaluar 7055). Nxënës minoritarë janë 241 ose 3.54 % (vitin e kaluar 238 ose 3.37 %): 171 ashkalinj; 53 romë dhe 17 egjiptianë. Nxënës femra në të gjitha nivelet arsimore janë 3389 ose 49.86 % (vitin e kaluar 49.62 %). Personel arsimor janë 711 (585 personel mësimdhënës; 45 personel administrativ; 81 personel ndihmës). Punëtorë femra janë gjithsej 315 ose 44.30 % (vitin e kaluar 42.19 %), kurse mësimdhënëse janë 295 ose 50.42 % (vitin e kaluar 47.84 %). Nga komunitetet pakicë një mësimdhënës shkallë punon në shkollën e mesme profesionale “Fehmi Agani” në Klinë ku punojnë edhe dy punëtorë teknikë ashkalinj. Po ashtu sipas sistemit SMIA janë 149 fëmijë me nevoja të veçanta në të gjitha institucionet edukativo-arsimore, me dëmtime të ndryshme dhe dëmtime të shumëfishta, shifër kjo që trajtohet me kujdes në procesin e planifikimeve të DKA-së për shtimin e mësuesve mbështetës dhe të asistentëve, por edhe për planifikimin e trajnimeve profesionale me mësues të klasave të rregullta për arsimin inkluziv ose gjithëpërfshirjen, në mënyrë që t’i përballojnë më lehtë sfidat e arsimit inkluziv dhe mësimdhënien e diferencuar sipas kërkesave të kurrikulës, zhvillimit psikofizik të nxënësve, moshës dhe shkallës së aftësive dhe talenteve të tyre.

Kurse në kuadër të avancimit të sigurisë nëpër shkolla, sipas projektit të financuar nga Komuna (realizuar nga kompania BIONIES), janë instaluar kamera sigurie në shkollat: Cerovik, Zajm, Poterq, Kerrnicë, Shtupel, Jashanicë e Lartë, Gjurgjevik i Madh, Resnik, Gremnik, Çabiq, Ujmirë.

Në aspektin e interesimeve dhe kontributit të DKA-së për ofrim të shërbimeve arsimore në fushën e gjithëpërfshirjes dhe duke u mbështetur në kriteret që parashihen me udhëzime administrative në fuqi për pranimin dhe kualifikimin e kandidatëve në institucionet edukativo-arsimore të arsimit parauniversitar, në tetor janë pranuar dy mësuese mbështetëse, një në SHFMU “Nënë Tereza” në Budisalc dhe një në SHFMU “Ismet Rraci” në Klinë sipas procedurave të konkursit publik që ka shpallur Fondacioni “Terre des hommes Lausanne” në Kosovë, në kuadër të qendrës mësimore në shkollën e Budisalcit, që vepron me lejen e MASHTI-t (mbështetur në UA numër 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e qendrave

mësimore) dhe ndihmon procesin e gjithëpërfshirjes përmes ofrimit të mundësive shtesë mësimore për fëmijë të grupeve të marginalizuara dhe për çdo fëmijë tjetër që ka probleme të natyrave të ndryshme në nxënie.

Ndërsa në kuadër të bashkëpunimit profesional me MASHTI-n, Divizioni për sigurimin e cilësisë, standarde, vlerësim dhe licencim ka përzgjedhur SHFMU “Motrat Qiriazhi” të Klinës dhe SHFMU “Dëshmorët e Kombit” të Çabiqit për studimin ndërkombëtar TALIS 2024 (Studimi ndërkombëtar për mësimdhënien dhe nxënien) që zhvillohet nga OECD (OBEZH- Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim). Procesi i vlerësimit përbën një anketim ndërkombëtar të mësimdhënësve për t’u arritur një kontribut që reflekton gjendjen momentale në arsim dhe u shërben institucioneve qeveritare për të avancuar politikat arsimore.

Më 22 nëntor 2022 një përfaqësues i DKA-së dhe një koordinator shkolle i cilësisë morën pjesë në konferencën e arsimit “Arsimi parauniversitar, menaxhimi dhe perspektivat në nivel komunal” të organizuar nga Kolegjiumi i drejtorëve të arsimit në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), mbështetur nga MASHTI dhe GIZ Kosova. Në konferencë u debatuan çështje të rëndësishme arsimore dhe u shkëmbyen informacione të ndërsjella rreth praktikave arsimore nëpër komuna, rreth nevojës për trajnime të mësimdhënësve për mësimin inkluziv, rreth projekteve të rëndësishme që ndihmojnë edukimin parashkollor dhe arsimin e aftësimin profesional me theks të veçantë mësimin dual.

MASHTI, konkretisht Divizioni për sigurimin e cilësisë, standarde, vlerësim dhe licencim, ka përzgjedhur SHFMU “Ismet Rraci” të Klinës, SHFMU “Tre dëshmorët” të Jashanicës dhe SHFMU “Avni Zhabota” të Shtupelit për vlerësimin ndërkombëtar TIMSS 2023 me nxënës të klasave të katërta në matematikë dhe shkenca, kurse po ky divizion ka përzgjedhur për vlerësimin ndërkombëtar ICILS (International Computer and Information Literacy Study) 2023 shkollat “Ismet Rraci”, “Motrat Qiriazhi”, “Azem Bejta”, “Avni Zhabota” dhe “Tre dëshmorët”, vlerësim ky që ka në fokus mënyrat se si të rinjtë arrijnë rezultate në Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit (TIK) si dhe format mbështetjes së kapaciteteve të tyre për epokën digjitale. Për të gjitha këto vlerësime dhe studime ndërkombëtare DKA-ja ka caktuar koordinatorë të shkollave të përzgjedhura, të cilët bashkëpunojnë me MASHTI-n, shkëmbejnë informacione të nevojshme për shkollat dhe plotësojnë formularë me të dhëna që kërkohen në kuadër të procesit të këtyre vlerësimeve.

### **Realizimi i projekteve 2022 për përmirësimin dhe avancimin e cilësisë në procesin mësimor dhe në fushën e sigurisë së nxënësve**

Projektet nga buxheti kapital 2022

1. Furnizim- montimi i kaldajës në sistemin e ngrohjes qendrore në gjimnazin “Luigj Gurakuqi” në vlerën prej 16,044.00 euro
2. Renovimi i objektit shkollor të SHFMU “Motrat Qiriazhi” në vlerë prej 85,301.86 euro
3. Furnizimi me inventar në shkolla në vlerën prej 19,992.00 euro

Projektet nga kategoria “Mallra dhe shërbime” 2022

1. Furnizim- montimi i kamerave në shkolla, vlera 8,638.70 euro
2. Rregullimi i nyjave sanitare në shkolla, vlera 12,372.00 euro
3. Furnizim- montim i perdeve “zebra” në shkolla, vlera 14,560.02 euro

4. Furnizimi me shujtë ditore për fëmijë parafillorë dhe nxënës të klasave 1-5, vlera

**Suksesi i nxënësve në nivel komune në fund të gjysmëvjetorit të dytë  
2021/2022**

36,103.13 euro

5. Transporti i nxënësve në relacionin shtëpi-shkollë dhe anasjelltas, vlera 34,058.41 euro
6. Furnizim- montimi i konstrukteve të laurave në SHFMU “Ismet Rraci” dhe SHMP “Fehmi Agani”, vlera 1,640.00 euro.

Realizimi i buxhetit të vitit 2022 nga të gjitha kategoritë (paga e medijtje, mallra dhe shërbime, komunale, subvencione, shpenzime kapitale) 99.90 %.

Vlerësim i brendshëm.

Shkëlq.		Shumë mirë		mirë		Mjaft.		Poz.	%	Pa nota		1 e dobet		2 të dob.		Përcillen		Përsëritin		Gjith.
F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	Gj.	Gj.	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	
183	352	39	83	15	58	8	17	510	97.3	4	14	0	0	0	0	0	0	0	0	52
180	348	42	107	26	69	10	21	545	98.4	6	9	0	0	0	0	0	0	0	0	55
162	297	36	85	26	69	11	36	487	97.6	0	1	0	2	2	4	2	5	0	0	49
188	331	52	104	32	78	14	30	543	98	2	3	0	0	0	2	2	6	0	0	55
184	320	75	137	27	99	18	33	589	99.5	0	0	0	0	0	0	1	3	0	0	59
125	205	86	148	42	112	20	51	516	93.6	1	2	4	17	0	5	0	0	1	11	55
113	178	55	110	59	146	22	88	522	92.2	3	5	1	10	2	19	0	0	0	10	56
115	177	69	122	78	161	24	98	558	93.6	1	4	4	11	1	3	0	0	2	20	59
137	195	62	128	57	169	19	95	587	95.6	1	2	4	11	4	14	0	0	0	0	61
64	93	49	84	94	165	47	150	492	97.2	0	0	0	0	1	1	0	0	2	13	50
64	82	55	86	73	152	34	93	413	98.8	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5	41
106	129	49	80	82	167	22	99	475	99.4	0	0	0	1	0	0	0	0	0	2	47
<b>1621</b>	<b>2707</b>	<b>669</b>	<b>1274</b>	<b>611</b>	<b>1445</b>	<b>249</b>	<b>811</b>	<b>6237</b>	<b>96.7</b>	<b>18</b>	<b>40</b>	<b>13</b>	<b>52</b>	<b>10</b>	<b>48</b>	<b>5</b>	<b>14</b>	<b>5</b>	<b>61</b>	<b>645</b>

n: në gjysmëvjektorin e parë 2021/2022 (dhjetor): klasa 9: 71 % pozitiv; klasa 10: 45 %; klasa 11: 52 %; klasa 12:48 %

Nga vlerësimet e jashtme

Rezultatet e testit të arritshmërisë 2022, pjesa e parë, mbajtur më 4 qershor 2022

në gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori, gjeografi

dhe më 14 qershor, pjesa e dytë, në matematikë, TIK, biologji, kimi, fizikë

Nr.	Institucioni																			
	SHKOLLA	Vendi	Kodi	Nx. në testim, pjesa 1	Nx. në testim, pjesa 2	Gjith. nxënës në testim	Femra	Poenat, pjesa 1	Poenat, pjesa 2	Gjithsej poena	Arritshmëria (%)									
1	"Ismet Rraci"	Klinë	1	139	139	139	62	7950	6718	14668	52.76									

2	“Emin Duraku”	Sferrkë	2	41	41	41	24	2181	1317	3498	42.66
3	“Motrat Qiriazi”	Klinë	3	75	75	75	29	4019	3134	7153	47.69
4	“Ali Krasniqi”	Ujmirë	4	24	24	24	15	1011	1068	2079	43.31
5	“Azem Bejta”	Grabanicë	5	23	23	23	10	1103	981	2084	45.30
6	“D. e Qëndresës”	Gllarevë	6	44	43	44	22	1930	1881	3811	43.80
7	“Tre dëshmorët”	Jashanicë	7	42	42	42	15	2341	2145	4486	53.40
8	“A. Sh. Gjeçovi”	Zllakuqan	8	39	38	39	21	1925	1621	3546	46.01
9	“Avni Zhabota”	Shtupel	9	18	19	19	7	864	827	1691	45.76
10	“Esad Mekuli”	Cerovik	10	24	25	25	9	990	762	1752	35.87
11	“Zgjimi”	Gremnik	11	19	19	19	7	1041	889	1930	50.79
17	“Isa Boletini”	Drenoc	12	24	24	24	10	1200	965	2165	45.10
13	“Nënë Tereza”	Budisalc	13	6	5	6	3	268	295	563	51.83
14	“Ymer Berisha”	Siqevë	14	7	7	7	2	340	386	726	51.86
15	“A.Gjergj Fishta”	Jagodë	15	7	7	7	3	533	375	908	64.86
16	“Dëshmorët”	Valljak	16	18	18	18	10	824	748	1572	43.67
17	“Dëshmorët e kombit”	Çabiq	17	23	23	23	10	1247	1087	2334	50.74
18	"Xhafer Gashi"	Përçevë	18	10	10	10	6	475	443	918	45.90
	<b>GJITHSEJ</b>			<b>583</b>	<b>582</b>	<b>585</b>	<b>265</b>	<b>30242</b>	<b>25642</b>	<b>55884</b>	<b>47.97</b>

**Shënim: vitin e kaluar shkalla e arritshmërisë ishte 50.85 %**

Nga vlerësimet e jashtme

**Rezultatet e provimit të maturës shtetërore 2022, 18 qershor 2022 (afati i parë)**

<b>Gjimnazi "Luigj Gurakuqi" Klinë</b>					
U testuan	Kaluan		Kalueshmëria <b>F</b>	Mbeten për afatin tjetër	% e kalueshmërisë
	<b>GJ</b>	<b>F</b>			
208	187	129	62.0	21	89.90
<b>SHMP "Fehmi Agani" Klinë</b>					
U testuan	Kaluan		Kalueshmëria <b>F</b>	Mbetën për afatin tjetër	% e kalueshmërisë
	<b>GJ</b>	<b>F</b>			
237	123	67	28.3	114	51.90
<b>Shkolla e mjekësisë "Keka Med" Klinë</b>					
U testuan	Kaluan		Kalueshmëria <b>F</b>	Mbetën për afatin tjetër	% e kalueshmërisë
	<b>GJ</b>	<b>F</b>			
40	38	26	65.0	2	95.00
U testuan gjithsej	<i>Kaluan gjithsej</i>		Kalueshmëria <b>F</b>	<b>Mbetën për afatin tjetër</b>	<b>% në nivel komunal</b>
	<b>GJ</b>	<b>F</b>			
485	348	222	45.8	137	71.75

Vitin e kaluar: gjimnazi 87.82; SHMP 68.25; Keka Med 74.36; në nivel komune 78.28

Nga vlerësimet e jashtme

**Rezultatet e provimit të maturës shtetërore 2022, 27 gusht 2022 (afati i dytë)**

<b>Gjimnazi "Luigj Gurakuqi" Klinë</b>					
U testuan	Kaluan		Kalueshmëria <b>F</b>	Mbeten për afatin tjetër	% e kalueshmërisë
	<b>GJ</b>	<b>F</b>			
8	3	3	37.5	5	37.50



<b>SHMP "Fehmi Agani" Klinë</b>					
U testuan	Kaluan		Kalueshmëria <b>F</b>	Mbetën për afatin tjetër	% e kalueshmërisë
	<b>GJ</b>	<b>F</b>			
53	29	15	28.3	24	54.72
<b>Shkolla e mjekësisë "Keka Med" Klinë</b>					
U testuan	Kaluan		Kalueshmëria <b>F</b>	Mbetën për afatin tjetër	% e kalueshmërisë
	<b>GJ</b>	<b>F</b>			
4	1	1	25.0	3	25.00
U testuan gjithsej	<i>Kaluan gjithsej</i>		Kalueshmëria <b>F</b>	<b>Mbetën për afatin tjetër</b>	<b>% në nivel komunal</b>
	<i>GJ</i>	<i>F</i>			
65	33	19	29.2	32	50.77

## **6.DREJTORIA PËR KADASTËR, GJEODEZI DHE PRONËSI**

Punët të cilat realizohen në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në Komunën e Klinës raportohen çdo vit.

*Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi gjatë viti 2022 ka funksionuar me stafin si në vijim:*

- Zyrarët për pranimin e qytetarëve,
- Zyrarja përgjegjëse për regjistrim në RDPP,

- Asistenti administrativ,
- Zyrtari për shërbim pronoro-juridik,
- Gjeodetet.

Disa nga punët të cilat janë kryer në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në Komunën e Klinës gjatë vitit 2022 janë:

- 1: Rritja e stafit punues (gjeodet dhe jurist).
- 2: Zgjedhja e problemit të zonës së Dushit dhe të disa zonave të tjera të cilat nuk janë të regjistruara në goportal.
- 3: Informimi me kohë i qytetarëve për miratimin apo refuzimin e kërkesave të tyre drejtuar për Drejtorinë e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë.
- 4: Trajnimi një javor i një gjeodeti në Agjensionin Kadastral të Kosovës për programin e legalizimit të objekteve dhe regjistrimin e tyre në Geoportal.
- 5: Trajnimi njëjavor i një juristit në Agjensionin Kadastral të Kosovës për lëndët rreth Shërbimit Pronëroro-Juridik.
- 6: Zbatimi i Rregullores NR.07/2021 në Drejtorinë e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë, për pezullimin e shërbimeve Komunale për mbledhjen e detyrimeve të papaguara të tatimit në pronë.
- 7: Mbajtja tabelare e raportit financiar të pagesave mujore të realizuara nga gjeodetët, zyrtarja përgjegjëse dhe zyrtaret në sportel në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.
- 8: Përfundimi i kërkesave të papërfunduara të gjeodetëve të licencuar.
- 9: Ofrimi i shërbimeve në rast nevojë për matjet në teren me kërkesë të drejtorive të tjera të cilat operojnë në Komunën e Klinës.
- 10: Kryerja e lëndëve të legalizimit të shtëpive, objekteve dhe lokaleve në goportal.

### **Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes**

01/01/2022-31/12/2022, Drejtoria : Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi

<u>Shkurt</u> <u>esa</u>	<u>Pranu</u> <u>ar</u>	<u>Në</u> <u>Proc</u> <u>es</u>	<u>Miratu</u> <u>ar</u>	<u>Refuzu</u> <u>ar</u>	<u>Hedh</u> <u>ur</u> <u>Posht</u> <u>ë</u>	<u>Pezullu</u> <u>ar</u>	<u>Anulu</u> <u>ar</u>	<u>Përfund</u> <u>uar</u>	<u>Tota</u> <u>li</u>
DKGJP	5	20	3461	28	0	1	47	0	3562

Pra siç shihet në tabelë gjatë periudhës njëvjeçare, Janar – Dhjetor 2022, në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi kanë arritur 3562 kërkesa të ndryshme përmes sistemit të intranetit, mirëpo në këto nuk janë të përfshira kërkesat për certifikata të pronësisë nga rastet sociale, me pas kërkesat nga prokuroria, policia, dhe nëse mblidhen edhe këto të cilat nuk janë të përfshira në sistemin intarnet numri total i kërkesave në bazë të evidencave zyrtare është 3998 kërkesa, të gjitha këto kërkesa janë regjistruar, evidentuar dhe protokolluar.

<b>GJATË VITIT 2022 NË DREJTORINË PËR KADASTËR, GJEODEZI DHE PRONËSI KONSTATOJM SE:</b>
---

<i>Janë lëshuar 2754 certifikata të pronësisë me pagesë nga zyrtarët përgjegjës</i>
---

<i>Janë lëshuar 91 certifikata që pala nuk posedon pronë me pagesë nga zyrtarët përgjegjës</i>
--

<i>Janë lëshuar 1523 kopje të planit me pagesë nga zyrtarët përgjegjës</i>
--

<i>Janë lëshuar 668 certifikata të pronësisë pa pagesë për raste sociale nga zyrtarët përgjegjës</i>
--

<i>Janë lëshuar 646 certifikata të pronësisë pa pagesë zyrtarisht nga zyrtarët përgjegjës</i>
---

<i>Janë lëshuar 11 kopje të planit pa pagesë zyrtarisht nga zyrtarët përgjegjës</i>
---

-Ndërsa në bazë të kërkesave siç janë të gjeodetve të licencuar, qoftë për ndarje-bashkim të parcelave, legalizimeve, vendosje në sistem të parcelave, historiatet, ekspertiza, aktvendime, marrëveshje të plotfuqishme të gjykatave ose organeve të tjera kompetente në drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi kanë arritur gjithsej **710 kërkesa**.

-Ndërsa tek zyrtarja përgjegjëse për regjistrimin dhe modifikimin e të dhënave në RDPP kanë arritur gjithsej **1341 lëndë** dhe janë nxjerrur vendimet për secilën prej tyre ku përfshihen kryesisht kontratat noteriale, lëndët e gjeodetve dhe vendimet e gjykatës.

-Përveç këtyre punëve të cilat janë kryer gjatë vitit 2022 në drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi gjatë këtij viti janë pranuar edhe tri kërkesa për ndërrim destinimi të tokës të cilat janë bërë me pëlqimin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

-Për nevoja të ndryshme të qytetarëve, përveç trajtimit të kërkesave të ndryshme të cilat janë bërë, dhe për secilën prej tyre pasiqë janë kthyer përgjigje janë ofruar edhe shërbimet siç janë lëshimi i certifikatave të pronësisë, certifikatave për social dhe lëshimi i certifikatës që nuk posedon pronë, me pas shërbimet nga gjeodetet si identifikimin e parcelave, lëshimi i kopjeve të planit, matjet për nevoja komunale, dhe me kërkesë të Gjykatës, Prokurorisë dhe Policisë,

me pas sigurimi i hartave Orto – foto, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, dhe ofrimi i shërbime përmes modelit të sistemit informativ mbi tokën dhe pronën me pas bartja e pronësisë në bazë të dokumenteve valide ligjore dhe të verifikuara si nga noteri, gjykata, dhe vendimet tjera të organeve administrative.

## **RAPORTI PERMBLEDHES I TË HYRAVE BUXHETORE PER VITIN 2022 SIPAS MUAJVE**

01/01/2022-31/12/2022, Drejtoria : Kadaster, Gjeodezi dhe Pronësi

<b>Jana</b>	<b>Shku</b>	<b>Mar</b>	<b>Pril</b>	<b>Ma</b>	<b>Qersh</b>	<b>Korri</b>	<b>Gus</b>	<b>Shtat</b>	<b>Teto</b>	<b>Nent</b>	<b>Dhjet</b>
4 mijë euro	4 mijë euro	7 mijë euro	5 mijë euro	5 mijë euro	8 mijë euro	7 mijë euro	9 mijë euro	4 mijë euro	7 mijë euro	5 mijë euro	7 mijë euro
817 euro		884 euro	238 euro	592 euro			343 euro		037 euro		

*Te hyrat vjetore në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi nga zyrtarët në sportel, gjeodetet dhe zyrtarja përgjegjëse për regjistrim në RDPP janë: 78 mijë e 482 Euro.*

### **7. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË**

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjence gjatë këtij viti është preokupuar në realizimin e plotë të punëve të planifikuara dhe mund të konstatojmë se ka qenë një vit shumë i suksesshëm. Gjatë periudhës vjetore 2022 në sektorin e shërbimeve publike nga ana e palëve janë parashtruar gjithsej: **475 kërkesa**, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me riparimin e rrugëve me zhavorr në fshatra dhe disa rrugica ne lagje të qytetit, riparim të gropave në rrugët me asfalt, furnizim me ujë dhe riparim të ujësjellësit, riparim dhe kyçje në kanalizim, leje për shfrytëzim të hapësirës publike, kërkesa për ndriçimin publik si dhe kërkesa për ndihmë me artikuj ushqimor dhe materialit ndërtimor për ndërtim apo renovim të shtëpive. Varësisht nga mundësit buxhetore jemi përgjigjur kërkesave të qytetarëve. Nga ana e drejtorisë janë shqyrtuar këto kërkesa dhe gjendja është si në vijim:

**Përshkrimi****Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes****01/01/2022 - 31/01/2023, Drejtoria: DSHPE**

Pranuar	7
Në Proces	12
Miratuar	415
Refuzuar	32
Hedhur Poshtë	2
Pezulluar	1
Ceduar	1
Anuluar	5
TOTALI	475

Ndërsa, sa ju përket projekteve të realizuara dhe në realizim e sipër për këtë vit, shkurtimisht po i theksojmë disa prej rezultateve të arritura për vitin 2022:

- **Mirëmbajtja e kamerave të qytetit.**

Edhe në vitin 2022 Komuna Klinës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka bërë rregullimin dhe përmirësimin e gjendjes së kamerave të qytetit të Klinës. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka monitoruar situatën dhe ka bërë mirëmbajtjen e kamerave, duke ndërruar ato dhe duke zëvendësuar me të reja, ka aktivizuar akse të prishura. Vlera e kontratës është 8,761.50€, dhe kontrata është 3vite.

- **Impianti për trajtimin biologjik të ujërave të zeza në fshatin Sferkë.**

Impianti i ndërtuar në fshatin Sferkë, i cili do të shërbejë për trajtimin e ujërave të zeza të fshatit Sferkë, duke ndihmuar edhe mjedisin si dhe duke përmirësuar gjendjen e fshatit. Kontrata është përfunduar dhe pranuar teknikisht dhe ka qenë në vlerë prej 178,032.50€.

- **Mirëmbajtja dhe riparimi i ndriçimit publik.** Në Vitin 2022, Komuna e Klinës ka mirëmbajtur rrjetin e saj në shumicën e fshatrave të Klinës, si në fshatin (Ujmirë, Dollovë, Këpuz, Gjurgjevik i Vogël, Poterq, Budisalc, Volljake dhe Sferkë). Investim ka pasur edhe në lagje të qytetit si në lagjen Arbëria, Dukagjini, lagjen e spitalit dhe qendrën e qytetit me rrugët kryesore. Përveç që ka pasur zgjerim të rrjetit të ndriçimit publik me drita 50ë në fshatra dhe 100ë në qytet, ka pasur vazhdimisht edhe mirëmbajtje të dritave.

- **Mirëmbajtja e drunjve dekorativ.**

Në qytet kemi rreth 300 trupa të drunjve dekorativ. Janë duke filluar nga sheshi “Ndue Perlleshi”, sheshi “ Mujë Krasniqi” , sheshi “ Nena Terezë” e deri te sheshi “Faruk Elezaj”. Duke qenë së për 3 vite rresht kjo pjesë e qytetit ishte në ndërtim për shkak të punime të tunelit dhe kalldrëmit, drunjte kishin pësuar dëmtime të mëdha, prandaj është dashur që në mënyrë profesionale të trajtohen të gjithë këta drunj, duke

filluar nga krasitja, plehërimi, trajtimi me insekticide, instalimi i sistemit të ujitjes, punimit të tokës për rreth etj. Tani pemët kanë marrë formë të mirë dhe të njëtrajtshme kanë rritje të mirë dhe janë të shëndetshme. Vlera e kontratës është 12,972.00€ dhe kontrata është 3 vite.

- **Furnizim me rroba të zjarrfikësve.**

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka investuar në rroba të zjarrfikësve duke, furnizuar ata me rroba dhe të mbathura, duke i bërë gati ata për një vit me komod. D.SH.P.E ka paguar 2,653.80€.

- **Mirëmbajtje e rrugëve me asfalt.**

Edhe në këtë vit ka vazhduar kontrata e cila ka qenë e lidhur në vitin 2021 dhe është bërë mirëmbajtja e rrugëve me asfalt edhe në vitin 2022, duke kompletuar rreth 6,209m<sup>2</sup>. Vlera e kontratës është 119,515.36€, dhe kjo kontratë ka përfunduar në fund të këtij viti.

- **Furnizim me zhavorr për riparim të rrugëve lokale.**

Po ashtu, gjatë këtij viti DSHPE ka bërë riparimin e rrugëve me zhavorr nga pjesa e mbetur e këtij projektit e kontraktuar në vitin 2021. Vlera e kontratës është 79,891.84€, dhe kjo kontratë ka përfunduar në këtë vit.

- **Furnizim me vegla punë për nevoja të komunës për mirëmbajtje të hapësirave publike.**

Furnizim me vegla pune të cilat punëtorët e kontraktuar komunal do t'i përdorin për mirëmbajtje të hapësirave publike të Komunës së Klinës. Kontratë 3vite me vlerë 9,917.31€.

- **Furnizim me pajisje për shërbimin e brigadës së zjarrfikësve.**

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka bërë një ndër investimet me të duhura sa i përket anës së zjarrfikësve dhe sigurisë qytetare, duke i furnizuar zjarrfikësit me pajisje për intervenim emergjent, si me pistona hapës, gërshtë haps dhe mbyllës, çanta shpinë me ujë dhe me mbushës të baterive të këtyre pajisjeve. Këto pajisje janë primare për një intervenim emergjent, duke mundësuar prerjen e metaleve dhe materialeve të ndryshme, hapjen e hapësirave të ngushta me piston haps dhe intervenimin me ujë me çanta të shpinës në hapësira të ngushta. Vlera e kontratës 13,471.41€.

- **Mirëmbajtja dhe riparimi e rrjetit të kanalizimeve.**

Rrjeti i kanalizimeve në shumë fshatra e qytet po paraqet problem të madh në mirëmbajtje. Hedhja e mbeturinave në puseta dhe kyçja e stallave të bagëtive apo ujërave të shiut, shpesh shkakton defekte shumë të mëdha. Problemi më i madh paraqitet në pjesët ku është instaluar kanalizimi, mirëpo nuk ka ende rrjet të ujësjellësit dhe si pasoje KRU HIDRODRINI nuk e merr në mbikëqyrje për shkak se nuk e vjelë tarifën e ujit të harxhuar. Ne kemi intervenuar në kanalizimet e fshatrave Caravik, Gllarevë e Gremnik. Kontrata ka qenë e 2021, por punët kanë përfunduar në mars të vitit 2022. Kontrata ka qenë në vlerë prej **8,590.00€**.

- **Ndërtim dhe riparim i kanalizimeve në Komunën e Klinës.**

Duke parë nevojën për intervenim urgjent për shkak të bllokimeve të kanalizimit dhe nevojë për përmirësimin e gypave, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka intervenuar në riparimin e kanalizimeve tek sheshi "Faruk Elezi", dhe në fshatin Zajm, Ujmirë, Sferkë, Drenoc Përqevë dhe Klinafc.

Vlera e kontratës 18,497.33€, ndërsa ka përfunduar 15,610.55€.

- **Trajtimi i qenve endacak.**

Qentë endacak janë problem i gjithë Kosovës, komuna e Klinës ndër komunat e pakta të Kosovës që kanë lidhur kontratë për trajtimin e qenve endacak. Drejtoria e

Shërbimeve Publike Emergjente kishe lidhur kontratë me shumën 20,000€ ku në këtë kontratë ne kemi trajtuar, sterilizuar, shëruar, larguar dhe ushqyer qentë endacak. Është bërë kastrimi i tyre dhe janë mbajtur dhe ushqyer e mbikëqyrur deri në shërimin e plotë të tyre, pastaj ata përsëri janë lëshuar në vendin ku janë kapur. Atyre ju ka kaluar tërbimi dhe rreziku nga ta. Kjo ka rezultuar në një sukses nga ana jonë, sepse janë eliminuar shumë rreziqe për qytetarët, kontrata ka qenë 3 vite dhe ka përfunduar në vitin 2022.

- **Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve pa asfalt.** (DEMET E KRIJUAR NGA VERSHIMET)

Komuna e Klinës pasi që rrethohet me shumë lumenj, ajo rrezikohet të vërshohet nga ujërat, duke rrezikuar jetët e qytetarëve tonë. DSHPE ka lidhur kontratë lidhur me rreziqet nga vërshimet duke lidhur kontrate 6 mujore e cila kap edhe vitin 2023, në vlerë prej 20,000€.

- **Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit.**

Qyteti i Klinës ishte qyteti më i dekoruar në krahasim me qytetet tjera. Patëm numër të madhe të qytetareve që vinin edhe nga qytetet tjera, posaçërisht nga qytetet fqinje për t'u kënaqur me atmosferën e krijuar për më shumë se 1 muaj rresht. Komuna nga buxheti i saj harxhoi vetëm 35,000.00€ nga kontrata 50,000.00€. Kontrata është 3vite.

- **Furnizim me material elektrik.**

Komuna e Klinës ka bërë furnizim me material elektrik shtese e cila ka shërbyer për mirëmbajtjen e ndriçimit publik, duke përmbushur disa pozicione të trupave ndriçues. Vlera e kontratës 3,474.39€

DSHPE gjatë vitit 2022 ka ndërprerë kontratat me këta operatorë për shkak të neglizhencës dhe mos seriozitetit në punë të treguar gjatë vitit 2021-2022.

1. Labinot M. Krasniqi BI NNP. TONI”,

2. ECO SËISS RECYCLING SHPK Prishtinë, më përfaqësues Afrim Morina;

## **NJPZSH KLINË**

### **NJESIA PROFESIONALE E ZJARRFIKËSEVE PËR SHPETIM**

NJPZSH në Klinë gjatë kësaj periudhe kohore aktivitetin e vetë e ka bazuar në planin e punës për vitin 2022 dhe si zakonisht ka arritur t'i përmbush me sukses objektivat e parapara me plan. NJPZSH ka vazhduar ta mbajë nivelin e gatishmërisë për reagime në rast nevojë edhe për raste emergjente për periudhën e lartcekur. Jemi angazhuar që shërbimet tona të jenë në nivel të përgjegjësisë dhe detyrës në përputhshmëri me kapacitetet tona ekzistuese. Jemi përgjigjur me kohë kërkesave të qytetarëve për pajisjen me vërtetime për demet e shkaktuara nga zjarret e ndodhura. Nga NJPZSH-it në Klinë gjatë kësaj periudhe ka pasur

gjithsej 293 dalje, 172 raste zjarri 64 shërbime dhe 12 vërshime 45 intervenime teknike. Në NJPZSH në Klinë disiplina në punë dhe respektimi i orarit të punës është në nivelin e lartë të përgjegjësisë, ndërrimet janë kryer sipas orarit të paraparë dhe niveli i gatishmërisë si zakonisht ishte në nivel të lartë për t'ju përgjigjur kërkesave-nevojave të qytetarëve të komunës tonë dhe më gjerë sipas nevojës dhe kapaciteteve tona ekzistuese. Të dhënat e detajuara për intervenimet e NJPZSH gjatë periudhës janar-qershor janë paraqitur në tabelarin që pason:

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve dhe struktura e zjarreve dhe intervenimeve tjera për janar - dhjetor 2022.

<b>Viti: 2022</b>	<b>REALIZIMI I NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË DALJEVE DHE INTERVENIMEVE PER MUAJN JANAR –QERSHOR 2022</b>							
	Nr.përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Shërbime	Aksident e rrugore	Vërshime	Të rrejshme.	Të ndryshme	Të lënduar
	293	172	64	18	12	1	26	0

<b>Viti - 2022</b>	<b>STRUKTURA E ZJARREVE</b>				
	Objekte ndërtimore	Zjarre në sipërfaqe të hapura	Zjarre në automjete	Elektrika-paisje elektrike	Të tjera
	14	139	3	11	5

## **8. DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE**

Duke u udhëhequr nga parimet themelore të ligjshmërisë, mbrojtjes së të drejtave të qytetarit dhe interesave publike të tij, efikasitetit, dëgjimit të palëve në procedurë, vlerësimit të lirë të dëshmive, vendosje, plotfuqishmërisë së aktvendimeve, Drejtoria për Punë Inspektuese e Komunës së Klinës ka përmbushur planin e saj të punës në pikat më kyçe si kontrollin inspektues të zbatimit të ligjshmërisë nga lëmi i shërbimeve publike, ndërtimit, bujqësisë dhe ambientit, tregut, trafikut, dhe atij financiar-legalizimit të ushtrimit të aktivitetit biznesor të subjekteve ekonomike dhe joekonomike etj.

Me qëllim të ndërtimit të strategjisë afatgjate në jetësimin e sundimit të Ligjit dhe luftimin e informalitetit -veprimeve kundërligjore të subjekteve që iu nënshtrohen kontrollit inspektues,



Organet e Drejtorisë për Punë Inspektuese në periudhën raportuese kanë ndërmarrur një seri aktivitetesh dhe veprimesh koordinuese në bashkëveprim edhe me Policinë e Kosovës në kontrollin e shfrytëzimit të paligjshëm të zhavorrit dhe rërës nga shtretërit e lumenjve, kontrollin e bizneseve, mbikëqyrjes së rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, PTK-së, KEDS-it dëmtimeve eventuale të rrugëve, trotuareve, hapësirave publike, respektimit të orarit të punës së bizneseve hoteliere sidomos gjatë punës në orët e vonshme të natës, mbarëvajtjes së tregjeve javore, mbikëqyrjen e transportit publik, mbikëqyrjen e pastrimit të rrugëve gjatë stinës së dimrit, kontrollin e artikujve ushqimor dhe të konsumit ditor nga aspekti i rregullsisë shëndetësore dhe afatshmërisë të përdorimit të tyre. Ndërlidhur me këtë nga ana e drejtorisë janë nxjerr një numër i konsideruar i akteve-urdhëresave ekzekutuese për eliminimin e lëshimeve të konstatuara. Këtu duhet shtuar se organizimi i punëve dhe detyrave të punës nga ana e eprorit të organit dhe inspektorëve, pos punëve të ushtruara në orarin e rregullt të punës, është bërë edhe gjatë ditëve të vikendit, festave fetare dhe shtetërore dhe me caktimin e kujdestarive si dhe punës në grupe.

Duke ushtruar kompetencat ligjore në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë nga sfera për Taksat, Tarifat dhe Ngarkesat si dhe në shqiptimin e gjobave për shkeljet e shkaktuara ligjore është inkasuar shuma prej 14,745.00 €, në emër të gjobave mandatorë dhe 6,808.55 € në emër të taksës për vlerësimin e kushteve minimale higjieno-teknike të hapësirave punuese-lokaleve në të cilat ushtrohet aktiviteti ekonomik nga Inspektori Financiar dhe Inspektori i Tregut.

Në total të hyrat për vitin 2022 janë 21,553.55 €. Nga personat fizik dhe ata juridik në nivel të drejtorisë janë proceduar **296** kërkesa të ndryshme nga të cilat **274** janë shqyrtuar dhe zgjidhur sipas procedurës së paraparë ligjore **10**, janë refuzuara si të pa bazuara – **1** është anuluar, janë **8** në procedurë të pritjes.

Më qëllim të informimit të ndërsjellë në relacionin: Organet e Inspektoratit dhe Drejtoria në raport me drejtoritë tjera dhe kryetarin e Komunës si dhe në vijën vertikale në raport me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe ministritë gjegjëse janë hartuar informata, raporte, memorandume dhe relacione tjera zyrtare në kërkesë të tyre dhe ato sipas detyrës zyrtare.

Duke perceptuar dhe shqyrtuar aspektet dhe veprimet e sipërshënuara, pashmangshëm rrjedh konstatimi i paraqitjes edhe të vështirësive dhe pengesave tjera që shfaqen përgjatë ushtrimit të kontrollit inspektues sidomos në numrin jo të mjaftueshëm të inspektorëve krahasuar me numrin e banorëve në komunën tonë, mosplotësimi i vendit të punës së Inspektorit Sanitar, demotivimi për punë nga pasoja shpërblimit jo adekuat krahasuar me punën e tyre/përgjegjësitë, punën jashtë orarit dhe rrezikshmërinë e ushtrimit të funksionit të tyre nga shkaku i kufizimeve buxhetore.

Në vijim paraqitet në vija të shkurtra puna veç e veç e secilit organ të inspektoratit pa pretenduar që të shkoqiten punët dhe aktivitetet e tyre rutinore dhe në detaje e që janë të përcaktuara në fushëveprimin dhe kompetencat e tyre ligjore.

## **INSPEKTIMET NGA LËMIA PUBLIKE**

Në këtë lëmi në periudhën raportuese janë ushtruar **327** mbikëqyrje inspektuese e që ka rezultuar me **200** procesverbale të përpiluara në vend. Në objektin e kontrollit ka qenë rrjeti i kanalizimit, ujësjellësit, ai elektrik, i telekomunikacionit, hapësirat urbane publike, organizimi i punëve në pastrimin e mbeturinave, veprimet e koordinuara me inspektorët tjerë në aksione të përbashkëta, inspektimi i tarracave në hapësirat publike, dalja në vend dhe

shqyrtimi-trajtimi i kërkesave të ndryshme të personave fizik dhe juridik të natyrës përkatëse, në stinën e dimrit organizimi dhe pjesëmarrja në pastrimin dhe lirim të rrugëve nga reshjet dhe punët tjera me prioritet nga fushëveprimi i tij.

Në procedurën e mbikëqyrjes së hapësirave publike janë nxjerr aktvendime për lejimin e bartjes së materialeve ndërtimore, aktvendim për transport (kamion) për bartjen e furrës së bukës, aktvendim për bartje të materialit të ngurtë me mjete transportuese (kamion), aktvendim për transport-bartje të pajisjeve bankare etj.

- ❖ Inspektive me qëllim të mbrojtjes së sipërfaqet publike nga dëmtimet, kyçje ilegale, dëmtimin e rrugëve dhe veprimet tjera ilegale;
- ❖ Inspektimin dhe largimin e pengesave tjera (panove, reklamave të ndryshme, tarracave etj.), nga sipërfaqet publike të cilët nuk janë të pajisur me pëlqim nga organet kompetente;
- ❖ Inspektive të tjera në bazë të ankesave të qytetarëve;
- ❖ Inspektimin dhe largimin e shitësve ambulantë dhe pengesave tjera të mbikëqyrë mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve, shesheve, parqeve, varrezave,
- ❖ Tregut të gjelbër, terreneve sportive dhe sipërfaqeve tjera publike, mbikëqyrin hedhjen e mbeturinave jashtë vendeve të caktuara, mbikëqyrin zbrazjen pa leje të materialeve (rërës, dheut, materialit tjetër ndërtimor,
- ❖ Punë të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi,
- ❖ Gjoha dhe procesverbale për mosrespektim të urdhrat të inspektorëve,
- ❖ Angazhimi në komisionin për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet.

Janë shqiptuar gjithsej **8** gjoha dhe **4** aktvendime për qarkullim në vlerë prej **1,345** euro, prej të cilave:

Gjoha për hedhje të mbeturinave, për thyerjen e rregullave të komunikacionit me mjete transporti, eksploatim i zhavorrit në mënyrë ilegale, ushtrim veprimtarive të tregut në vende të palejuara, për mosrespektim të afatit për aplikim për shfrytëzim të hapësirës publike, për mosrespektim të afatit të caktuar kohor për kthim në gjendje të mëparshme, për ndërtim pa leje të tarracës ushtron veprimtari si taxi ilegal.

## **INSPEKTIVET NGA LËMI I NDËRTIMIT**

Në këtë resor duke ushtruar mbikëqyrjen inspektuese në zbatimin e dispozitave ligjore të ndërtimit janë ushtruar **76** kontrole duke përfshirë edhe ato monitoruese inspektuese, janë hartuar **67** procesverbale në vend dhe janë mbajtur nën kontroll të gjitha ndërtimet, duke shtuar këtu edhe organizimin e punës në formë kujdestarie, gjatë ditëve të vikendit dhe atyre të festave të ndryshme. Po ashtu, është koordinuar dhe bashkëvepruar me inspektorët tjerë në kuadër të drejtorisë në punët e përbashkëta si në punët e tregjeve javore inspektimi i tarracave në hapësirat publike me inspektor të shërbimeve publike në kuadër të mbrojtjes dhe ruajtjes së ambientit etj. Nga ky organ janë shqiptuar gjoha në vlerë prej **8,700 €**.

## **INSPEKTIMI NË LËMIN E KOMUNIKACIONIT/TRAFIKUT**

Arsyetim: Ligji Nr. 03/L-212 dhe nenit 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Inspektori i komunikacionit/trafikut Nazmi Elshani, për shkak të gjendjes shëndetësore (sipas qarkores zyrtare të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë e përgatitur për këtë qëllim) punëtorët me sëmundje kronike dhe të ngjashme lirohet nga punëdhënësi në punët në teren.

Inspektori komunikacionit sipas fuqisë ligjore punët dhe detyrat punuese me autorizim të eprorit të organit në periudhën raportuese ka ushtruar Komisioni Inspektues.

Ky organ në vitin raportues ka ushtruar mbikëqyrje inspektuese nga lëmi i transportit të udhëtarëve dhe mallrave, mbarëvajtja e shenjave të trafikut në rrugët rajonale dhe ato lokale, vendosja në kërkesat e palëve etj. Në lidhje me këtë janë hartuar si dhe janë evidentuar monitorime nga sfera e qarkullimit të mjeteve të transportit të udhëtarëve, si brenda lokalitetit të Klinës ashtu edhe jashtë saj përkatësisht të qendrave të lokalitetit në territorin e Komunës së Klinës. Është asistuar në vendosjen dhe shenjëzimin e shenjave vertikale dhe horizontale në qytet dhe në fshatrat e Komunës së Klinës, ku edhe janë bërë procesverbale dhe fotografi për punët në të cilat janë kryer si:

- Vendosje e vendkalimit për këmbësor prej 850 m<sup>2</sup>,
- Është caktuar lokacioni i ri për taxi prej 12 vendparkingje-taxi ku është pajisur me shenja vertikale dhe horizontale,
- Janë krijuar 12 vend parkingje të personave me aftësi të kufizuar afër institucioneve publike dhe rregulluar ato që kanë qenë ekzistuese,
- Është bërë vendosje e afër 200 shenjave të komunikacionit në tërë territorin e komunës së Klinës, si shenja të rrezikut, lajmërimit, urdhrave të prera etj.

Po ashtu, është bashkëvepruar me organet tjera inspektuese në aksione të përbashkëta të planifikuara nga drejtoria.

## **INSPEKTIMI NGA LËMI I BUQËSISË DHE AMBIENTIT**

Gjatë periudhës raportuese për vitin 2022 nga lëmi i inspeksionit të bujqësisë dhe ambientit janë ushtruar aktivitete si:

- Inspektime të ekspluatuesit e resurseve natyrore si rërës, gurit, dhe zhavorrit,
- Verifikimin e bartjeve të zhavorrit me mjete transportuese se a janë të pajisur me dokumentet e nevojshme apo bëjnë bartje ilegale të zhavorrit,
- Inspektime për hedhje të mbeturinave në hapësira publike,
- Inspektime për djegie të mbeturinave dhe ndotje të ambientit,
- Kontrollime për kualitetin e prodhimeve bujqësore,
- Kontrollimin e barnatoreve bujqësore se a janë të pajisur me aktvendime për ushtrimin e veprimtarisë,

Nga këto aktivitete janë bërë **70** kontrollime inspektuese prej tyre janë bërë **40** procesverbale mbi konstatimin e gjendjes, si dhe **17** gjoba të shqiptuara, **4** gjoba për eksplantim i zhavorrit dhe bartje e zhavorrit në mënyre ilegale **7** gjoba për hedhje të mbeturinave në hapësira publike, **6** djegie e mbeturinave dhe ndotje të ambientit.

Në total realizimi i të hyrave është 1,100 €.

## **INSPEKTIMI NË LËMIN E TREGUT**

Mbikëqyrja e kushteve të ushtrimit të veprimtarive ekonomike, qarkullimit të mallrave dhe mbi bazën e obligimit ligjor për përpilimin dhe skicimin e shënimeve dhe të dhënave për punën dhe aktivitetin e ushtruar dhe punëve të kryera gjatë vitit **2022**, më poshtë do të listohen punët dhe aktivitetet punuese të organit të Inspektoratit të Tregut sipas strukturës dhe tipave të kontrollit të ushtruar ndaj subjekteve që i'u janë nënshtruar mbikëqyrjes inspektuese në zbatimin e dispozitave ligjore pozitive të Ligjit për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, atë për Tregtinë e Brendshme, të Mbrojtës së Konsumatorëve, njësave

matëse. Mbikëqyrja e kushteve të ushtrimit të veprimtarive ekonomike, qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve, kualiteti i produkteve industriale dhe ushqimore, cilësia e shërbimeve, verifikimi i regjistrimit (pajisje me Certifikata për Regjistrim të Biznesit), të gjitha subjekteve afariste tregtare dhe shërbyese, objekteve dhe subjekteve tjera, pajisëshmëria me leje të punës.

Procesverbale të hartuara mbi faktimin e gjendjes e që i referohen të njëjtit aktivitet për përcaktimin e veprimeve dhe procedimi i mëtejme administrativo-procedural-**127**.

Puna në Komisionin Inspektues në përcaktimin e kushteve minimale teknike, sanitare-higjienike, ku janë pajisur **71** lokale me aktvendime dhe inkasuar **6,268.55** €, nga bizneset ku janë plotësuar urdhërpagesat për kompensim të pagesave në emër të taksës. Në koordinim me zyrën për biznese janë mbarështuar dhe është punuar në zgjidhjen e kërkesave për lejimin e zgjatjes së orarit të punës së subjekteve afariste nga lëmia hoteliere dhe kafiteri që është në konformitet me Rregulloren përkatëse komunale, shënohen raste **13**.

Në bashkëveprim me Inspektorin sanitar dhe të tjerë është larguar nga qarkullimi mall dhe produkte ushqimore me afat të skaduar për përdorim të prishura- pa deklaracion për shitje ku është inkasuar shuma prej **90** € në emër të taksës për punën komisionarë konform Rregullores për Taksat, Ngarkesat dhe Tarifat, kurse vlera e mallit të asgjësuar **54,221**€.

Gjoha të shqiptuara ndaj subjekteve dhe individëve për shkelje ligjore (për përcaktuara me dispozita ligjore), gjatë ushtrimit të aktivitetit afarist apo të ngjashme për **16** raste që kap shumën totale prej **3,210** €. **Në total realizimi i te hyrave është 9,648.55 euro**

Në pasqyrimin e punëve dhe aktiviteteve punuese për vitin raportues nuk është përfshirë puna qoftë vetanake, qoftë në bashkëveprim me Inspektoret e Tregut pranë MTI-së sipas Planit të Veprimit të Inspektoratit të Tregut në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Republikës së Kosovës për çfarë sipas një vije të veçantë ka qenë e nevojshme korrespondimi dhe raportimi për të njëjtit.

## **INSPEKTIMI NGA LËMI FINANCIAR-LEJEVE TË PUNËS/REGJISTRIMIT/ TË BIZNESEVE**

Në këtë lëmi janë ushtruar 95 mbikëqyrje inspektuese kurse lidhur me to janë hartuar 87 procesverbale për konstatimin e gjendjes në vend. Janë nxjerrë 15 Aktvendime nga komisioni për përcaktimin e kushteve minimale teknike higjiëno-sanitare ku janë inkasuar 300 €, taksa si dhe për, Dënime mandatorë në shumën prej 540 €, për biznese ku janë plotësuar urdhërpagesat për kompensim të pagesave në emër të taksës. Po ashtu, është bashkëpunëtor me inspektoret tjerë në nivel të drejtorisë në aksionet e koordinuara të përbashkëta dhe në monitorimin e tregjeve. Është udhëhequr evidenca e lëvizjes së pagesave të ndryshme në emër të taksave, ngarkesave dhe tarifave dhe kontrolli në përlllogaritjen dhe orientimin e drejtë të tyre.

### **PROPOZIMI I MASAVE:**

Duke konkluduar mbi konstatimet e sipërshënuara dhe efektet e arritura nga periudha raportuese, paraqitet domosdoshmëria në ndërmarrjen e masave dhe veprimeve në:

- ngritjen përkatësisht stimulimin material të inspektorëve duke korrigjuar koeficientin në përfitimin e të ardhurave personale dhe kompensimin për punën gjatë ditëve të festave, vikendeve apo jashtë orarit të punës;

- shtimin e numrit të Inspektorëve sipas standardeve ligjore në përpjesëtim me numrin e rezidentëve/banorëve/në komunë.

## **9. DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Me fillimin e vitit 2022 është bërë plani i punës në bazë të të cilit Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do t'i kryej të gjitha punët dhe aktivitetet e saj.

Ne si drejtori përveç planifikimeve në planin tonë të punës kryejmë edhe detyra që dalin nga Ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dh veçanërisht aplikimi i fermerëve për subvencionim, raportimin për realizimin e mbjelljeve të kulturave bujqësore, korrje shirjeve, ndërrimi i kulturës bujqësore nga tokë pyjore në tokë bujqësore(sipas kërkesave të fermerëve), raportimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore, etj.

Më datën 21.01.2022 ka filluar aplikimi i fermerëve për subvencionimin e qumështit për sasi dhe majmëri të viçave që mbështet nga Ministria e Bujqësisë. Ky aplikim ka zgjatur deri më 11.02.2022 e që është për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2021.

Duke e pasur parasysh se mbjelljet pranverore fillojnë herët në pranverë ne paraprakisht si drejtori kemi përgatitur planin e të mbjelljeve pranverore dhe njëkohësisht kemi këshilluar fermerët që t'i aplikojnë të gjitha masat agroteknike si dhe të përdorin farëra cilësore dhe të certifikuar.

Këtë plan po e paraqesim edhe formë tabelore për vitin 2022:

Nr.	Kultura	Sipërfaqet e planifikuara ha	Sipërfaqet e realizuara ha
1.	Misër	2990	2995
2.	Tërshëre	260	260
3.	Perime	210	215
4.	Patate	140	155
5.	Bimë foragjere	770	790
6.	Të tjera	80	75
	Gjithsej	4450	44090

Siç shihet nga tabela plani i mbjelljeve pranverore është realizuar pothuajse në tërësi me disa ndryshime të vogla sipas kulturave dhe sipërfaqeve të mbjella.

Gjatë kësaj kohe ne si drejtori e Bujqësisë vazhdimisht kemi monitoruar procesin e mbjelljeve pranverore dhe kemi këshilluar fermerët t'i përmbahen masave agroteknike.

Këtë vit aplikim i fermerëve për subvencione që mbështeten nga Ministria e Bujqësisë ka filluar nga data 26.04.2022 deri më datën 01.06.2022. Gjithsej kanë aplikuar 940 fermer për drithëra, perime, pemë dhe blegtori.

Me fillimin e aplikimit të subvencioneve drejtorja e bujqësisë paraprakisht i ka njoftuar fermerët për afatin dhe për dokumentacionin e nevojshëm për aplikim dhe gjatë kësaj periudhe procesi ka shkuar mirë dhe interesimi i fermerëve ka qenë i madh.

Duke pasur parasysh afatin shumë të shkurtër për aplikim, ne kemi punuar edhe jashtë orarit të punës në mënyrë që mos të mbetet asnjë fermer pa aplikuar.

Në Drejtorin e Bujqësisë në Klinë deri më tani janë të regjistruar 2340 fermerë në regjistrin e fermës, e cila është bazë për aplikim me qëllim të përfitimit të subvencioneve, grandeve dhe nevojave tjera të bujqësisë.

Para fillimit të korrje-shirjeve është formuar komisioni në nivel komunal për përcjelljen e kësaj fushate. Ky komision nga fillimi deri në përfundim ka monitoruar fazën e korrje shirjeve, inspektimin e autokombajnave për gjendjen teknike të tyre dhe vazhdimisht i kemi

këshilluar fermerët që të mos bëjnë djegien e hamulloreve duke pasur parasysh se janë të dëmshme për token bujqësore dhe ambientin.

Rendimenti i grurit këtë vit ka qenë mesatar duke marrur parasysh kushtet jo të favorshme klimatike si dhe paraqitjen e sëmundjeve të ndryshme.

Pas përfundimit të korrje-shirjeve fermerët kanë sjellë formularin për sasinë e grurit të dorëzuar në pikat grumbulluese të grurit-mullinj deri më 02.09.2022, të cilët më pastaj ne i kemi dërguar në MBPZHR për subvencionim.

Aplikimi i fermerëve për subvencionimin e qumështit dhe viçave për majmëri nga Ministria e Bujqësisë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 ka filluar prej datës 20.07.2022 deri me 19.08.2022.

#### **Nga Drejtoria e Bujqësisë këtë vit janë realizuar këto projekte:**

- Shpërndarja e makinave mjelëse për lopë qumështorë dhe dele (50 copë),
- Projekti i serrave në sipërfaqe 50 m<sup>2</sup> (përfitues janë 100 fermerë),
- Ndërtimi i kanalit për ujëra mbledhëse në Pjetërq të Epërm(në ndërtim e sipër),
- Ndërtimi i kanalit të ujitjes në Dollovë,
- Ndërtimi i kanalit të ujitjes në Krushevë të Madhe(në ndërtim e sipër),
- Ndërtimi kanalit për ujëra mbledhëse në Zllakuqan.

Projektet dhe subvencionet kanë ndikuar në zhvillimin e bujqësisë dhe rritjen e të ardhurave për ekonomi familjare.

Përpos punëve me palë në zyrë, vazhdimisht ne kemi vizituar fermerët: lavërtarë, bletarë, pemëtarë, blegtorë, të cilët i kemi mbështet në dhënien e këshillave në këto fusha, orientimin e tyre për një bujqësi të qëndrueshme, po ashtu janë shpërndarë edhe broshura me tema të caktuara në lëmin e bujqësisë.

Për të qenë sa më të suksesshëm dhe për t'u kryer në afat optimal mbjelljet vjeshtore në vazhdimisht kemi këshilluar fermerët që të bëjnë përgatitjen me kohë të sipërfaqeve tokësore, të përdorin farërat cilësore të certifikuar dhe plehrat minerale.

Para fillimit të mbjelljeve vjeshtore ne si Drejtori e Bujqësisë kemi hartuar planin për mbjelljet vjeshtore, të cilin po e paraqesim në formë tabelore për vitin 2022/2023.

Nr.	Kultura	Sipërfaqet e planifikuara ha	Sipërfaqet e realizuara ha
1.	Grurë	4540	4550
2.	Elb	170	175
3.	Thekër	115	120
4.	Foragjere	410	420
	Gjithsej	5235	5265

Gjatë këtij viti kushtet kanë qenë shumë të favorshme për mbjellje, mirëpo këtë vit çmimet e plehrave minerale, farërave dhe karburanteve kanë qenë shumë më të larta.

Ky vit është karakterizuar me breshër dhe vërshime dhe në bazë të kërkesave nga ana e fermerëve, ne si përfaqësues të Drejtorisë së Bujqësisë kemi inspektuar terrenin dhe kemi bërë vlerësimin e demit në kulturat bujqësore.

Ne si Drejtori e Bujqësisë kemi bashkëpunim me OJQ, me drejtorit komunalë të bujqësisë së komunave tjera.

Në kuadër të Festivalit Folklorik Mbarëkombëtar i “Këndojmë Lirisë” kemi organizuar panairin e produkteve bujqësore në të cilin fermerët e Klinës dhe të komunave tjera kanë ekspozuar prodhimet e tyre për tri ditë radhazi.

Po ashtu, në fund të muajit shtator kemi organizuar panairin e produkteve bujqësore, i financuar nga Bashkësia Evropiane në të cilën produktet e tyre i kanë ekspozuar fermerët klinas si dhe fermerët nga Shqipëria–Hasi.

Vizitw studimore në Shqipëri në kuadër të projektit ndërkufitar “Kapërcimi i Gjellbër Drejt Ekonomisë së Gjellbër Vendore”.

### **Spektori i Pylltarisë gjatë vitit 2022 ka zhvilluar aktivitet si në vijim:**

Në vazhdimësi ka monitoruar gjendjen e pyjeve në të gjitha rajonet ekonomike pyjore që janë në pronësi shoqërore dhe mbrohen si kompetencë e deleguar nga Komuna e Klinës;

Ka iniciuar procedurën penale në stacionin policore në Klinë ndaj 41 personave për shkak të uzurpimit të tokave pyjore dhe pyjeve pronë e Agjencisë Pyjore, por që mbrohen si kompetence e deleguar nga komuna e Klinës;

Ka filluar me regjistrimin e demit pyjor të shkaktuar nga dëmtuesit e pyllit gjatë vitit 2022 (ende nuk është përfunduar regjistrimi i dëmeve). Ka konstatuar se demin i arsyetuar me fletëparaqitje në pronën shoqërore është 30.27 m<sup>3</sup>, ndërsa në pronën private është 19.64 m<sup>3</sup>;

Ka ushtruar njëzetënëntë (29) fletëparaqitjeve në Gjykatën Themelore Pejë–Dega Klinë, divizionin për kundërvajtje, kundër dëmtuesve të pyllit, njëzet e gjashtë (26) për shkak të dëmtimit të pyllit në pronën shoqërore dhe tri (3) në pronën private;

Ka përgatitur dhe ushtruar gjashtë (6) ankesa në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, kundër aktgjykimeve të shkallës së parë të Gjykatës Themelore Pejë – Dega Klinë;

Ka përgatitur dhe dorëzuar në Gjykatën Themelore Pejë – Dega Klinë dhjetë (10) parashtrës, një (1) për plotësimin e fletëparaqitjes së ushtruar nga rojet e pyllit, tri (3) për informim lidhur me ecurinë e procedurës gjyqësore, gjashtë (6) për përshpejtim të zgjedhjes së fletëparaqitjeve të ushtruara nga Drejtoria e Bujqësisë;

Ka pranuar njëzetedy (22) aktgjykime dënuese nga Gjykata Themelore Pejë – Dega Klinë dhe gjashtë (6) aktgjykime nga Gjykata e Apelit. Vlera e gjobave të shqiptuara është 7150.- €;

Ka përfaqësuar Drejtorinë e Bujqësisë në dyzet (40) seanca Gjyqësore, në procedurën kundërvajtës;



Ka sekuestruar 21.16 m<sup>3</sup> masë drusore, 1.55 m<sup>3</sup> të prerë në pronën shoqërore dhe 19.61 m<sup>3</sup> në pronën private;

Ka shqyrtuar njëmbëdhjetë (11) kërkesa të parashtruara nga qytetaret për damkimin e masës drunore në pyjet private. Pas shqyrtimit ka lëshuar katër (4) leje për prerje në pyjet private dhe pesë (5) fletë përcjellje për transportimin e masës drusore të shitura përmes ankandit publik;

Në baza mujore ka përgatitur dhe dërguar raportet mujore, lidhur me aktivitet e ndërmarra në pyll, në drejtorin koordinuese të APK-se në Pejë;

Ka përgatitur raportet dhe planet mujore të punës, ato vjetore, si dhe planin për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri;

Ka kryer edhe aktivitete të tjera, sipas urdhrimit të drejtorit të drejtorisë.

## **10. DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE**

### **Fushëveprimtaria:**

Bazuar në Ligjin për vetëqeverisjen lokale, Ligjin për shëndetësi, Statutin e Komunës së Klinës, rregulloret komunale, urdhëresat dhe udhëzimet, drejtorja ka këtë fushëveprim:

- Mbikëqyrja e punës së Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare /QKMF/, Qendrës së Mjekësisë Familjare /QMF/, Ambulancës së Mjekësisë Familjare /AMF/ dhe Qendrës për Punë Sociale /QPS/.
- Hartimi i strategjisë për kujdesin parësor shëndetësor që përfshinë: promovimin, parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve,

edukimin shëndetësor, imunizimin, diagnostifikimin e parë dhe kujdesin themelor shëndetësor, promovimin e shëndetit oral dhe kujdesit themelor stomatologjik.

- Vlerësimin e nevojave lokale për shëndetësi primare.
- Koordinon dhe mbikëqyr punën e Qendrës për Punë Sociale dhe përmes saj siguron ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të komunës së Klinës, sipas standardeve të specifikuara nga ministria përkatëse.
- Përmes QPS siguron implementimin e plotë të infrastrukturës ligjore që rregullon përkujdesjen e rasteve sociale të popullatës së komunës, përmes shpërndarjes së drejtë të ndihmës sociale.
- Mbikëqyrjes së situatës epidemiologjike në nivel të komunës.
- Të zhvillojë buxhetin bazuar në nevojat lokale duke iu përmbajtur udhëzimeve nga MSh dhe Kuvendi komunal i Klinës.
- Vendos dhe mbledh bashkë-pagesat, liron kategoritë e caktuara të shoqërisë brenda kornizës së caktuar nga MSh dhe Kuvendi komunal.
- Siguron ofrimin e shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Klinës.
- Raporton mbi të arriturat e objektivave të përcaktuara, Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës.
- Zhvillimi, monitorimi dhe zbatimi i rregulloreve ekzistuese që i lëshon MSh dhe kuvendi komunal.
- Zbaton normat dhe standardet e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore të aprovuara nga MSH dhe Kuvendi i Komunës.
- Bashkëpunon me MSH, vendos dhe zbaton politikat e mbrojtjes së kategorive të fëmijëve të rrezikuar dhe të gjitha kategoritë tjera të fëmijëve, përmes QPS, në nivelin lokal.
- Përkujdeset për sigurimin e strehimit për të pastrehët.
- Ushtron edhe kompetencat tjera që dalin nga ligjet e veçanta, statut të komunës, akte nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror.

## **QKMF / QMF / AMF – Raport i punës**

Objektivi kryesor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, përgjatë vitit 2022, ka qenë ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët.

Gjatë kësaj periudhe kohore është bërë rritja e numrit të shërbimeve mjekësore të ofruara në QKMF, është përmirësuar furnizimi me medikamente për pacientët, janë përmirësuar shërbimet e patronazhes, kujdesit paliativ, etj.

Furnizimet mjekësore /barna dhe paJisje mjekësore/ janë bërë me kohë dhe në sasi të mjaftueshme falë investimeve nga Komuna e Klinës si dhe nga Lista esenciale e Ministrisë së

Shëndetësisë. Qytetarët tanë kanë marrë shërbime cilësore në QKMF dhe janë furnizuar në masë të madhe me barna. Nga buxheti i komunës së Klinës, nga kategoria mallra dhe shërbime janë blerë me dy kontratat për furnizime me barna, rreth 35,000 euro.

Rritja e gamës së shërbimeve dhe cilësisë në Diagnostikë - edhe në shërbimin e diagnostikës në QKMF janë kryer numër i madh i shërbimeve cilësore, analiza laboratorike dhe shërbime të rëntgenit, me aparatura moderne dhe pa kosto për shumicën e qytetarëve. Më shumë se 20,000 qytetarë kanë kryer shërbime diagnostike, analiza laboratorike dhe shërbime të rëntgenit. Gjatë vitit 2022 është bërë furnizimi me pajisje të reja laboratorike të cilat do të përmirësojnë edhe më shumë cilësinë e shërbimeve të ofruara si dhe do të rrisin edhe gamen e shërbimeve në laboratorin e QKMF-së. Vlera e pajisjeve të reja të blera në QKMF nga buxheti i komunës është afër 60,000 euro. Gjithashtu, kemi pranuar donacione në pajisje të reja nga KFOR-i si dhe Ministria e Shëndetësisë.

Gjatë vitit 2022 nuk kanë munguar edhe investimet kapitale në QKMF, duke përmirësuar dukshëm kushtet e punës dhe ofrimin e shërbimeve profesionale për qytetarët e komunës sonë. Janë krijuar hapësira të reja dhe është bërë renovimi i hapësirave ekzistuese për përmirësimin e shërbimeve mjekësore, ordinancave specialistike dhe barnatores së QKMF-së. Vlera e investimeve kapitale gjatë vitit 2022 ka qenë rreth 75,000 euro, prej tyre nga buxheti i komunës janë shpenzuar 50,000 euro kurse pjesa tjetër është bërë nga projekti i AQH-së.

Ngritja e kapaciteteve të resurseve njerëzore për përmirësimin e shërbimeve mjekësore ka qenë prioritet edhe përgjatë vitit 2022. Është bërë trajnimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore përmes bashkëpunimit me organizata dhe institucione tjera relevante si dhe janë kryer procedurat e rekrutimeve për stafin mjekësor dhe teknikëve të infermierisë.

Ka vazhduar bashkëpunimi me donatorët ekzistues dhe janë zhvilluar takimet e reja me donatorët potencial ku janë prezantuar objektivat tona parësore dhe projektet e planifikuara.

Vëmendje e madhe i është kushtuar programit për kujdesin mjekësor për të moshuarit, kujdesit paliativ dhe pacientëve terminal si dhe kujdesit mjekësor për komunitetet pakicë. Është rritur angazhimi në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për fëmijët 0-3 vjeç si dhe gratë shtatzëna dhe lehonat, duke pasur mbështetje të vazhdueshme edhe nga programi i UNICEF-it. Është bërë ofrimi i shërbimeve mjekësore në shtëpi për pacientët që nuk kanë mundur të kryejnë shërbimet mjekësore në QKMF dhe AMF.

Sfidë ka mbetur funksionalizimi i plotë i Sistemit Informativ Shëndetësor.

### **Vizitat Mjekësore**


	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gushte	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Mjekësia Familjare	7253	5415	6516	4374	5637	5562	6149	4951	5314	5545	5776	5904
Pediatria	331	171	352	125	0	609	225	279	304	329	91	142

Gjinekologjia	22	54	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Stomatologjia	108	182	170	139	167	157	123	185	181	135	138	155
Specialistika	1463	1936	1942	1341	1462	1415	931	2079	1704	1586	1817	1351
Totali	9177	7758	8980	5979	7266	7743	7428	7494	7503	7595	7822	7552

Totali

Mjekësia Familjare	68396
Pediatria	2958
Gjinekologjia	76
Stomatologjia	1840
Specialistika	19027
Totali	92297

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gushte	Shtator	Tetor	Nëntor	Dh
Trendi Mujor	9177	7758	8980	5979	7266	7743	7428	7494	7503	7595	7822	7




## Shërbimet Shëndetësore

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gushte	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Barnatorja	769	1011	1248	959	1090	1075	813	851	762	960	456	627	10621
Echo	10	35	38	0	3	21	16	9	21	65	35	9	262
Ekg	90	104	209	132	64	108	27	37	183	0	196	106	1256
Injeksione	2080	1523	678	1652	1388	1982	1148	1554	1498	1798	1649	1198	18148
Infuzione	2237	1831	1792	1203	1018	1608	3347	1954	1193	1288	1173	1388	20032
Inhalime	129	42	126	200	114	37	24	34	125	82	292	308	1513
Laboratori	989	1067	1318	947	1141	1282	1330	0	1234	1356	1297	1295	13256
Lidhje	397	457	623	688	566	613	621	586	648	1768	644	747	8358
Qepje	79	0	1	3	0	0	0	0	0	38	57	0	178
Rentgeni	677	668	653	0	594	615	649	853	533	495	540	485	6762
Vaksinimi	160	141	188	168	183	186	161	67	151	207	1459	438	3509
Injeksione- I.M	2251	876	2381	968	790	1168	819	780	1598	937	1270	1130	14968
Terreni	529	411	664	458	628	382	487	361	586	701	425	519	6151
<b>Totali</b>	<b>10397</b>	<b>8166</b>	<b>9919</b>	<b>7378</b>	<b>7579</b>	<b>9077</b>	<b>9442</b>	<b>7086</b>	<b>8532</b>	<b>9695</b>	<b>9493</b>	<b>8250</b>	<b>105014</b>


### Totali 12 Mujor i shërbimeve

Barnatorja	10621
Echo	262
Ekg	1256
Inekcione	18148
Infuzione	20032
Inhalime	1513
Laboratori	13256
Lidhje	8358
Qepje	178
Rentgeni	6762
Vaksinimi	3509
Inekcione-I.M	14968
Terreni	6151

### Totali 12 Mujore shërbimeve




	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gushte	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Trendi mujor i shërbimeve	10397	8166	9919	7378	7579	9077	9442	7086	8532	9695	9493	8250





	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gushte	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Trendi Mujor I shërbimeve	10397	8166	9919	7378	7579	9077	9442	7086	8532	9695	9493	8250
Trendi Mujor I vizitave	9177	7758	8980	5979	7266	7743	7428	7494	7503	7595	7822	7552
<b>Totali</b>	<b>19574</b>	<b>15924</b>	<b>18899</b>	<b>13357</b>	<b>14845</b>	<b>16820</b>	<b>16870</b>	<b>14580</b>	<b>16035</b>	<b>17290</b>	<b>17315</b>	<b>15802</b>

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gushte	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Mesatare
Organizimi I Kornatores nga SH	70%	70%	50%	50%	60%	50%	35%	35%	30%	30%	30%	30%	40%
Ushqimtare	219	219	221	224	225	228	228	232	238	238	242	244	230
Ushqimtare Fëmijë	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7





	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gushte	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
aksidentuar	41	6	14	10	5	5	11	9	4	7	5	8	1
ekje	1	1	1	3	0	0	0	1	1	0	2	1	
kologjike	5	5	36	11	11	12	10	8	6	15	20	21	1
zitat në ëpi Nena e Fëmijë	101	144	153	153	131	91	81	107	101	101	114	70	13



## QENDRA PËR PUNË SOCIALE

Qendra për Punë Sociale në bazë të fushë veprimtarisë së vet ka bërë përpjekje për kryerjen e misionit të saj në mënyrën më të mirë duke u mbështetur në detyrat dhe obligimet që i posedon në raport me ofrimin e shërbimeve për qytetarët pa dallim. Po ashtu, kujdes i veçantë i është kushtuar implementimit të politikave që janë nxjerrë nga niveli qeveritar në implementimin e standardeve për mbrojtën e kategorive të ndryshme sociale që kanë nevojë për këto shërbime.

Në kuadër të misionit të QPS-së tretman i veçantë i është kushtuar kategorive më të rrezikuara dhe që kanë nevojë për shërbimet që ju ofron ky institucion në veçanti për këto kategori: Fëmijët e braktisur, fëmijët pa kujdes prindëror, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit, personat e moshuar dhe pa përkujdesje, personat më nevojta të veçanta, delikuentet etj.

Mision tjetër i QPS-së ka qenë edhe ofrimi i ndihmës financiare nëpërmjet sektorit të Asistencës Sociale për familjet nevojtare të cilat i plotësojnë kriteret që janë të parapara në Ligjin dhe Udhëzimet Administrative në fuqi, gjithmonë duke u bazuar edhe në verifikimin dhe monitorimin e këtyre familjeve nevojtare.

### **Fusha e trajnimit**

Gjatë vitit 2022 stafi i Qendrës për Punë Sociale ka marrë pjesë në disa trajnime kryesisht të fushës sociale, ku edhe janë certifikuar.

### **Bashkëpunimi më Organizatat joqeveritare**

Kur jemi të bashkëpunimi më Organizatat Joqeveritare, ne si Institucion kemi pasur një bashkëpunim mjaft të mirë më të gjitha ato Organizata që për mision kanë mirëqenien e qytetarëve, andaj unë do t'i veçoja disa nga këto:

- OJQ “Arbeiter Samariter Bund- ASB” me seli në Prizren ku është realizuar suksesshëm projekti "Mbështetje e Integruar Socio ekonomike për familjet e prekura pakicë dhe shumicë në Klinë”.
- Caritas Umbria - e cila çdo herë na përgjigjet në kërkesat tona për ndihmë familjeve skamnore;
- Qendra për Mirëqenien e Gruas - Shtëpia e Sigurt në Pejë, ku kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë, ku çdo herë na janë përgjigjur pozitivisht në kërkesat tona për strehimin e viktimave të dhunës në familje, duke respektuar kështu memorandum bashkëpunimin e kësaj Organizate me Komunën e Klinës.
- Terre des hommes, Organizatë kjo që përpos trajnimeve të organizuara, herë pas here na ka ndihmuar në ofrimin e ndihmës direkte (veshmbathje, pajisje shkollore, medikamente mjekësore) për disa familje.
- Shoqata Humanitare Bamirëse “Dushkaja”, me seli në Gjakovë, ku janë ndihmuar shumë familje skamnore me veshmbathje të përdorura, të ardhura nga Gjermania.
- UNICEF - United National International Children’s Emergency Fund (Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët).
- OFAP - Organizata për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror
- GIZ – Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
- Save the Children në Kosovë, pastaj bashkëpunim të mirë kemi pasur edhe me OSBE, Syri Vision - Organizatë që realizon veprime lokale të bazuara në praktikat më të mira me seli në Pejë, etj.

### **Pjesa kryesore**

Raporti është përpiluar i ndarë sipas sektorëve që funksionojnë në kuadër të QPS-së, atë të Shërbimeve Sociale dhe Familjare dhe Sektorin e Asistencës Sociale.

### **Sektori i Shërbimeve Sociale**

Sektori i Shërbimeve Sociale gjatë vitit 2022, ka kryer 701 shërbime, në këto shërbime përfshihen nga këshillimi deri të përkrahja për familjet me probleme familjare, kujdesi dhe mbrojtja e fëmijëve, kujdesi dhe mbrojtja e të moshuarve, si dhe shërbime tjera shtesë administrative (vërtetime, deklarata të ndryshme dhe shkresa tjera).

Bashkëpunimi i Sektorit të Shërbimeve Sociale më Institucione si, Policia e Kosovës, Prokuroria e Kosovës, Gjykata Themelore në Pejë - Dega Klinë, institucionet shkollore, zyrën për ndihmë juridike falas, mbrojtësen e viktimave, si dhe me OJQ të ndryshme ka qenë në nivelin më të mirë të mundshëm.

Gjatë vitit 2022, Shërbimi Social i ka realizuar vizitat në familje të cilat kanë fëmijë me nevoja të veçanta, fëmijë në strehim familjar, fëmijë në kujdestari, ka marr pjesë në intervistimin e të miturve në polici, ka marr pjesë në seanca gjyqësore, si dhe ka realizuar vizita tjera në familje të ndryshme ku është paraqitur nevoja e ofrimit të shërbimeve sociale.

### **Me poshtë e keni raportin e sektorit të Shërbimeve Sociale në mënyrë tabelore**

Nr.	Shërbimet e kryera	Numri i rasteve të reja	Numri i rasteve aktive (ekzistuese)	Vërej tje
1	Kujdestari për fëmijë	5	18	
	Kujdestari për raste të veçanta	2	9	
2	Delikuencë	5	0	
3	Adoptime – Periudhë provuese për Adoptim	1	0	
4	Dhunë në familje	25	25	
5	Strehim familjar brenda familjes biologjike/nr fëmijëve	0	8	
6	Strehim në shtëpinë e sigurt në Pejë	5	1	
7	Vendosje të fëmijëve në SOS fshatin e fëmijëve në Prishtinë	0	1	
8	Strehim i personave madhorë në Institutin e Special në Shtime dhe Deçan	2	6	
9	Strehim i fëmijëve në shoqatën “Caritas Umbria”, në Leskoc	0	4	
10	Shërbime për të miturit në konflikt me Ligjin	31		

11	Çrregullime familjare	6	0	
12	Strehim në shtëpinë e sigurt në Gjakovë	7	7	
13	Përcjellje të kontaktit fëmijë-prind	9	6	
14	Shkurorëzime	22		
15	Fëmijë nga prindërit e shkurorëzuar	21		
16	Strehim i të moshuarve në shtëpinë për të moshuar në Gurakoc dhe Skenderaj	0	4	
17	Vërtetime dhe deklarata	476		
18	Fëmijë më nevoja të veçanta	16	61	
19	Pjesëmarrje në seanca gjyqësore dhe polici	38		
20	Kujdestari për përfaqësime në seanca gjyqësore	2		
21	Propozime për Gjykatën Themelore në Klinë, për privim të së drejtës prindërore	1		

### Sektori i Asistencës Sociale

Në periudhën që po raportojmë, numri i familjeve shfrytëzuese të Ndhmës Sociale në të dy kategoritë është 835. Në kategorinë e parë janë 568 familje, ndërkaq në kategorinë e dytë 267 familje.

Gjithashtu, gjatë periudhës që po raportojmë në bashkëpunim me Kuvendin Komunal, Organizatat humanitare, bizneset e ndryshme, Organizatat Joqeveritare etj, i kemi ndihmuar disa familje me pako të ndryshme (higjienike, ushqimore, veshmbathje).

**Mw poshtë e keni raportin e sektorit të Asistencës Sociale në mënyrë tabelore për periudhën raportuese:**

Aktivitetet	Kategoria I dhe II
<b>Numri i rasteve që kanë aplikuar për herë të parë</b>	68
<b>Sa prej tyre janë të aprovuara</b>	45
<b>Sa prej tyre janë të refuzuara</b>	22
<b>Sa janë në shqyrtim</b>	1
<b>Numri i rasteve të ndërprera përmes ATK</b>	46
<b>Numri i rasteve të dërguara në Komision</b>	374

<b>mjekësor</b>	
<b>Numri i rasteve të aprovuara nga KM</b>	272
<b>Numri i rasteve të refuzuara nga KM</b>	87
<b>Numri i rasteve të kthyer nga KM për kompletim dokumentacioni</b>	15
<b>Numri i ankesave të paraqitura nga shfrytëzuesit e As. sociale</b>	11
<b>Në shkallë të parë ( I )</b>	11
<b>Në shkallë të dytë ( II )</b>	0
<b>Numri i ankesave të aprovuara</b>	1
<b>Numri i ankesave të refuzuara</b>	8
<b>Nr. ankesave në shqyrtim</b>	2

### **Realizimi i te hyrave nga tarifat administrative në Qendrës për Punë Sociale**

Meqenëse, më rastin e ndryshimeve të Rregullores mbi Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat Komunale, nga Kuvendi Komunal, ne si QPS kemi propozuar që të tariforen disa nga vërtetimet që i lëshon ky institucion, ju informojë që gjatë kësaj periudhe që po raportojmë, kemi arritur që të grumbullojmë një shumë të konsiderueshme të të hollave të cilat janë derdhur në xhirollogarinë e Komunës së Klinës. Në vazhdim në mënyrë të detajizuar i keni të hyrat që janë grumbulluar për periudhën Janar – Dhjetor 2022, nga tarifat që i lëshon Qendra për Punë Sociale:

Muaji	Përshkrimi	Vlera e taksës - Euro
Janar - Dhjetor 2022	Vërtetim që nuk i është marr ose kufizuar aftësia për te vepruar (për marrjen e lejes për armëmbajtje)	5,280.00 €
Janar - Dhjetor 2022	Vërtetim për lirim nga shtetësia e Kosovës	1,730.00 €
Janar - Dhjetor 2022	Vërtetim që nuk është shfrytëzues i Asistencës Sociale	88.00 €
		<b>Totali: 7,098.00€</b>

### Sfidat

- Grumbullimi e të hyrave vetanake të mbledhura nga QPS, në një kod të veçantë buxhetor të Qendrës për Punë Sociale/Shërbime Sociale, mjete këto ku do mundë të shfrytëzoheshin për pagesat e punëtorëve që angazhohen jashtë orarit të punës/kujdestari, si dhe për nevoja tjera për ndihmë të menjëhershme familjeve në nevojë sociale.
- Krijimi i një fondi të veçantë për ndihmë emergjente familjeve nevojtare.

### Përfundimi

Qendra për Punë Sociale, kujdeset për banorët e komunës sonë në nevojë për shërbime sociale dhe Asistencë Sociale, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, religjioni, dhe orientime tjera, shuma e të hollave që shpërndahen përmes këtij Institucioni brenda një viti kalendarik është rreth **1.2 milion Euro**, duke përfshi këtu familjet përfituese të Ndhmës Sociale, familjet që kanë fëmijë më nevoja të veçanta si dhe familjet që kanë në strehim fëmijë pa përkujdesje familjare.

Konsiderojmë se, edhe për kundër disa sfidave, periudhën që po raportojmë e kemi përmbyll suksesshëm, krejt kjo falë punës së stafit të QPS-së, me punën dhe angazhimin e të cilëve është bërë realizimi i planit dhe detyrave të punës, gjithashtu falë edhe bashkëpunimit të mirë me DSHMS-në, DPSF-në, si dhe me Institucione tjera qeveritare dhe jo qeveritare.

Mbesim me shpresë që angazhimi dhe bashkëpunimi në vitin e ardhshëm do rritet, në mënyrë që të arrihet në plotësi realizimi i të gjitha detyrave dhe objektivave për vitin 2023.

## **11. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT**

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport vepron në kuadër të Komunës së Klinës me gjithsej 6 departamente që kryejnë funksione dhe shërbime të ndryshme. Secili nga këto departamente ka udhëheqësit dhe zyrtarët përgjegjës për kryerjen e këtyre shërbimeve dhe detyrave. Më poshtë jepet raporti narrativ i punës duke shënuar kështu punët që janë kryer sipas planit të punës për vitin 2022.

### **➤ Departamenti i Arkivit Historik të Klinës**

Në vazhden e punëve për rregullimin e lëndës arkivore është punuar në digjitalizimin, sistemimin dhe rregullimin e materialit arkivor të disa fondeve.

- **Lëndët e digjitalizuara:**

Emri i fondit	Vitet	Kuti	Dosjet	Faqe
Bashkësia e Sigurimit Pensional dhe Invalidor e Klinës	1966-1998	1	1939-1944	305

**- Fondet e rregulluara**

Emri i Fondit	Vitet	Nr. kutive, librave	Nr. dosjeve	Nr. faqeve
Rindërtimi i shtëpive të shkatërruara gjatë luftës 1998/99 në Klinë.	2000-2002	25 kuti arkivore	107	12683
SHFMU „Nënë Tereza” - Budisalc	1956-1976	78 libra (ditarë pune)	78	32948
				<b>Gjithsej faqe: 4593</b>

*Krahas punës në rregullimin e lëndës arkivore, prioritet për arkivin ka qenë puna me palë, pranimi i kërkesave dhe shqyrtimi i tyre.*

**- Numri i kërkesave**

Kërkesa të pranuar	Të realizuara	Të parrealizuara për shkak të mungesës së lëndës në arkiv	Kopje A3 të vërtetuara	Kopje A4 të vërtetuara
<b>65</b>	<b>51</b>	<b>14</b>	<b>112</b>	<b>43</b>

➤ **Biblioteka e Qytetit “Kongresi i Manastirit”**

Biblioteka publike “Kongresi i Manastirit” në Klinë, nga planifikimi i punës për vitin 2022 ka realizuar një përqindje të madhe të detyrave, duke u nisur nga rritja e fondit librar, mbajtja e regjistrit të lexuesve, mirëmbajtjen e fondit të librave dhe regjistrin të lexuesve, përpunimin e librit, përmirësimin e fondit librar në bazë të kërkesave të lexuesve, spastrimin dhe ruajtjen e koleksioneve dhe vetëdijesimin e lexuesve po ashtu edhe shtimin e komunikimit me lexues për ruajtjen dhe kthimin me kohë të librit në bibliotekë. Këtë vit biblioteka është pasuruar në fondin e saj me një numër të titujve të rinj dhe përtëritjen e titujve ekzistues, nga MKRS kemi pranuar një donacion më 919 ekzemplarë me 414 tituj, po ashtu edhe nga komuna me përmes procedurave të prokurimit kemi furnizuar me një numër të konsiderueshëm të librave prej 495 ekzemplarë me 52 tituj të cilët janë kryesisht lektyra shkollore dhe tituj të rinj të cilët nuk kanë qenë në bibliotekën tonë. Në total vetëm gjatë këtij vitit janë regjistruar 1748 ekzemplarë apo 598 tituj të rinj.



Është realizuar edhe marrëveshja me ambasadën Suedeze ku gjatë dorëzimit të librave me autor suedez është mbajtur edhe një aktivitet ditor me të rinj dhe një tryezë diskutimi rreth librit, problematikave dhe vështirësive që kanë të rinjtë për librin dhe mos leximin e tij, më këtë rast është pranuar edhe një numër prej 112 ekzemplarë me 10 tituj të autorëve suedez ku edhe është ndarë një kënd për këto libra që e kemi emëruar si këndi suedez në bibliotekë.

Janë mbajtur edhe orë letrare me lexues dhe nxënës të shkollave të qytetit të Klinës në kuadër të javës së rinisë ku edhe janë ndarë shpërblime për nxënësit që kanë marrë pjesë në orë letrare – garë me poezi.

### ➤ **Departamenti i Kulturës**

- Në muajin shkurt kemi realizuar programin për organizimin e 14 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Aktivitetet kulturore të zhvilluara:

#### **14.02.2022:**

- Ora Letrare e Pavarësisë.
- Ekspozitë kolektive e artistëve figurativë të Klinës dhe më gjerë, në hollin e galerisë.
- Hapje për vizitë e muzeut “Mozaiku Antik” – Klinë.
- **8 Mars**, realizimi i ekspozitës së artit figurativ të nxënësve të Sh.M.L - Gjinnazi “Luigj Gurakuqi” në Klinë, holla i galerisë në Qendrën e Kulturës “Jehona e Dukagjinit”.
- **4 Prill**, është shënuar dita e të pagjeturve të luftës në Klinë, me homazhe në Klinë, Kralan, Postasel e Izbicë si dhe është mbajtur Akademi Përkujtimore në QK “Jehona e Dukagjinit”.
- **Prill**, filluan përgatitjet për Festivalin Folklorik “I këndojmë lirisë” u mbajt mbledhja e parë e Këshillit Organizativ për të vazhduar me mbledhjet e përjavshme rreth përgatitjeve realizuese të festivalit.
- **13 Prill** - Takimet letrare të pranverës, organizim i përbashkët me Klubin Letrar “Vorea Ujko”, me aktivitete letrare, promovim të librave: “ Me hënën mbi tisin qiellor” (poezi) dhe “Çaste leximi dhe interpretimi” (kritikë letrare), nga Mikel Gojani, Ismet Krasniqi: Kryetar e jo mahi, komedi, botimet më të reja të autorit Prend Buzhala.

- **15 Prill**, për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Artit u realizua Ekspozita e Artit Figurativ nga Shkolla e Mesme e Lartë Aplikative “Odhise Paskali” Pejë, në hollin e Galerisë në Qendrën e Kulturës “Jehona e Dukagjinit”.
- **21 Maj**, u shënua Dita e teatrit të Klinës, u përkujtua Osman R.Gashi me promovim të monografisë “E bukura ka vetën një emër” me autor Prend Buzhala - Qendra e Kulturës “Jehona e Dukagjinit”.
- **24 Maj** u mbajt aktiviteti letrar “Leximi i librit” në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit dhe ambasadën Suedeze.
- **28 Maj** - Takim poetik në bibliotekën “Kongresi i Manastirit”.
- **1 Qershor**, u shënua Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve e organizuar në bashkëpunim me OJQ “ArtEko”, program festiv me këngë, valle e balet në Qendrën e Kulturës “Jehona e Dukagjinit”
- **6,7,8 Qershor** – Festivali Folklorik „ I këndojmë lirisë ” Klinë, Edicioni i 20 – të, hapja e festivalit në Çabiq dhe tri net me radhë mbajtja e festivalit në qytet.
- **18 Qershor** – Dita e Çlirimit të Klinës u mbajt ekspozitë kolektive e artistëve figurativ nw Sheshin Mujë Krasniqi si dhe promovimi i librit “Muri i kujtesës” me autor Vilson Culaj nw Qendrën e Kulturës, si dhe programi artistik me këngë e valle i mbajtur para Komunës së Klinës.
- **25, 26, 27 dhe 28** Korrik u mbajt “Camping Fest” Edicioni i 4-të në Dresnik, Ujmirë-Klinë, e organizuar nga OJQ “ArtEko” e mbështetur nga Komuna e Klinës- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
- **30 dhe 31 korrik** u shënuan Ditët e Diasporës me dy koncerte para Komunës së Klinës për bashkatdhetarët.
- **3 Gusht** u mbajt promovimi i librit “Nëpër breza me idealin e lirisë” të autorëve Shefqet Kryeziu dhe Rovena Shuteriqi në Qendrën e Kulturës “Jehona e Dukagjinit”
- **5 Gusht** nw kudër të programit “Karvani i Diasporës 2022” Ministria e Jashtme dhe Diasporës nw bashkëpunim me Komunën e Klinës shfaqti filmin artistik “Zgjoji” tw Blerta Bashollit, para objektit të komunës.
- **11 Gusht** në sallën e Kuvendit tw Komunws u mbajt akademi përkujtimore kushtuar doajenit të arsimit prof.Frrok Gojanit, ku u mbajt promovimi i monografisë “Frrok Gojani, pedagog e misionar i denjë i shkollës shqipe” autor Mikel Gojani.
- **12 gusht** në kuadër të pritjes së mërgimtarëve u mbajt promovimi i vëllimit poetik “Ndalo” autore Lulëjetë Dragidella- Tigani, Qendra e Kulturës “Jehona e Dukagjinit”.

- **-7 Shtator**, në sallën e Asamblesë Komunale u organizua manifestimi tradicional „Ora e Tahir Deskut” i 13-të me radhë, ku u shpërblye vepra më e mirë letrare dhe iu nda Çmimi „Tahir Desku” shkrimtarit Ilir Muharremi si dhe u mbajt Ora e madhe letrare me poetë nga të gjitha trevat shqiptare dhe u ndan shpërblime e mirënjohje.
- **24 shtator** në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës u mbajt: Takimi me shkrimtarin Nasi Lera, si dhe promovimi i monografisë studimore letrare “Poetika e Nasi Lerës” me autor Mikel Gojani.
- **14, 15, 16 dhe 18 nëntor** u mbajt Java e Kulturës, në Qendrën e Kulturës “Jehona e Dukagjinit” dhe u mbajtën këto aktivitete:
  - Ekspozita e studentëve të Fakultetit të Arteve - dega e artit figurativ të Universitetit të Prishtinës.
  - Debat rreth teatrit dhe lojës së aktorëve në skenë.
  - Koncert me muzikë klasike, kuartet në saksofon.
  - Shfaqja e filmave të metrazhit të shkurtër të Fakultetit të Arteve - dega Regji dhe Film të Universitetit të Prishtinës, u shfaqën filmat e studentit klinas Dardan Kabashi.
- **25 nëntor** për nder të 28 Nëntorit në hollin e Galerisë të QK „Jehona e Dukagjinit” u mbajt ekspozita tradicionale ART Klina 2022-edicioni i shtatë.

#### ➤ **Përgjegjësi për zërim dhe kinoaparaturë**

- Ka realizuar përgatitjen teknike të sallës për secilin aktivitet të mbajtur në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Gjithashtu DKRS këtë vit ka mbështetur edhe shumë aktivitete të tjera si; promovime librash, sesione informuese nga OJQ të ndryshme, realizimin e konferencave dhe trajnimeve të ndryshme për të cilat është përkujdesur përgjegjësi për zërim gjatë gjithë vitit dhe ka kryer me sukses çdoherë përgatitjen e duhur teknike të sallës së kulturës.

#### ➤ **Departamenti i Rinisë**

Aktivitet kanë filluar që në muajin Janar nga DKRS por edhe në bashkëpunim me OJQ rinore dhe projekte të ndryshme rinore. Kemi zhvilluar takime të shumta me Departamentin e Rinisë në kuadër të MKRS-së, me organizata rinore si dhe punëtori që kanë për qëllim angazhimin e rinisë në projekte të ndryshme. Është realizuar Java e Rinisë **17-21 tetor** me;

### **Aktivite Kulture:**

- Vizita në objekte të trashëgimisë kulture dhe galeri artistike.
- Ora letrare, poezi, recital me të rinj në bashkëpunim me shkolla fillore e të mesme.
- Ekspozitë në artet figurative – kursi i pikturës.

### **Fusha e edukimit dhe vetëdijesimit**

- Trajnim dyditor me qëllim fuqizimi të rinisë – Të rinjtë pjesëmarrës janë certifikuar.

### **Aktivite sportive me të rinj/të reja;**

- Futboll në bashkëpunim me shkolla.
- Volejbol për femra.
- Basketbol meshkujt.
- Gara në ping-pong.

Gjithashtu është mbajtur një aktivitet në kuadër të projektit të përbashkët "Promovimi i dialogut ndër-komunal" me komunat e regjionit të Dukagjinit, ku janë diskutuar projekte të shumta për rinore në bashkëpunim me komunat e rajonit të Dukagjinit.

### **➤ Departamenti i Sportit**

- Janë realizuar aktivite të ndryshme sportive për të shënuar data të ndryshme historike si dhe gara e lojëra në kuadër të shkollave e klubeve sportive ekzistuese në Komunën e Klinës;
- Aktivite sportive për nder të 17 Shkurtit ditës së Pavarësisë së Kosovës.
- Fillimi i Kampionatit të Kosovës në futboll pjesëmarrja e KF „Dukagjinit”.
- Përgatitjet e klubeve të riaktivizuar për kampionatin e Kosovës.
- **Qershor** - Muaji i aktiviteve sportive, organizimi i turneve për nder të FF „I këndojmë lirisë” dhe Ditës së Çlirimit të Klinës me ç ‘rast edhe janë ndarë mirënjohje për disa klube që kanë realizuar suksese gjatë vitit.
- Kemi vazhduar me regjistrimet, lejet e klubeve dhe riaktivizimet e tyre.
- Aktivite sportive për javën e rinisë, gara shkollore.
- Nëntori - muaji i analizave të suksesit të klubeve në kampionatin e Kosovës,
- Organizimi i turneve në disa disiplina të sportit me rastin e festës së 28 Nëntorit - Ditë së Flamurit.

- Kemi ofruar mbështetje në realizimin e garave, turneve dhe aktiviteteve të ndryshme për shkollat, klubet sportive apo organizime individuale e shoqërore sportive.

➤ **Investimet kapitale**

- Rinovim i pjesshëm në Shtëpinë e Kulturës.
- Inventarizimi i Palestrës Sportive.
- Rrethojë metalike në fushën ndihmëse të futbollit.
- Rregullimi i kullës së Mujë Krasniqit.

➤ **Subvencionet**

- Realizimi i festivaleve, orëve letrare dhe ekspozitave tradicionale.
- Mbështetje financiare për OJQ-të kulturore, rinore dhe shoqata si dhe për klube sportive.

